

Xhevahir Cirongu

Shtigjet e vendlindjes

Publicistikë

Titulli:

Shtigjet e vendlindjes (Publicistikë)

Autor:

Xhevahir Cirongu

Redaktor:

Osman Azizaj

Durrës, Jozef, 2021

ISBN : 978-9928-357-06-9

Falënderim:

Falënderoj nga zemra ime, sponsorin e këtij libri, z.R. Paja, i cili e do librin,do dijen e përparimin shoqëror e intelektual në mendim e veprim.

Atij i jam shumë mirënjohës, dhe nga shpirti im i uroj shëndet e suksese në jetë me bekimin e malit të shenjtë "Baba Tomorri".

Miqësisht,

Xhevahir Cirongu

Durrës ,Qershor 2021

Reportazh

Djali nga Skrapari Rako Paja kërkon të "kap" diellin...

Të shkruash për këtë djalë, i cili në dukje të parë kur bisedon me atë, gjatë bisedës do zbulosh hap pas hapi atë begram sa intuitativ, po aq vizionar me një këmbëngulje e besim për realizimin e ëndrrave vetiake e ato shoqërore. Kjo këmbëngulje e shoqëruar me një besim deri në takimin me yjet e qiellit, të jep shkas që të ndalosh pak si gazetar për të reflektuar ndaj këtij njeriu me utësinë e mendimet që shpalos edhe si intelektual. Të tillë njerëz janë të paktë në shoqërinë tonë, prandaj duhet edhe një investim racional deri në këputshmërinë e mendimeve të tyre, sepse ato i shërbejnë gjithë shoqërisë të tashmes e të ardhmes. E megjithatë, ne kontaktuam posaçërisht me Rako Paja, ku biseda merr udhën e bashkëbisedimit jetësor....!

U lind në qytetin Çorovodë, rritet në fshatin Çorrotat...

Kur e pyetëm se në ç'vit ke lidur, ai në fillim u ndrojt pak, por ashtu me atë thjeshtësinë e një djali intelektual që e karakterizon, na u përgjigj shkurt: - Unë në fakt kam lindur në qytetin e Çorovodës, por jam rritur e arsimuar në vendlindjen e gjyshit e të babait tim, në fshatin Çorrotat të zonës tomorricë – Skrapar. Edhe nënën po nga kjo zonë është, nga fshati Straficë, na thotë Rakua. Vështirësitë ekonomike të kësaj familje ishin tej të skajshme. Por, fjala e ngrohtë e gjyshit Muharrem dhe e dy prindërve Zylfo e Lule Paja, u jepnin forcë e besim për të ecur

pa u ndalur drejt të ardhmes. Ishin këto fjalë zemra, të ëmbla si mjalti, por edhe këshillat e herë pashershme të gjyshit e të atit Zylfo (të cilët sot nuk jetojnë) ië cilat i frymëzonin për të realizuar vepra të mira në jetë. U rritën me këtë frymë edukatë dhe sot ata punojnë e jetojnë me djersën e ballit. E pyesim Rakon: Sa vëllezër e motra jeni ? Ai na përgjigjet: jemi 4 vëllezër e 1 motër! - Motrën e kemi të martuar, dhe 3 vëllezër. Kurse vëllanë e vogël ende s'është martuar! - Po ju sa fëmijë keni ? - Një vajzë e dy djem, na përgjigjet ai. Vajza e ka emrin Kejsi, kurse djemtë: Zakris e Bjordi. Arsyet ekonomike dhe ato familjare më detyruan të lë qytetin ku linda dhe u përkushtova punëve në fshat, - na thotë Rakua. Ne ngacmojmë bisedën tonë për ta vazhduar më tej atë. Ashtu, duke ecur në rrugën e pyetjeve, e ngacmoj me pyetjen tjetër e cila kishte të bënte me arsimimin e këtij djali energjik e fjalë shtruar si një tapet plot kolor ngjyrash. Familjet shqiptare si në veri e jug të Shqipërisë migruan drejt jug- perëndimit të vendit. Edhe familja e Zylfo Paja lë Skraparin e vendoset me banim në fshatin Rrashbull të qytetit bregdetar të Durrësit.

Ëndrra e këtij djali ishte arsimimi !

Arsimin e mesëm e kryen në shkollën "Peliva Dorrozhani" Zhepë - Skrapar. Ishin vitet e para të ndërrimit të sistemit monist. Sigurisht, si kudo në Shqipëri, edhe familja Paja kishin plot vështirësi ekonomike. Jo vetëm ekonomia e dobët familjare, por edhe sëmundjet e nënës Lule e gjyshit Muharrem, jua shtonin hallet kësaj familje. Bashkë me vëllezërit më të mëdhenj, të cilët ishin edhe në moshë pune, morën rrugën e kurbetit drejt Greqisë. Kështu, gati 10 vjet punoj emigrant larg atdheut. Ndërpret punën e fillon arsimin e lartë në Tiranë. Ishte viti 2004, fillon studimet në degën Inxhinieri Ndërtimi dhe elektrik 1 vit në Universitetin e Tiranës, dhe 3 vitet e fundit i mbaron në Selanik të Greqisë. Rakua s'ju nda asnjëherë punës dhe diturisë. Kjo e fundit ishte edhe një amanet e gjyshit Muharrem. Dhe me të vërtetë Rako Paja zgjodhi rrugën e dijes për t'u bërë i ditur për vete dhe i dobishëm edhe për shoqërinë. Pas universitetit, ishte ky djalë me plot ëndrra për të ardhmen që s'u nda librit e diturisë për asnjë çast; kështu mbaron në vitin 2020 në degën Energjitikës "Panelet Diellore" (energji e gjelbër)

në universitetin "A. Moisiu" Durrës.Ëndrra e këtij djali ishte arsimimi,sepse pa dije s'mund të ecte në rrugën e duhur të jetës. Dhe ai me mund e përkushtim ia arriti këtij qëllimi final i cili është një udhërrëfyes së jetës e punës së Rako Paja.Pa këtë busull formimi të diturisë e arsimimit vetiak,por edhe profesional, së bashku me guximin, s'do ishte ky që është sot.



Episode nga emigracioni....

Ishte muaji prill i vitit 1994 . Ashtu, së bashku me disa shokë të zonënës e bashkëfshatarë, niset drejt shtetit fqinj Greqi. Zakonisht emigratët niseshin në fillim të pranverës ose në vjesht kryesisht në shtator.Rrugëtimi ishte plot rrëziqe, sa ai kërkonte edhe jetën e emigranteve. Plus rrugëtimin nëpër male e lumenj, një rrëzik real bëhej edhe policia e ushtarët grekë. Ishin këto fjalë që ende mezi i shqipëronte me lot në sy Rako Paja, sepse ato vite kishin lënë kujtime të hidhura. Janë disa djem e vajza nga zona e tomorricës, që në ato vite rrugëtimesh për në emigracion duke ecur në këmbë, u kushtoj edhe me jetën e tyre.Që të merrje atë rrugë, duhej ta bëje mirë llogarinë, se ndryshe e paguaje me jetë ! Dhe...ata ecnin me këngën e moçme në gojë që tomorricarët e kanë kënduar në shekuj : "Zunë

yjet e rrallojnë / Kurbetlinjtë po shkojnë / Kapërcyenë Gurin e Prerë / Nën at qajnë derë më derë /... (!) Kur djemtë dalin në Gurin e Prerë, hedhin sytë nga mali tomorr e marrin bekimin e tij. Këtë bëri edhe Rakua me shokët e të afërmit kur u nisën për në kurbet. Intenerari i rrugëtimit ishte i gjatë me plot rreziqe. Do kaloje qytin Maliq, Korçë, malin Gramoz në Ersekë. Me të lënë malin Gramoz, ku matanë ishte greqia, do kaloje lumin e "Vdekjes" në Grevana. Ky lum nga emigrantët ishte emëruar me këtë epitete : "Lumi i vdekjes". Një lum shumë i rrezikshëm, sa e sa jetë djem e vajza të rinj jua kishte prerë në mes ëndrrat atyre !? Edhe Rakua ishte shumë i ri në atë kohë, ai drithet i tëri kur i kujton ato vite . Pastaj dilnin në Lariskë e Kozanë dërsa arrinin në malin e Grevanasë. Në malin Gramoz qëndronin një natë nëpër stane ose nën pemë , si mbulesë kishin plasmasin. Me të mbritur në Grevana, aty punonin disa ditë. E shumta 2-3 ditë në pemptoren e pjeshkëve. Si bënin disa pare (dragmi) për të blerë bukë e ushqime të tjera , sepse rrugëtimi nuk mbaronte këtu. Ecnim drejt Selanikut dhe pas 14 ditëve rrugëtim ditë e natë qëndronim në Kalidhiki. Aty punonin njerëzit e mi, - na thotë Rakua. Kush ishin ata , - pyes me fjalë dashamirësie Rakon. Ai sjell në kujtmet e tij disa prej tyre si : Veri Paja, Adriatik Paja (vëllai), Koçi Paja, Ferdinand Paja, Luan e Besniku etj. Por, edhe nga fisi hasanllarëve . Të gjithë ne bënim punë bijqësie. Rakua ishte më i vogli i grupit. Atij si pëlqente kjo punë. Problem ishte edhe gjuha, na thotë Rakua. Sa ditë qëndrova aty ? Vetëm një javë, na përgjigjet Rako Paja. Në këto ditë aty mësova vetëm tre fjalë greqisht: si i thoshnin bukës, ujëit, punës!

Ndonjëherë fati të troket në derë, por duhet edhe ta respektosh atë...

Nuk i dihet nga se të vjen e mira apo e keqia në këtë botë. Këtë e ka provuar edhe Rakua , sa që sot kur e kujton "fatin" e tij l duket pakëz si e çuditshme, por është një realitet konkret që i solli mirësi në jetë. Pra, ishte ky fat i cili e njohu me një sipërmarrës grek me emrin Qiriako. Ai ishte njeri inteligjent dhe shumë kërkues ndaj punës e disciplines, sa që atë e quanin edhe me epitetin i "egërt", por në shpirt kishte humanizëm. Dhe Rakua na tregon: " Mbas 8 ditëve takoj në qëndër të fshatit Qiriakon. Me makinën e tij nisemi së bashku drejt një kantieri ndërtimi. Në atë kantier ishin të punësuar vetëm puntorë grekë. Në atë kantier emigrantë shqiptarë punonin vetëm 1 ose 2 ditë dhe largoheshin, sigurisht merrnin edhe pagën që u takonte. Thash me vete se, edhe unë do kisha të njëjtin fat. Por, kjo

s'ndohi tek unë.Vazhdoja të punoja normalisht, pavarsisht se ditë po kalonin limitin e tyre. Kur fillova punë atë ditë duke transportuar karrocën me Ilaç,bëra një manovrim , sepse s'mund ta shtyja dot karrocën për shkak të rëndesës së saj, por edhe të moshës sime. Isha 14 vjeç në atë kohë. Mora dy kova i ndava në dy pjesë Ilaçin, dhe shpejtoja për ta kapur kohën e transportit për në destinacion. Nga larg më vëzhgonte Qiriakua,por unë se kuptoja dot.Mbas disa ditëve, më afrohet Qiriakua dhe më ra krahëve duke më falnderuar. Pastaj në greqisht më tha :” *Kam gabuar me punëtorët shqiptarë, u kërkoi falje atyre !*”. Më von mësova se ai nëpërmjet meje u kërkonte të falur emigrantëve shqiptarë,dhe ishte bërë pishman për këtë vlerësim. Ishin kohë të trubullta, e s'mund ta kishe të lehtë në atë kohë hapje rrugësh kufitare,se kush kishte të drejt e kush ja kishte me hile. Nga ky çast Rakua punoi për 8 vjet rresht në këtë kantier ndërtimi.Në këtë kantier pune punonte dhe vazhdonte edhe studimet në Selanik.Kjo i bëri shumë përshtypje Qiriakos, dhe më von më kalon sipërmarrës të punimeve ndërtimore. Gjatë kësaj kohe që isha aty me punë u punësuan emigrantë që vinin nga Skrapar e Tomorrica, Elbasani,Cërriku,Berati,Korça,Gramshi, etj.”. Vitet kalonin,por edhe Rakua fitoj eksperiencë e kulturë pune.Kështu mbas 8 viteve krijon sipërmarrjen e parë të ndërtimit shqiptarë në zonën e Kalikrotës, duke ndërtuar dhjetra e dhjetra objekte ndërtimi në këtë zonë.Ishte puna cilësore dhe korrektësia ajo që i dha emër këtij djali shqiptar në greqi. Por Rakua vazhdon të na tregojë edhe një episode tjetër, përsa i përket korrektsisë në ndërtim: “ *Një ditë më vjen një grek me emrin Stelio me moshë rreth 65 vjeç.Ai donte të ndërtonte një vilë 3 kate në malin Vasilica në Grevana.Afati ishte brenda 3 muajve.Nuk e merrte askush për ta ndërtuar objektin në një kohë kaq të shkurtër*”. Pas një telefonate me Stelion, Rakua merr guximin e ndërtimit dhe e përfundon atë brenda afatit të caktuar.Këtu ndërpret aktivitetin e ndërtimit. Stelio mbetet i kënaqur dhe Rakos i rekumandon një shokun e tij me emrin Jani Titakis të moshës 63 vjet.Takohet me Janin e shokun e tij gjerman duke bërë një marrveshje ortakrie për të instaluar në Shqipëri impjante diellore (Energji e rivonueshme).Edhe Rakua qe i gatshëm për këtë propozim.Kjo ishte edhe një ëndërr e tija e hershme që të investonte në atdheun e tij Shqipëri.Kështu, mbas 23 vjet pune emigrant në Greqi, në vitin 2013-2014 kthehet në Shqipëri për të filluar punën.Ju desh një kalvar i gjatë duke rendur nëpër zyrat e shtetit shqiptar. E shikonin me spekticizëm e mosbesim këtë

sipërmarrje të vështirë që po merrte një djalë i ri nga një fshat i thellë të zonës tomorricë të rrethit Skrapar. Por, këmbëngulja e guximi i tija, bëri që të thyejë gjithë barrjerat burrokratike. Kështu në vitin 2014 merr lishencën e parë në Shqipëri për "Energji e rivotueshme Fotovoltaik" duke u bërë pionere e para në këtë fushë të shkencës në Shqipëri. Ka 6 vite që ky djalë i ri po investon kapacitetet intelektuale dhe monetare duke ndërtuar parqe diellore. Kështu, parkun e parë e hap në aksin Tiranë – Durrës. Pastaj shtrihet në Fushë – Krujë duke ndërtuar central me 350 KV. Por, janë edhe disa 10 të vegjël si në Durrës e në çdo qytet të Shqipërisë. Aktualisht punohet te kompleksi "FAFA" në Golem. Por, janë në pritje për t'u realizuar kontratat e reja në qytetet Vlorë, Tiranë, Berat, Lushnje etj. Pritet gjithashtu për të realizuar projektin e madh të parkut energjitik diellor më të madh në Ballkan, i cili do ndërtohet në Porto Romane në qytetin bregdetar të Durrësit. "Eco Energia" është kompania e parë e çertifikuar në Grqi për ndërtimin e impianteve Fotovoltaike. Por, Rako Paja, një djalë guximtar e me vizion prej intelektual, merr guximin e sjell këtë eksperiencë edhe në Shqipëri në vitin 2015, ku tashmë është edhe administrator i kompanisë. Me punën e deritanishme, kjo kompani numëron mbi 350 impiante fotovoltaike të instaluar në vend e në rajon. Ai synon të "kapi" rrezet e diellit e ti kthejë në energji elektrike në dobi të vendit e për gjithë familjet shqiptare.



...Jo vetëm i punës, por Rakua është edhe djalë i këngës!

Ishte data 27 nëntor 2020, ashtu së bashku si një tufë lule "bore" iu ngjitën me makinën e tyre drejt malit tomorr. U nisën gjysh herët në mëngjes nga Durrësi e Tirana për tek mali i shenjtë Tomorri. Ndonse pak ftohtë në këto ditë fundore të muajit nëntor 2020. Ishte kënga e grupit polifonik "Tomorrca – Skrapar" e cila i tha reve të largoheshin drejt hapësirës së qiellit blu. Dhe me të vërtetë, kjo ndodhi si me magji, koha mbajti si vetë zemrat e kënga e këtij grupi që sapo ka çelur si manushaqet e pranverës së malit tomorr. Është kënga ajo që ngroh shpirtin e njerëzve, por edhe i jep shpirt e jetë kombit të vetë. Ashtu, atë mëngjes i bëra një telefonatë Rako Paja, një djalë energjik, punëtor, e mbi të gjitha ai e do me gjithë shpirtë këngën popullore. – Po, Rakua jam, - më përgjigjet në krahun tjetër të telefonit. – Ku ndodhëni, - e pyes unë atë? – Jemi këtu te busti i Dervish

Iliazi në Kulmak në malin Tomorr. Ishte ora 9.30 minuta. Bënte pak ftohtë, por me kalimin e orëve koha u zbut, sepse rrezet e diellit na “përshëndetën” deri sa ne bëmë vidioklipin atje në malin Tomorr. Pikërisht, ishte ky udhëtim i bukur sepse na jepte ngrohtësi kënga që u këndua aty për vendlindjen tonë tomorricën e skraparit. Aty janë kënduar shumë këngë, që nga lashtësia e deri sot. Ja, edhe në këtë 27 nëntor të 2020 – ë, grupi i këngëtarëve iu ngjiti si shqiponjat e këtij mali duke kënduar këngën “Kënga jonë udhën e mori” me tekst të poetit Arben Duka. Jehona e këngës u dëgjua deri në majën e malit Tomorr atje ku qielli “puthet” natë e ditë me këtë mal të bekuar nga perëndia. Sa bukur?! Janë djemtë skraparas e tomorricarë që u digjet shpirti dhe këndon goja e zemra për vendlindjen e tyre. Buçet kënga e jehon gjithë luginën nga mali Koshnicë, Qafa e Gjarprit, Ostrovicë, mali Mëlovë, e deri në Sulovë. Kjo këngë këndohet nga Nesim Mëno e Pëllumb Gjata. Iso mbajnë: Sefedin Çela, Xhelal Cërri e Rako Paja. Aty nuk mungon edhe mjeshtri i muzikës së këngës popullore, Agim Xhemali. U filmua, u bënë foto, por mbi të gjitha vargjet e këngës oshëtinë drejt monopateve të maleve dhe u ulën në prehrin e luginës së Tomorricës për t’u kënduar në shekuj. Kemi për të thënë shumë, por na mbetet për ti thënë grupit polifonik “Tomorrica – Skrapar” udhë të mbarë bashkë me këngën “Kënga jonë, udhën e mori!”. Vetë jeta është punë e këngë, bukuria e jetës sonë.



Foto e grupit në malin Tomorr

Durrës dt. 3 Nëntor 2020

Poet që ndez zjarre e lë gjurmë në shpirtin e lexuesit

Refleksion

Duke hedhur një vështrim tërsor gjithë poezive të autorit Idriz Ismajli, para syve m'u shfaq anija e jetës. Ajo lundronte nëpër det bashkë me gjurmët të cilat kuvendonin me njëra – tjetrën. Aty janë gjithë ato kujtime të bukura, por edhe sakrificat, ku së bashku formëzojnë atë gjerdan petalesh me lule shkronjash e varg poetik të magjishëm shpirtëror. Po të ulesh, ashtu ngadalë në tapetin e poezive të këtij autori, lexuesi do gjejë tharm poetik, i cili do i shkrijë akullin e viteve të jetës, si rrjedhojë e kësaj do i diellrohet shpirti. Poezitë e këti vëllimi me titull "Gjurmë", kanë specifikat e tyre krijuese e letrare. Vetë autori është një zog shtegëtar, ku takohet me jetën

e tij në kohë,.Vargjet e poezive përcjellin ato mesazhe të fuqishme deri në skutat e fsheta të shpirtit edhe të vetë lexuesve. Libri poetik është ndarë në katër nëndarje. Në çdo pjesë, poezitë kanë një ndërthurje midis tyre, si rrjedhojë e kësaj lexuesi e ka më lehtë për t'u njohur me (124) poezitë e përfshira në këtë vëllim. Tematikat e poezive kanë larmi ngjyrash artistike letrare, por edhe një stil krijues letrar disi ndeyshe, ku spikat thjeshtësia artistike. Kjo frymë e stilit të thjesht krijues me burim jetësore, ndez si zjarr gjurmët e jetës sonë e të vetë poetit me thirrjen : E DUA JETËN ! Liqeni shpirtëror i poetit Idriz Ismajli, vjen pas kaq vitesh e shkrepëtën fuqishëm si një rrufe qielli duke na dhënë vargje të bukura, të veshur me mantelin e kaltërsisë së qiellit, të natyrës së gjelbër, të luleve në livadhe, të borës , apo të "ngricave" të jetës sonë. Në librin me poezi "Gjurmë" ai udhëton bashkë me fjalën e shkruar, me ëndrrat si fluturat nëpër lule në livadhe e kroje; pikërishtë kjo e të tjera e bëjnë poezinë të dashur për gjithë katigoritë e lexuesve, për ta lexuar atë deri në fund. Dhe vazhdon me "Rrethi vicioz" , "Ëndrra nuk merret", "Po të mos ishe ti". Simbolika e titullit të librit " Gjurmë", është si një busull që orenton gjithë gamën e poezive të këtij vëllimi.Mesazhet e jetës janë të qarta : me lajtmotivet e saj të mira apo të këqija, ajo na fton në lëmin e jetës për ta jetuar. Por, ne si qenie njerëzore duhe të lëmë gjurmët tona që t'u flasim brezave të tashëm e të ardhshëm. Këtë poeti e shpreh në poezinë "Gjurmë" nga ku ka marrë edhe titull libri.Ja si e shpreh poeti këtë më konkretisht:

"Cifla bore,
Më bien mbi pelerinë !
I shkund,
Por nuk shkunden,
Dhe gjurmë lënë
Edhe pse pas pak
Shkrijnë !"

..Me këtë poezi, poeti Idriz Ismajli na tregon vazhdimësinë e JETËS. Ndërsa te poezia "Ftoi i gjyshes" poeti përshkruan portret e gjyshes, e cila qëndron e gjallë në memorjen e tij. Ai ndjen dhimbje në shpirt, por edhe e kujton me mall e dashuri, ku bashkëbisedon ëmbël me vargun e përjetësisë te kjo poezi. Sa herë prek një ftua, ai ndjen aromën e gjyshes. -Dhe vargjet kumbojnë me pjalmin e dashurisë, ku zemra kujton e përjetëson:

"Ttani sa herë hap dritaren kah kopshti,
Dhe shoh ftoin me degë kërrusur përtokë,
Më kujtohet arka e gjyshes në qoshe
Që mbushte dhomën me aromë ftoi".
Një ndjesi që të sjell aromë pranvere ,janë edhe vargjet e poezisë "Lirikë pranvere", ku vargëzimet lirike marrin trajta plot simolikash të ngarkuara

me metafora artistike. Po kështu te poezia me titull "Përsëri dimër" apo "Si lumi rrjedhin vitet" etj.

"Si lumë rrjedhin vitet
N' mes miqsh rrjedh jeta
E vetëm fotot mbesin
Si kujtim në sirtar!
me ca "gjurmë" në flokë
nga erërat e jetës
dhe shpirt të paepur,
Nga stina në stinë!"

II

RRETHI VICIOZ

Në këndvështrimin e poezive "Rrethi vicioz", ku në këtë nëngrup përfshihen 25 poezi, autori Idriz Smajli na sjell artistikisht e me fines bukurinë e vargjeve poetike, i cili na përshkruan me dhimbje rrethin vicioz të jetës sonë. Ai ngreh atë shqetësim madhor para vetes e shoqërisë, sa që bën thirrjen sublime me anën e vargut krijues të poezisë, se jeta duhet jetuar me gjithë të mirat e të këqiat e saj, sepse në fund të fundit është një sfidë, ku njeriu e si shoqëri njerëzore, duhet të lërë pas "Gjurmë" mirësie deri në kupën e qiellit, e të flasë me yjet! Ndryshe, jeta merr kahun e rrethit vicioz, deri në vetëasgjësim. Prandaj poeti bën thirrjen e tij që i del si vullkan nga shpirti, sepse tërë shoqëria njerëzore të ndërgjrgjësohet sa nuk është von nga ky rrethim vicioz, e ti thotë JETËS të DUA! Konkretisht:

"Sikur jemi të djallëzuar

Apo kënaqemi

me djallëzi

E bota na shikon

bën sehir

...Ishin viktima, këta dje?

Apo tënjëjtit janë

Viktima sot!..."

...Dhe vazhdon këtë thirrje plot jehonë edhe tek poezitë "Letra", "Sa hironi", "Tik-taku i orës", "Shumë dhimbje", "Binarët e jetës", apo "Në mes yjesh i fshehur", "Pa fjalë", "Kjo botë", "Vizitë në qytetin e Gjirokastrës", etj. Ne po sjellim këto vargje për ta bërë sa më të lehtë lexueshmërinë e lexuesit të këtij vëllim prestigjioz, sepse me anën e vargjeve të këtij vëllimi, poeti thyen të gjitha rrethimet vicioze, e si rrjedhojë ngreh male e kështjella jete deri në yjet e qiellit.

"I vogël është planeti i ynë

për gjithësinë...

Sa një grimcë kuantike

Ne mes yjesh,

Diku!?"

"I vogël është planeti i ynë

për gjithësinë...

Sa një grimcë kuantike

Ne mes yjesh,

Diku!?"

Pra, kjo thirrje e poetit duhet dëgjuar nga të gjithë, pa prjashtim, sepse ndryshimet globale atmosferike rrezikojnë planetin tonë, ku ne si njerëz jemi banorët e tij që të mos shkojmë tek ai rreth mizerioz sa nuk është von. Pra, kjo thirrje e poetit duhet të dëgjohet nga politika në përgjithësi, e në veçanti nga qeveritarët e çdo vendi, por edhe nga ndërgjegjësimi i tërë shoqërisë njerëzore, pa dallim në mbarë globin.

III

ËNDRRA NUK MERRET

Po ti hedhësh një vështrim të përgjithshëm poezive të ciklit të (3) të këtij libri, në (38) poezitë autori sjell lirika të bukura vargjesh me temë atdhetare, epike, apo lirika shpirtërore. Tharmi i poezive mbart atë pjalm fryme, ku era e lirisë ngrihet lart në përjetësi në emrin më të dashur ATDHE ! Poeti është i kudogjendur me vargun e tij poetik. Ai shtegëton në çdo cep të atdheut, ulet e bisedon me historinë, me patriotët, me dëshmorët, me mendimtarët e kombit. Kjo tregon se, edhe vetë poeti, në një mënyrë apo në tjetër këndvështrim, i digjet shpirti si vargjet e Naimit për atdheun. Poet i Idriz Ismajli i këndon shpirti për Kosovën martire, ndaj edhe poezia e tij është e veshur me mëndafshin e këngës së shpirtit. Vargu merr fluturim si pëllumbat, ajo ulen për kuvendim me historinë në Mitrovicë e Deçan, Kaçanik e Gjakovë, Ulqin e Guci, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë, Tiranë, Prekaz, Prizren etj. Vargun e poezisë e përjetëson në gonxhen e LIRISË së Kosovës në Prekazin heroik me heroin e kombit tonë legjendarin ADEM JASHARI. Pra, meqëse gama e poezive është e madhe në këtë cikël, ne po sjellim disa prej tyre për ta informuar e orientuar lexuesit. Si psh, "Para monumentit Nënë Shqipëri", "Bac Adem Demaçi", "5 maji", "U ktheve te rrënjët", "28 Nëntori", "Ëndrra nuk merret", etj. Dhe më konkretisht :

1. Nga poezia "Para monumentit Nënë Shqipëri"

"Eh! Nënë Shqipëri sa rudha paske në ballë

Sa thinja në kokë!

S'më dukesh e re

Mos vallë e ke nga malli që të ndryn në zemër

Për birin tënd të dashur

Që të ndarë e ke?!

Tiranë, 12 tetor 1980

2 . Bac Adem Demaçi

.....

"...ne te gjithë të jemi borxhlinjë

Se ti ishe i të gjithë neve
Më shumë se vetës tënde
Se sonte të pranoj Toka e Kosovës
Në gjirin e vet
Si birin ma të mirë të saj
Bac Adem! ‘‘

3 U KËTHEVE TEK RRËNJA Kushtuar Hasan Prishtinës

U ktheve të rrënja Ti
Sot
Sepse kjo tokë të kërkoi
Nuk duronte, pa birin e vet
Nuk duronte
dot
E tani pyesim vetën?
E si do të ishim ne
Sot
Pa Ty
Pa vizionin Tënd!

.....
4. 28 NËNTORI

‘‘ Për çdo vit na mbledh
rreth teje
O Flamur!
Nga cepi më i largët i Shqiptarisë.
dhe thërret me të madhe
Shporru viti zero
nga këto troje të lashta
të Arbërisë’’.

.....
5 APO : ‘‘ ËNDRRA NUK MERRET’’

Nata të sjell ëndrrën,
e të gjitha dëshirat t’i mbledh,
ti vë nën jastëk,
të pamundurën ta bën të ‘‘mundur’’.
Nën dritën e hënës
atje lart,
e mbledh kujtimet e jetës,
e t’i vë përpara,

një nga një,
gjer sa gjumi troket në qepallë.
Që të sjell ëndrrën
në natën me hënë,
si një vegim.

Është e vërtetë, se ashtu siç thotë edhe poeti Idriz tek kjo poezi se, ëndrra s'merret, por ajo bëhet materiale atëhere kur kthehet në vargje e të mbush shpirtin si qenie njerëzore. Kur njeriu realizon ëndrrat me të cilat mendon e jeton, dhe ato i bën pjesë e realitetit jetësor në qëllimet e veta, lë gjurmë pas e bashkëbisedon me brezat e ardhshëm nëpërmjet fjalës së shkruar. Edhe Autori Idriz Ismajli, duke botuar këtë libër, ka relizuar ëndrrën e tij.

IV

PO TË MOS ISHE TI

Vargu lind poetin apo poeti thur vargje poetike?! Kësaj pyetje kaq domethënëse, por edhe inigmatike, do ta gjesh te poezitë e vëllimit të parë që paraqet poeti ynë nga Kosova Idriz Ismajli. Në ciklin e katërtë lexuesit që janë të dashuruar pas poezisë, do të gjejnë vërtetë vargje të spikatura, ku mesazhi filozofik bëhet njësh me gjithë gamën e cikleve të tjera që paraqet ky vëllim me titullin "GJURMË". Poezia e këtij poeti, vjen si zjarr vullkanik që i del nga shpirti në vite; e si rrjedhojë i kësaj ai "Puthet" diku nëpër shtigjet e jetës, bashkë me kujtimet fjalët i kthen në vargje, e poezia bëhet këngë JETE! Te poezia e këtij poeti, lexuesi do gjejë shumë piktakime jetësore, e si rrjedhojë e kësaj do ti duket vetja sikur udhëton bashkë me atë drejtë pavdekësisë. Në këndvështrimin tonë letrar analitik, në tërësinë e gjithë poezive të paraqitura nga ky poet, të bie në syrin "magjik" sinteza florishente e vetës së parë e mënyrës e të shkruarit, që do të thotë se poeti është vetvetja, ai shpreh botën e tij të brendshme, e cila u bashkangjitet si rruaza gjaku çdo varg edhe njerëzve të tjerë në përgjithësi, por në veçanti lexuesit që "Dashurojnë" poezinë. Poezitë kanë dashuri, mall, dhimbje....por edhe krenari që shprehin me forcën e fjalës vazhdimësinë e jetës! Ne mundëm të shkëpusim nga ky cikël, i cili përbëhet nga (37) poezi, këta tituj si : "Po të mos ishe ti", "Mall për babain", "Vitet ikin", "Thinjat", "Pulbardhat", "Shtëpia e vjetër", "Elegji për nënën", "Dua të këndoj" etj. Tek poezia "Po të mos ishe ti" poeti na paraqet një vargëzim të bukur me plot elegancë, sepse ai ka ditur të na sjellë pjalimin shpirtëror të skalitur në varg poetik letrar. Ai e shpreh duke sjellë këto sekuenca vargjesh:

" Po të mos ishe ti,
unë kurrë nuk do kisha shkruar!
Asnjë varg, asnjë poezi,
do kisha mbetur si një murg i vetmuar
mbyllur diku,

si një eremit në vetmi".

.....

‘ Dhe tani ngado që shkoj
një laps kam me vete,
shkruaj një varg, një strofë a një poezi!
Dhe të gjitha këto nuk do ishin,
nuk do mbeteshin gjurmë
asgjëkundi,
po të mos ishe ti!".

Kështu, poeti Kosovar Idriz Ismajli ia detikon vargut të poezisë gjithë qënien e tij, ajo është shprehja më e specifikuar, dhe ka besimin e plotë se poezia të lartëson e të përjetëson. Kjo është mëse e vërtetë, se letërsia të jap vendin e duhur në shoqëri, të përjetëson në breza duke lënë gjurmë JETE! Prandaj edhe libri ka marrë gjithë ëndrrat e këtij poeti të ri, duke na dhënë ne si lexues vëllimin e parë poetik me titullin ‘Gjurmë’, i cili është një liman i vërtetë i shkruar me një gjuhë të thjeshtë artistike, dhe si rrjedhojë ai do zërë vendin e tij që i takon në letërsinë shqipe. Ndërsa te poezitë ‘Mall për babain’, ‘Elegji për nënën’, poeti shpalos si pala e flamurit atë dashuri të madhe, por njëkohësisht edhe atë malldhimbje kujtimesh të cilat i qëndrojnë si kristale të ndritshme brenda kullës së shpirtit me plot dritë.

1 . Nga poezia ‘Mall për babain’

.....

‘ Kur bashkë me kosëtarë të tjerë, thirrje që nga larg
të ju sjellin një kënatë me ujë.
Ujë te ftohtë bilur,
e sa mall kam sot
sa mall,
kur dëgjoj cicërimën e zogjve buzë përroit,
e barin e pakositur
në livadh!...".

2. Apo ‘Elegji për nënën’

‘ Mblodhe puplat dhe si engjëll fluturove,
Fluturove,
lart në qiell !?

E Nuk prite që dallëndyshet të sjellin pranverën e sivjetme:
as qershia , lulet e para
t’i nxjerrë...! ”.

.....

3. Te poezia ‘Thinjat’ na paraqitet vetë poeti, ku thinjat i numërojnë vitet e tija. Ai plis i bardhë mbi krye që i ngjan borës së maleve , tregojnë atë

rrugëtim të vështirë të jetës së autorit, por ndjen njëkohësisht edhe aromën e luleve të gëzimeve e hidhërimeve që ka kaluar nëpër liqenin e kaltër të jetës. Dhe ja si e shpreh ai këtë me anën e vargjeve të poezisë te ky vëllim, më konkretisht:

‘‘ Thinjë e bardhë, diku në flokë
Sikur lé, gjurmë,
Apo ndoshta, tregon
Pjekuri
Nga sfidë e jetës, kaluar ndër vite
Me ndoj’ romancë
a dashuri!
Dhe...
Edhe po ti fshehësh
nuk i fsheh dot,
As me ngjyre e as me bojë,
E me vite do shtohen edhe te tjera
Në çdo Stinë,
Në çdo Kohë!’’.

Poeti Idriz Ismajli fle bashkë me ëndrrat eshe tek ajo shtëpi e vjetër ku ka lindur . Janë këto ëndrra jete, të cilat i japin frymëzim, i japin jetë, i sjellin kujtime,i falin dashuri pafund.....(!) Pikërisht, këtu fillon ai zgjim i largët nëpër vite; ng ku merr penën e shkruan në gjuhën e nënës, e bojë i bëhet qumshi saj,fjala e babait vargun ja bën të fortë si shkëmb,kurse shpirti i tyre ja bën vargun poezive DRITË DIELLI ! Prandaj, poezitë e këtij poeti, janë edhe këngë shpirti që do lexohen e këndohen si vetë jeta jonë duke lënë gjurmët e tija.Prandaj edhe poeti Kosovar na paraqet në këtë vëllim të këtij cikli poezinë me titullin ‘‘Dua të këndoj’’.

‘‘ Sot dua të këndoj
Te hedh brengat pas
Te shijoj këngën, natyrën, poezinë
Dua kaltërsinë e qiellit ta shijoj
E pse t’ua kemi lakmi
Zogjve
Që në çdo behar këndojnë...!.

Pra,, na mbetet për ti thënë poetit Idriz Ismajli suksese në rrugën e bukur të krijmtarisë letrare bashkë me librin me titull ‘‘Gjurmë’’ .Jeta jonë është poezi, por edhe këngë.Ky është lajtmotiv që na përcjell poeti në këtë vëllim poetik.

Në Dukat flisnin dashuritë njerëzore...

(Me rastin e 55 vjetorit të martesës të bashkëshortëve Vilhelme e Fitim Vranari Haxhiraj)

Ese

Një telefonatë më erdhi nga Vlora. Ishte data 8 gusht 2020. Kush do të ishte vallë!? E them këtë qysh në krye të kësaj ese jetësore, sepse në telefonin tim janë të shumtë miq e shokë nga e gjithë Shqipëria të cilët më telefonajnë shpeshherë, por komunikim tjetër është edhe ai nëpërmjet imelit e facebookut. Më pyesin për shëndetin, për punën e përditshme por...edhe për krijimet letrare. Telefonatës iu përgjigja pak me vonesë. Verifikova numrin e thirrjes. Ai ishte i një mikut tim nga qyteti i Vlorës. Nuk vonova, edhe unë i bëra thirrjen time. Pastaj, nga ana tjetër e telefonit më thotë: - "Po ku jeni more Xhevo! Si jeni me shëndet, familja?!...Po me pandeminë si po ja kaloni?". Edhe unë iu përgjigja duke i thënë se jemi mirë, por me pak strese...Na mungojnë takimet, bisedat, diskutimet si dikur, o mik! Sigurisht që po o mik i dashur, - më thotë Fitimi nga ana tjetër e telefonit. Pastaj vazhdon bisedën e më thotë: Më datën 10 gusht ora 9.30 minuta ju pres në Vlorë. Kisha edhe ftesa të tjera më parë nga Fitimi, por për arsye objektive i kisha refuzuar. Kjo ishte e treta, nuk thonë kotë "e treta e vërteta", dhe i them se do mundohem të vij me patjetër. Kështu vendosa e, në datën 10 gusht 2020, sëbashku me djalin tim u nisëm me makinën drejt qytetit të Vlorës. Por, merakun e Fitimit ishte i madh. Ai më telefononte herë pas here, si po ecte rrugëtimi duke na porositur që të kishim kujdes gjatë rrugës. Pas një pushimi të shkurtër në qytetin e Fierit, pasi aty pime një kafe me disa shokë të punës së djalit, u nisëm për në Vlorë. Ora po tregonte 9.15 minuta. Tek dy palmat, atje në qendër të qytetit na prishte Fitimi. Diku aty afër parkojmë makinën. Takojmë Fitimin, (sigurisht takim pandemie), dhe ai na fton drejt një lokali aty afër. Në një tavolinë ishte ulur bashkëshortja e Fitimit, Vilhelme bashkë me nipin Rainhard (djali i djalit).

- Po, ky kush është, - më pyet Vilhelmia?

- Lëre, mos pyet, i përgjigjet Fitimi. Megjithatë, po ta prezantoj: është i biri i Xhevos. Ajo u gëzua e nga emocionet kërkoi të ngrihej në këmbë për ta respektuar, i kërkoi të nipi për ti afruar patericën. Në këtë kohë ndërhyra unë, por pash se djali im u çua në këmbë dhe e falnderoj atë e Fitimin për mikpritjen. Më tutje po filmonte kameramani Isuf Lutaj, i cili na zuri në befasi duke na bërë filmimin e prezantimit. Nuk vonoj shumë, aty në tavolinë afrohet e takohet me ne djali i Fitimit. Prezantimet sipas zakonit, sigurisht i bëri i zoti i shtëpisë Fitim Haxhiraj. - Merr Vilhelmen e nipin, nisu me makinën drejt Dukatit, - i thotë Fitimi të birit. Na prisni aty sa të vijmë ne edhe të tjerët. Pas pak minutave, me makinën time, duke marrë edhe Isuf Lutaj, u nisëm për Dukat. Nga Vlora për në Dukat është 30 km. rrugë. Ishte një diell i fortë, bënte zakushi, por kondicioneri na ndihmoi në këtë rrugëtim të gjatë. Mendova për ndonjë promovim libri, por kisha gabuar.

- Dëgjo, Xhevo, - më thotë Fitimi. Ju kam bërë një surprizë juve e miqve të tjerë në këtë takim. Heshta!

- Sot kam festë familjare! Prandaj e mbajta sekret, do festojmë me miq e shokë 55 vjetorin e martesës sonë. Data 10 gusht është ditë simbolike për ne si bashkëshortë.

- U emocionava shumë, sa edhe dallgët e detit shpirtëror u bashkuan me gëzimin e kësaj feste familjare të mikut tonë të letrave. Telefonatat binin parreshtur gjatë rrugës, sepse nga Durrësi po vinin edhe miq të tjerë. Te kthesa e Dukatin ndalua disa minuta. Ndërsa Fitimi bisedonte me miqtë e tjerë të cilët vinin nga Durrësi. Ata me makinën e tyre na ndiqnin nga pas. Një komunikim i tillë, shpjegoi gjithçka. Që nga aty ne vështronim malet përreth, ku në shpatullat e tyre qëndronin kryelartë shtëpitë e gurta. Pas disa minutave, arrijmë te lokali që mbante mishkrimin “Dukati i Vjetër”. Psherëtimat e shekujve vijnë si zjarre të ndezura me plot dashuri mes malesh Dukatase. Ato të thonë me dallgë deti të bardha, “Miq të nderuar, jeni në zemrat tona si yjet në qiellin blu!”. Jo vetëm nga banorët e tij, por edhe nga ne vizitorët e ardhur për një vizitë sado të shkurtër në këtë fshat turistik, edhe gurët marrin jetë.

Edhe plagdhimbjet e shkrintares Vilhelme Vranari Haxhiraj, sot më 10 gusht 2020, kanë se çfarë të na thonë. Në fjalën e saj të shkurtër, por me polen si të luleve të kësaj treve mikpritëse të labërisë, të kristalta si burimet e Dukatit; lexohet qartë dashuria vllazërore për miqtë e ardhur enkas nga Durrësi. Plagdhimbjet e trupit të saj, në këtë takim “Manifest” të 55 vjetorit të martesës me Fitim Haxhiraj, marrin trajtën e zambakëve të bardhë, duke sfiduar edhe plagët e shpirtit të kohës gri moniste. Është një rrugëtim 55 vjeçar, i cili s’do ndalet kurrë. Bashkëshortët Fitim e Vilhelme Haxhiraj kanë ditur ta ndërtojnë jetën e tyre familjare me mund e sakrificë. Me “Heshtjen” intelektuale si dy meteor kanë ecur të sigurtë drejt sfidave jetësore. Një jetë e mbushur me shkrepëtima drite si të rrufeve të qiellit. Dhe kjo midis të djeshmes të shekullit që lamë pas, por edhe të këtij shekulli të XXI. Sfidat e kohëve kanë startuar te fjala plot kuptim e dritë dielli DASHURI NJERËZORE! Nuk janë pak, por 55 vjet bashkëshortë shëmbullorë, një familje solide, për tu marrë shëmbull edhe nga të tjerët. Pikërishtë, kjo ka ndikuar, që DASHURIA u ka buzëqeshur në çdo kohë. Sot ajo është bërë “Këngë” e këndohet, lexohet në thinjat e bardha të cilat numërojnë vitet e jetës bashkëshortore të tyre.

Koha ecën e s’ndalet drejtë shtigjeve të saj. Ajo lë pas gjurmët e kujtesës. – Janë shtigjet e jetës sonë 55 vjeçare, ku në çdo hap që kemi hedhur si bashkëshortë, na është dashur që gjurmëve të lëmë pas veç dashurit njerëzore, - na thotë në këtë drekë - feste familjare Fitim Haxhiraj. Tavolinat ishin shtruar për merak e në sikron me njëra-tjetrën, duke ruajtur distancën. Rregullat janë rregulla e duhen zbatuar ndaj coronavirusit, nuk i thonë shaka, foli një nga miqtë i cili u ul në një karrige. Ai ishte miku i mikut tonë Fitim e Vilhelme Haxhiraj. Si u ulëm të gjithë në vendet, gotën e parë sipas traditës e ngriti Fitimi. Pas tij Vilhelmia, e kështu me radhë duke i uruar 55 vjetorin e martesës bashkëshortëve Fitim e Vilhelme. Kadri Tarelli lexon disa poezi nga libri i tij të titulluar “Kohë në vargje”. Gëzim e duartrokitje, sepse ishte vetë festa jubilarë e dy intelektualëve që festonin midis miqve e shokëve këtu në Dukatin e historisë e të kulturës. Dollinë e parë, sipas traditës e bëri Selman Hamiti, ishte me bashkëshorten Miroshë Hamiti, miku i Fitimit nga fshati Dukat. Kujtimet më fluturuanë shumë vite pas. E pyes Selmanin, për një shokun tim të vjetër i cili kishte punuar si mjek bashkë me të shoqen në fshatin tim Leskovë, Zhepë, Gurrazes, Çorrotat, e Çerricë, në zonën tomorricë të Skraparit. E ka emrin Lefter Kulluri. A e njihni se nga Dukati është!? – Po, më tha. Këtu në Dukat e ka shtëpinë. - Kam shumë respekt, i bëj të fala nga unë, - i them Selmanit. E shoqja dëgjonte me vëmendje bisedën tonë. - Ore

mik, e kam mik shtëpie, vazhdova bisedën unë. Ndërkaq, të gjithë sa njerëz ishin në tavolinat ulur, por edhe të tjerë rreth nesh, po ndëgjonin dialogun që po bëja me Selmanin. Merr gotën e ngrë një dolli tjetër. Kjo ishte për mikun nga Leskova e Skraparit, - thotë Selmani. – E shikon o mik, i drejtohet Fitimit e Vilhelmes, shoku e miku yt, është edhe miku im. Lefterin e kam kushëri, djalë hallo, o Xhevo ! Ndjeva emocione të dyfishtë.Më pas ndez atmosferën duke recituar poezi poetja Merita Thartori. Herë pas here, Fitimi çohet në këmbë e ngrinte shëndete për miqtë e ardhur nga Durrësi. Po kështu edhe Vilhelmia. Ngritën shëndete me radhë,për Kadri Tarellin,Shpendi Topollaj, Merita Thartori, (e cila ishte ma bashkëshortin), Xhevahir Cirongu (kishte ardhur me të birin). Mbas Selmanit, dollinë e dytë e bën Kadri Tarelli. – Të gjeta o Xhevo, më drejtohet mua Kadriu. –Edhe unë të prita, ia ktheva aty për aty dollibashit. Kadriu këtë dolli e bëri siç e donte zakoni, por edhe festa familjare, 55 vjetori martesor i miqëve tanë. Si mbaron dollinë Kadriu, nga çanta Shpendi Topollaj nxjerr disa libra e ja dhuron shkrimtares Vilhelme. Midis tyre ishte edhe libri me titullin “Ata ishin njerëz” dramë. Po kështu edhe Xhevahiri u jep si dhuratë librin me titull “Udhë në kohë...”. Sa shumë emocione! - E ku ka më bukur, na bëtë të rinj si dikur, kjo do mbetet një ditë tjetër e shënuar e jetës sonë, - thotë Fitimi. Nga gëzimi , si një djalë i ri çohet në këmbë e reciton disa vargje të një poezie.Por , s’vazhdon deri në fund recitimin, sepse lotët i “mbulojnë” sytë e në buzë ndriçonin si diamante , ku dashuria për jetën rrëfente historinë e saj. Hedh shikimin te nipi Rainhard, i cili po e fotografonte, e sërish fytyra i buzëqeshi si vetë dielli.Na preku të gjithëve kjo skenë, saqë edhe ne padashur derdhëm pika loti. Ishin lot gëzimi të kësaj feste të bukur familjare e 55 vjetorit të dy miqëve tanë Fitim e Vilhelme Vranari Haxhiraj. Ndërsa Isuf Lutaj na ndiqte me kamrën e tij në të gjitha detajet e këtij aktiviteti miqësor. Aty u bënë edhe foto të ndryshme.Mbasdite von u nisëm drejt Vlorës.Kurse miqtë morën rrugën e kthimit për në Durrës.

Të ecësh mbi gjurmët e veta, duke lënë gjurmë mirësie tek të tjerët. Vlerëso dhe çmoji njerëzit largpamës, intelektualë e guximtarë,thur vargje kënge për atdheun, për heronjtë e kombit, duaje vendlindjen,familjen, njerëzit që të respektojnë pa interes, mikun e vjetër mos e harro kurrë, të këqiat e shoqërisë njerëzore largoi nga vetja, respekto familjen e madhe të dashurisë njerëzore, sepse kështu ke ngritur deri në qiell diellin e shpirtit tënd. Ke ndërtuar shpirtin me gurë xehori , e cila afron dashuri njerëzore e thur gjerdanin e jetës së miqësisë së vërtetë që ndriçon si dielli pranveror e puthet si vala e detit në shkëmb edhe kur ne largohemi nga kjo jetë. Pra,dashuria njerëzore ka me vete tharmin e jetës së Pavdekësisë !?

Vërtetë në Dukat flisnin dashuritë njerëzore !

Vlorë, Dukat dt. 10 Gusht 2020



Nga e majta në të djathtë: Rainhard Vranari Haxhiraj, Miroshë Hamiti, Vilhelme Vranari Haxhiraj, Selman Hamiti. Fitim Haxhiraj (nga pas). Foto Xh. Cirongu





Nga e majta në të djathtë: M. Hamiti, Merita Thartori





Nga e majta në të djathtë: Shpendi Topollaj, Xhevahir Cirongu, Kadri Tarelli.

Foto Xh. Cirongu, Dukat 10 Gusht 2020

Libri poetik “Eci mbi një fije shprese” pasqyron shpirtin e kohës që jetojmë

Duke hedhur një vështrim të përgjithshëm lexushmërie poezive të autorit Kujtim Mateli, para syve m'u shfaqën lisat e Përmetit, ujrat e burimeve të asaj ane, kënga e valëve të lumit Vjosë, e mbi të gjitha Frashëri e rilindasve të kombit tonë! Udhëtoj nëpër histori! Ajo më shfaqet si një flakadan në memorien time, ku në damarët e atdheut është shkruar me gërma të arta fjala Liri! Por, që të arrihej deri këtu, u desh shumë sakrificë e vetmohim. Mendimi e fjala e poetit tonë kombëtar Naim Frashëri, bëri që me vargjet e shkruara prej tij në poemën “Bagëti e bujqësi”, zgjoi ndjenjat tona kombëtare të dashurisë për atdheun. E bëra këtë parantezë stacionale, sepse poeti Kujtim Mateli, pas vëllimit të parë poetik “Kur mendon për të tjerët”, na sjell librin e dytë poetik me titull “Eci mbi një fije shprese”. Është ajo shpresëdritë që na vjen qysh nga Rilindasit tanë deri më sot; si një flakadan e ndezur si ngjyrat e gjetheve të pemëve të vjeshtës, e si rrjedhë na fton të gjithëve për te lëmi i grunjtë të fjalës poetike që mbahet për çdo vit “Ditët e Naimit në Përmet”. Poeti Kujtim Mateli, duke qenë edhe biri i kësaj treve, sa me tradita atdhetare, patriotike, por edhe letrare, e ngacmon ajo ndjenjë e dëshirë që të hedhi në copa letre për tek blloku i tij vargje poetike. Ai nuk shkëputet dot për asnjë çast nga realiteti i jetës sonë, prandaj si e tillë kjo e fundit i ngacmon ndërgjegjen dhe brenda shpirtit “mbjell” polenin e frymëzimit poetik. Vëllimi poetik është i ndarë në pesë kapituj. Në çdo kapitull lexuesi do gjejë atë fije shprese për jetën, mendimin filozofik, fjalën e gdhendur artistikisht letrar, por edhe metafoën e krahasimet letrare, të cilat u japin frymarrje e oksigjen poezive tërësore të këtij libri. Qysh në titullin e librit, i cili të bën për vete sapo e lexon atë “Eci mbi një fije shprese”, të vë në mendime, rrokesh me vargun ku ai është me rimë, pastaj gjen vargun e thyer, e prap ngjitesh te lisat e këput gjethet e tyre nëpër degë. Pra, poezia e këtij poeti, është sa e thjeshtë në të lexuar, po aq e atdhetare në të kuptuar; saqë kur bashkohen të dyja ato formëzjnë fjalën poetike letrare me bukurinë e saj, na japin forcën filozofike me plotë mesazhe për tek lexuesi, si hekuri që rrihet në kuthrën e frakëtarit të hekurpunuesit. Tek poezia “Sythat e mendimit” duket qartazi se poeti ndalet në radhë të parë për tek ai mendim njerëzor, sepse si qenie njerëzore që jemi na duhet të reflektojmë drejt e të përcjellim shoqërisë sonë, në tërsinë e saj mendimin pozitiv, me qëllim që ai ti shërbejë kësaj të fundit për përparim e zhvillim. Poeti i mban fort pas vetes ato thërmija toke e shkëmbi, oshëtimat e ujrave të kristalta të burimeve, bukurinë e lëndinave ku rriten lulet shumëngjyrshë, këngën e zogjve të cilët ia marrin këngës së jetës nëpër pemët, pra gjithçka që na rrethon ...Dhe me penën e krijuesit autori di ta thuri vargun poetik, si rrjedhë i këtyre dukurive i çelin sythat e mendimit e marrin udhën e tyre tek ajo fije bari bari ku dëgjohet lehtë fëshfërima e shpresave të jetës sonë. Pra, mendimi bëhet njëjsh me buqetën e vargjeve të poezisë. Po e konkretizojmë me vargjet e poezisë “Sythat e mendimit”,

“Koha lëviz para syve tanë,

Para kafes pimë me të dashurit e zemrës,

Para tavolinës bisedat çelin sythat e mendimit.

Disa ngjarje i shohim

Nuk i fshihen dot dritës së mëngjesit;...”

Pra, poeti Kujtim ecën paralelisht me kohën, por ai kthen kokën edhe pas në kohë, sepse pa ditur të djeshmen s'mund të reflektojmë për të sotmen e të ardhemen që

do shkelim në gjurmët e saj enigmatike. Ndërsa tek poezia “të prisja...” poet derdh pa rezervë dashuritë e bekuara, për njerëzit, atdhun, vendlindjen Mazhan, për heronjtë e atdhut etj. Simbolika është e qartë, saqë shpirti i vetë poetit qëndron varur edhe nëpër degët e thara të lisave, por vazhdimësinë e jetës e gjen atje tek ajo hardhi e prerë që ngjall kujtime dhe i flet heshtjes mesjetare, se dashuritë kanë bekimin e vetë të Perëndisë, saqë rri në pritje që të vijë dikush...! Pra Dashuria e Jetës!

...Ecim mbi atë fije shprese! Shpresat e jetës çelin si lulet e Majit poetik nga ku merr jetë edhe vetë libri i këtij autori. Janë poetët që thurin vargje të këngës së jetës sonë, pikërisht i bashkon takimi i përvitshëm fjala poetike që zhvillohet më 25 Maj në Frashërin me yje ndezur plot dritë në “Ditën e Naimit” në Përmet. Poeti bën thirrjen e tij që i buron nga shpirti se atdheun s’duhet ta braktisim kurrë, sepse ai që e braktisë, një ditë do të dëshpërohet nga bora e dimrit ngricakeq.

Megjithatë lajtmotivi i poetit Kujtim Mateli është i qartë, i fluturojnë ëndrrat si dallëndyshet nëpër qiellin e kaltër bashkë me shpresat, duke i përtypur ato me fatet njerëzore...,

” Adresa të vjetra mbi fletë të zverdhura,
Nofullat e kohës kishin përtypur fate njerëzish.

Ende ngulmoj me shpresë

Të gjej ndonjë shteg,

T`më çojë tek shpirti i dëshiruar

Që natën trazohet nga ëndrrat”.

Ndërsa tek cikli i tretë e të katërtin, poeti sintetizon atë optimizëm të shpresave të cilat marrin udhën e jetës e thyejnë udhëkryqet e kohës tinxare. Atdheu është dhimbje, na thotë poeti Kujtim . Dhe kjo është plotësisht e vërtetë. Tek atdheu, te vendlindja lindin ëndrrat, na shfaqen si një ekran para syve në çdo hap të jetës sonë....Dhe vargjet e poezisë me titull “Atdheu” jep drithërima dhimje, por edhe shpresë si rrezet e diellit për dashurin ndaj atdheut.

“Atdheu është fjala,

Kurorë e të gjitha fjalëve,

Përjetësinë ia gjen në blerime malesh”.

...Por, nuk shterojnë lotët e vajzës së vogël të cilës i dhimbset atdheu, saqë gurët po ia rrukullisin të marrët në kërkim të një muri ku kërkon të vari pallton e lagur nga shirat e kohëve, pra vargjet e poezisë “Në këto troje” e shprehin me dhimbje këtë fenomen, saqë nesër do jetë von për ta rikuperuar të keqen.

Ujvarat e shpirtit të poetit rrjedhin në pafundësi. Ato dalin nga skutat e fshehura të shpireti e memories të këtij krijuesi, e marrin udhëtimin e tyre në brinja malesh duke ndezur zjarre bashkë me barinjte, fjala shkruhet në pllaka guri, bojë i bëhet qumshti i bardhë i bagëtive, vargu i poetit rend pas mëzit të vogël të pelës, fladi i erërave poetike takon stërgjyshërit në fushëbeteja....dhe u ngajmë në të ecur, -thotë poeti Kujtim Mateli. Sa bukur! E ku ka më bukur të ecësh në gjurmët e stërgjyshëve tanë!? Një tjetër poezi të bën për vete sapo e lexon atë. E themi këtë, sepse është një gjetje e goditur artistikisht letrare. Poezia “Këmisha e prillit” i plotëson gjithë parametrat letrare. Aty gjen pluhurën e kaltër të qiellit, lulet e prillit, agimet e ditës, fytyrën e një vajze, syrin e dashurisë së dritës, por edhe burbuqet e sapoçelura të prillit jetdhënës me atë këmish gjelbëror...! Konkretisht mbyllet me këto vargje:

“ Këputet ndonjë kopsë,

Dhe bie mbi fletoren me vija katrore

Duke thyer heshtjen e syrit,

Që kërkon mbi libra burimin e dritës”

Tërheqëse janë edhe poezitë “Porta e së nesërme”, ”Në agim të ditës”, “Mbesës sime”, ”Atdheu thinjet”, “Një kurorë lisi”, “Në vendlindjen e profetëve” etj. Te libri poetik ” Eci mbi një fije Shprese” lexuesi do gjejë gjithësinë e jetës, tallazet e shprezave, por edhe një klithje, një zë, liri, krenari, ku zogjtë shtegëtojnë horizonteve të atdhut e të kontineteve për të gjetur rrezet e ngrohta të diellit. Por, nuk mungojnë edhe këngët e kukuvajkave.... Letrat e lagura, konferenca e Londrës 1913, në tokën Dardane, shpionja e qëndisur në flamur, janë poezitë përmbyllëse të kapitullit të pestë të këtij vëllimi me titull “Eci mbi një fije shprese” të poetit Kujtim Mateli. Lexon vargjet e këtij libri e galeria e shpirtit të mbushet me oksigjenin e atdheut, të dashurisë për vendlindjen, takon shpresat e jetës e padashur fluturon hapësirave të universit të shpresave. Ashtu si jë gur meteori, poeti Kujtim Mateli prek çdo cep të atdheut tonë, që nga Tuzi, Plava Gucia, Dardania, Vardari.Nga Arta e Pirros, gjer në majat e Vetëtimës, në Tamarë, e fushëbetejat e Krujës, tek malet e Dibrës e Matit ku jehon zëri i Lirisë!

Dhe e mbyllim këtë refleksion ndaj librit me poezi të poetit përmetar Kujtim Mateli me poezinë e titulluar “Shqiponja”,

“ Shqiponja

Mbi çatinë e erërave,

I vetmi zog në fluturim!...

Shqiponjë e qiejve të kaltër,

Simbol i vendit tim”.

Poeti na përcjell bukuritë e jetës të cilat lundrojnë mbi një fije shprese, dhe reflektojnë dritë në pafundësi me forcën e fjalës artistike letrare të shkruar prej tij në këtë libër “Eci mbi një fije shprese”.

Le të udhëtojë vargu poetik i këtij libri si shqiponja drejt qiellit shpirtëror për te lexuesit ynë!

Durrës, mars 2020

Ese

Në “kurthin” e koronavirusit dhe marrdhënia njeri – natyrë ...!

Ka disa muaj që tashmë i gjithë njerëzimi në globin tonë po vuan nga “ethet” e virusit vdekjeprurës. Ky virus , i cili është ulur këmbëkryq në gjithë vendet e kombet në shkallë ndërkombëtare, krahas negavitetit të shëndetit të njeriut duke marrë deri tani mbi 260 mijë jetë në gjithë globin, tregoi edhe një herë se, njeru dhe shoqëria në tërsinë e saj, duhet të silllet me një dashuri për natyrën. Tashmë po dalin hipoteza të shumta duke thënë se virusin e përhapën kafshët siç përmendet lakuriqi natës apo minjtë, por shkojnë deri aty se mund të ketë dalë edhe nga një laborator.Këto dhe të tjera

hipoteza, të cilat po qarkullojnë nga rrethet shkencore – kërkimore për gjetjen e vaksinës kundër COVID-19, po dëshmon edhe një herë se sa të papërgatitur u gjend njerëzimi ndaj këtij virusi “armik” i cili gjunjëzoi tërë njerëzimin në këtë shekull të XXI. Me gjithë masat e marra nga rrethet kërkimore e shkencore botërore, por edhe masat drastike të qeverive në gjithë globin, virusi famkeq tronditi themelet e shoqërisë në botë. Pra, koronavirusi jo vetëm që ka marrë mbi 258 mijë jetë njerëzish në shkallë botërore deri më tani, por ai po thëllon krizën ekonomike globale, e cila kërkon një vëmendje të veçantë nga gjithë qeveritë e çdo vendi, sepse kjo pandemi, ka prekur gjithë sektorët e ekonomisë globale. Kjo pandemi na mësoi shumë gjëra se si duhet të sillemi ndaj “Nënës natyrë”, sepse lakmia e parasë në këtë kohë modernë e të tekologjisë së përparuar në gjithë sektorët e jetës, qëndrimi i faktorit njeri në marrdhënien me natyrën, ka qenë si “njerka” që shpërfill dashurinë e vërtetë, e si pasojë e kësaj njeriu harroi që është pjesë e jetës së pandarë të “Nënës natyrë!”.

Kjo dëshmoi edhe një herë, se aty ku smogu industrial, rrezatimet radioaktive, e të tjerë faktorë ndotës të natyrës nga vetë dora e njeriut, koronavirusi ishte i fuqishëm duke marrë mijra jetë njerëzish. Koronavirusi i dha një mësim akademik mbarë njerëzimit, por më shumë politikbërësve, qeverive, miliaderve, të cilët kështu e tutje të reflektojnë e të marrin inisiativa konkrete për të investuar te “Nëna” natyrë. Pa një natyrë të



shëndetshme, s'mund të ketë shëndet shoqëria njerëzore! Ngrohja globale, ndotja e atmosferës, shpërthimet në oqeanë, dete, ajër, rrezatimet radioaktive, ndotja e lumenjve, ushqimet jo bio, etj faktorë, ku prezent është faktori njeri, kanë prishur ekuilibrin jetësor në tokë, pra natyrë – njeri. Sa më e shëndetshme të jetë natyra, aq më i shëndosh do jetë vetë njeriu e tërë shoqëria njerëzore. Edhe vendi ynë Shqipëria u prek nga ky virus, ku tashmë me masat e marra nga qeveria, por

edhe me qëndrimin korrekt të vetndërgjegjësimit të njerëzve, ndikoi e po ndikon pozitivisht ndaj virusit “armik”. Bluzat e bardha qëndruan e po qëndrojnë në frontin e parë në përballimin e kësaj fatkeqësie natyrale, bashkë me strukturat e tjera shtetërore për t'u kthyerë sa më shpejtë jetës normale. Mjekët shqipëtarë dhanë kontributin e tyre edhe në shtetin fqinj italianë në përballimin e situatës nga virusi covid – 19. Por qeveritë, strukturat gjithpërfshirëse të saj duhet të tregohen të kujdesshme ndaj pasojave negative të “virusit” ekonomik, sepse në këtë mënyrë i vihet “freri” varfërisë ekonomike pendamike të izolimit, për të rritur dalngadalë parametrat tërësorë ekonomik të vendeve. Pra, faktori i marrdhënive të ekuilibruara njeri- natyrë, është çelsi i gjithë zhvillimit jetësor i shoqërisë njerëzore. Pa këtë marrdhënie e qëndrim real ndaj natyrës, të cilën ne e mësuam edhe nga Covid-19, njerëzimi nuk do bjerë në “kurthin” e pendamisë ekonomike globale. “Vaksina” më e shëndetshme është qëndrimi e sjellja e njeriut ndaj natyrës.

Durrës, 06.05.2020

Poezia e Rifat Plakut lexohet si vetë pranvera

Refleksion

Këto ditë u njoha më nga afër me librin me poezi të autorit Rifat Plaku. Duke lexuar një e nga një poezitë e këtij vëllimi, dhe si e mbarova së lexuari edhe poezinë e fundit, atëherë ndjeva aromën e " luleve të shpirtit" aq kuptimplot si titulli e lulet që pasqyron autori në ballinën e librit. Mesa duket, poeti ynë Rifat Plaku, tek ky libër me poezi ka derdhur mjaltin e dashurisë së ndjenjave shpirtërore, dhe me shumë fines e tharm poetik krijues na dhuron ne e botës letrare vargje të spikatura të cilat mbeten në memorjen e çdo lexuesi.

Po të vërejmë me kujdes, dhe me syrin e letrarit, poezia e këtij krijuesi paraqitet e thjeshtë në dukje, por duke reflektuar në gamën e tyre krijuese, ajo vjen si një gongxe me shumë ngjyra e planizuar në formën dhe në përmbajtjen e tematikave të tyre. Shiptri krijues dhe ai letrar, të rrok në lexushmëri, sepse aty është vetë poeti, është natyra që na rrethon, janë njerëzit e zemrës e shoqëria njerëzore, por aty do gjesh edhe histori e kulturë, por poeti s'mund të rrijë larg edhe shqetësimeve sociale të shoqërisë sonë. Pra, duke udhëtuar e lexuar poezitë e poetit Rifat Plaku, padashur kemi prekur edhe një pjesë të jetës sonë, si rrjedhojë kjo e bën lexuesin për ti shkuar deri në fund lexueshmërisë së librit me titullin doethënës "Pranverë gjithmonë ti mbete". Siç e theksuam edhe më lartë, këto nëndarje, të cilat reflektohen në 54 poezitë e këtij vëllimi, plotësojnë më së miri gjithë lëmin krijues letrar e atë artistik.

Në reflektimin tonë , poezitë për natyrën në këtë vëllim poetik ato zënë një vend të planit të parë, mesa duket poeti aty ka gjetjen e tij frymëzuese, dhe si rrjedhojë i kësaj ai na sjell edhe poezitë që janë përfshirë në këtë libër. Na po sjellim disa tituj si: "Kjo është pranverë", "Trëndafilat", "Ky mars", "Prag vjeshte", "Një ditë maji", "Lule Mimizës", "Vajton Kodra Vilë " etj. Në planin e dytë gjejmë poezitë me motive të karakterit epiko-historike, ku autori e shpreh fuqishëm me anën e vargut te poezitë "1 Nëntori 1912", "Për Skënderbeun", "Proncesha Ilire", etj. Por në këtë vëllim nuk mungojnë edhe poezitë sociale, midis të tjerash po përmendim poezinë me titull "Pensionistët". Një vend të rëndësishëm janë edhe poezitë për njerëzit e zemrës, ku respekti e dashuria del nga vullkani i dashurisë së shpirtit të poetit. Poezitë kanë mesazhe të qarta, sepse aty lexuesi gjen thjeshtësinë e fjalës letrare e cila të frymëzon e ngroh shpirtin. Këto motive i gjejmë tek poezitë me titull "Mikut tim Dhimitrit", "Mbesës sime të parë", por edhe në poezitë "Babait " ,

“Nënat”. etj. Në mbyllje të këtij refleksioni të poezive të autorit Rifat Plaku, po sjellim vargjet e poezisë me titullin “ Pulbardha e shpirtit”. Më konkretisht:

Pulbardha e shpirtit tundi krahët

Mbi detin e gjerë fluturoi,

Zjarrit të mallit kërkon t'i shuaj flakët

Me zemrën mes dallgëve qëndroi.

Shëndet e suksese mik e shoku jonë Rifat Plaku!

Durrës, 10 Mars 2020

Reportazh

Tomorrica nëpër shekuj dhe tomorricarët që apelojnë...

Kush ka udhëtuar drejt skraparit, duke lënë pas qytetin Çorovodë e merr rrugën majtas që të çon për në Qafën e Dëvririt, para syve të shpaloset si në ekran tomorrica me gjithë fshatrat e saj të cilët janë vendosur si në dy krahët e “Pëllumbit” ku në mes tyre i ndahen lumi me të njëjtin emër: Lumi Tomorricë. Theksojmë se dikur ky lum me një gjatësi prej 60 km, thonë se quhej “Dodona” e “Puthet me lumin Devoll nën këmbët e fshatit Nartë. Natyra i ka dhënë bukurinë hyjnore kësaj lugine piktoreske, saqë miku apo vizitorin e magjepsin dhe i thonë “bujrum” në vatrat tona. Dhe kjo është mëse e vërtetë, e tomorricarët me të drtejtë kanë seç të tregojnë edhe sot në shekullin e 21-të. Tomorrica deri në vitet’90 të shekullit që lam pas kishte rreth 15 mijë banorë. Transformimet gjeopolitike dhe socialshoqërore sollën atë ndryshim befasues, një heshtje e trishtueshme ka rënë në gjithë fshatrat e kësaj zone, por ajo heshtje e

“frikshme” pas 28 vitesh po zgjon e thërret ndjenjat e tomorricarëve për t’u kthyer në vendlindjen e tyre. Porta e vetme hyrse që lidh me rrugë automobilistike me zonën e tomorricës është gryka e Dëvrisë. Pëllëmbë e histori gjen në çdo kohë në këtë trevë perlë që gjendet në kërthizë të Shqipërisë së jugut. Tomorrica e Zezë përbëhet nga fshatrat: Grëmshi historik i kryearkitektit të Perandorisë Osmane, Mimar Kasëmit; Gjokovica, fshati i mjaltit, Kuçi, Barçi, Floqi, Rehova, Vishanji, Straficka, Greva, Kovaçanji, Postena, Leskova, Zhepa, Çerrica, Gurrazezi, Çorotati, Burranji, Dobrenji, dhe vazhdon ... Simani, Lemnusha, Vidhani, Kotka, Ermenji, Shërmbëdhenji, Bletza, Kullolli, Narta.

Ndërsa, Tomorrica Bardhë: Përrenjasi, Mëlova, Zaloshnja, Davidhi, Gjerbësi, Ujaniku, Gradeci, Luadhi, Shpatanji, Trebla, Duncka, Rromasi, Osnati Tërrovë... Kërpicë, Bregas.



Mali Tomorr

Vendndodhja e luginës, vështrim i shkurtër historik...

Gjeografikisht Tomorrica ndodhet në Shqipërinë e jugut. Ka

një shtrirje gjeografike dhe entografike midis malit Tomorr

(nga ku ka marrë edhe emrin), Qafa e Kulmakut,

Qafa e Dardhës, në jugperndim, Koshnica, Qafa e Gjarprit në veri,

Ostrovica në lindje, Qafa e Dëvrrit në jug.

.Për zonën e Tomorricës, gryka e Dëvrrit është nyja lidhse dhe porta e vetme që lidh atë me qytetin e Çorovodës dhe zonën tjetër, Skrapar.

Bën pjesë në rrethin Skrapar.

Është në prefekturë e Beratit. Kufizohet me rrethin Gramsh, Korçë e Berat.

Tomorrica formon një luginë të gjerë e cila përshkruhet nga lumi me të njëjtin emër, lumi I Tomorricës. Ky lum e ndan në dy pjesë: Pjesa e Tomorrit nga njëra anë dhe tjetra Qafa e Gjarprit nga ana tjetër. Përbëhet tërësisht nga shkëmbinj flishorë të butë të bardhë e gri nga ana tjetër, të cilët janë të gërryeshëm në punim. Relievi i Tomorricës është kodrinor – malor i thyer me një numër përrenjesh e përoskash me brazda gërryerjesh në vazhdim.

Lugina e Tomorricës ka qënë e populluar qysh në lashtësi.

Ajo ka në rregjistrat e kohëve të rregjistruar 39 fshatra. Fshati Grëmsh dikur ka qënë qytet. Ka patur 400 shtëpi, 18 dyqane e një xhami.

Nga Grëmshi i Tomorricës është edhe origjina e patriotëve edhe rilindsave tanë të Frashllinjëve.

Toka e bukës është e pakët, por prodhuese. Bimësia është natyrale, por edhe e kultivuar nga vetë dora e njerzëve punëdashës të Tomorricarëve.

Tomorrica njihet qysh në lashtësi për zhvillimin e jetës.

Në zonën e Tomorricës janë vërtetuar disa pika arkeologjike.

Nëpërmjet ekspeditave të kryera nga studuesi Lutfim Ylli në luginën e Tomorricës.

Dëshmitë më të hershme arkologjike i takojnë

periudhës së hershme të hekurit në shekujt XII - V p.e.r.

Gjurme të kësaj periudhe janë gjetur në fshatrat Strafickë,

Çerricë, Përrenjas e Leskovë, Davidh.

Në këtë zonë vihen re edhe kultura e qytetimit Ilir

. Të cilat i përkasin shekullit V - I p.e.r.

Për këtë dëshmon gjetjet në shpellën e Tërrovës dhe kalaja

e Vidhanit me pozicionin e saj gjeografik.

Në teknikën e ndërtimit dhe materialin arkeologjik që

gjendet në të, përbën një ndërtim të realizuar në periudhën e antikitetit të vonë.

Prania e saj dëshmon edhe për një arter tregtar në luginën e Tomorricës.

Ajo merte anën e majtë të lumit Tomorricë. Rruga djathtas Osumit ndiqte interarin e mëposhtëm: Berat, Vodic, Karkanjos, Tomorr,

Qafa e Dardhës, Dunckë, Dobrenj, Qafa e Gurit të Prerë, Qafa e Kumbllës, Dushar, Protopapë, Voskopjë, Turan, Korçë.

Kjo rrugë përmendet në shumë dokumente mesjetare. Në një burim të muajit janar 1700-ës thuhet: "Banorët e Voskopojës, Vithkuqit e

Shipkës ankohen se kur pokalonin në vendin quajtur Guri i M'pretë në kuzanë e Tomorricës, disa vetë u kanë marrë mallin që e çonin për tregëti në Berat".

Vështrimi historik i saj të bën të ndalesh pak për të kuptuar më shumë e të njihesh sado pak me rrebeshet e shekujve të cilat janë të dukshme edhe sot. Krahina e Tomorricës duke qënë një vend strategjik, ajo ka njohur mbi trupin e saj disa lulëzimesh qytetrimi e kulture; megjithatë tomorricarët kanë ruajtur të paprekur dinjitetin e tyre. Jo vetëm brenda teritorit gjeografik, por edhe jashtë saj. Dokumentat na flasin qartazi për çdo kohë të cilat gjenden në arkivat e ndryshme. Ato vijnë si dëshmi të gjala e flasin për tomorricarët e tomorricën edhe sot e kësaj dite. Sipas shënimeve të Gjon Muzakës, para 500 vjetësh Tomorrica përbëhej prej 80 fshatrash, që përfshinte luginën e lumit Devoll, deri në Maliq të Korçës. Por pas vdekjes së Skënderbeut, shumë familje emigruan në Greqi dhe Itali. Sipas Çabejt emrat Gjerbës (Jerbës), Barç, Zhupë (Zhepë)

të Kalabrisë e kanë origjinën prej këtej. Deri në '12-ën nën administrimin turk, Tomorrica ka qenë kaza (nënprefekturë-rreth), e ndarë nga Skrapari. Dy Shëmbërdhenjtë, Narta, Kullolli, Sotira, Kushova, Dardha, Sulova, Jança, Delvëni, Patozi, Tunja, Duzha, Bregasi e të tjera fshatra të rrethit të Gramshit deri në vitin 1923 kanë qenë me Tomorricën dhe Skraparin. Fshatrat Kërpicë, Ermënj, Vidhan, Lemnushë, Kotkë dhe Sqimar (Siman) kaluan me rrethin e Gramshit në vitin 1949.

Çfarë kanë thënë për tomorricën?

Janë të shumtë ata njerëz të cilët kanë dhënë vlerësimet e tyre për luginën e tomorricës dhe tomorricarët, njerëz të thjeshtë e personalitet të fushave të ndryshme të të gjithave shkencave, vendas apo të huaj. Nuk është rastësi por realitet se para 300 vjetësh Evliah Çelebiu thotë se “nga Evropa mjekët e atëhershëm dërgonin pacientët e tyre në Tomorr , sepse barnat e këtij mali ishin shëruese...”, por edhe piktori i madh anglez Eduart Lir, para 160 vjet pikturon malin e shenjtë Tomorr e zonave përreth, dhe kjo vepër arti ngeli kryevepra e tij. Mal i shenjtë i tomorrit ka tërhequr shumë studiues e shkencarë qysh nga lashtësia e deri më sot nga e gjithë bota, një nga këta ka qenë Martin Lik Margaret Halcuk e Antiono Baldaci etj.



Një fotopamje e pjesshme nga Tomorrica

....Nga veprimtaria patriotike atdhetare

Veprimtaria patriotike e atdhetare e njerëzve tomorricarë janë një galeri mbushur me plot thesare të cilat flakadojnë nëpër shekuj , e si rrjedhojë ato janë pjesë e kultures historike e atdhetare e kombit tonë. Por ne do sjellim vetëm disa pika kulmore historike në këtë reportazh, për ti thënë lexuesit se duhet të njihemi sa më shumë me vlerat tona historike të popullit tonë. Konaku ka qenë qendra e zonës së tomorricës. Aty janë zhvilluar shumë kuvende të cilat kishin lidhje me fatet e kombit tonë. Jo më kot Sali Butka kishte dy çeta në Tomorricë që komandoheshin nga Dostllarët e Zaloshnjës,

Serveti dhe Mahmuti.Edhe sot e kësaj dite këndohet ajo këngë që kambetur në memorien e popullit të kësaj zone: “Në Konak thërret tellalli,/ thërret Sali Kapedani”... Fakte janë të shumta e domethënës që i shtohen masakrave barbare që grekërit kanë kryer edhe në zonën tomorricës e skrapar, me djegien, plaçkitjen deri në vrasjen e banorëve të kësaj krahine.Në luftën kundër andartëve grekë për mbrojtjen e trojeve shqiptare, në vitin 1914 mbetet i vrarë te Tre Urat e Përmetit edhe patrioti Razim Shabani nga Leskova e Tomorricës së Skraparit.Në vitin 1915 në Konak të Tomorricës u mbajt Kuvendi që i cili mori vendime të rëndësishme për të luftuar kundër shovinistëve grekë që masakronin popullin në fshatrat e zonës së Korçës e të Kolonjës.Në këtë Kuvend mori pjesë edhe patrioti Sali Butka.Pas këtij Kuvendi u krijuan dy çeta komitësh:Njëra në Kuç me komandant Nebi Alimadhi,që veproi me luftimet e saj në Panarit të Korçës, dhe tjetra në Vidhan me komandant Zenel Braçi,që operonte në mbrojtjen e Voskopojës.

...Ishte viti 1923,ku Fan Noli qëndron një natë në tomorricë,pikërisht në fshatin Dobrenj.Pasi kthehet në Tiranë,ai bën këtë debat në Parlamentin shqiptar të asaj kohe:“*Sa për Shqipërinë e këtushme, kam parë rasën të udhëtoj nga Dobreja në Voskopojë 25 orë me kalë dhe kudo kam parë katunde të prishura...Patriotizmi dhe sakrificat e këtij populli nuk është kursyer aspak*”.Është për t'u theksuar se fshati Shërbërdhenj, sot Skënderbegas, e ka marrë ngaqë aty ka qenë me luftëtarët heroit ynë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu.

Çeta e plakut të maleve Mestan Ujaniku

.... Bashkë me shumë patriotë të tjerë nga Berati dhe Skrapari krijon një çetë me 15 vetë, ku merr edhe djemtë dhe kushërinjtë e tij. Kjo çetë e vogël e krijuar që në vitin 1941 është bërthama e çetës së madhe që u krijua më 14 mars të vitit 1942, që u quajt Çeta Plakë e Skraparit dhe ku komandant u caktua Mestan Ujaniku.Në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare në çetën morën pjesë edhe dy luftëtarë të shquar me përmasa kombëtare, Heroin e Popullit Ramiz Aranitasin nga Mallakastri dhe Gjini Markun nga Mirëdita, të cilët populli i Skraparit dhe i Tomorricës i deshi dhe i nderon si bijtë e tij. Populli i kësaj ane shquhet për besnikëri e trimëri.

Poetët Dritëro Agolli e Ali Podrimja....

...Ishte muaji gusht i vitit 1994,poeti Ali Podrimja vinte nga Prishtina si pelegrin ai u befasua, thajse mbeti pa gojë, kur dëgjoi vargjet e tij të recituara nga një mësuese atje, në Tomorr !

....Me atë famë që mori në vitet '70-'80 me zërin e tij brilant, Artisti i Popullit Demir Zyko, domosdo që do të kishte miq të shumtë,gazetarë, shkrimtarë, regjisorë, skenaristë, por më i veçanti, që bujti disa herë në shtëpinë e tij dhe që u bënë miq të vërtetë, ishte Dritëro Agolli.

Tomorrica e tomorricarët e shekullit 21-të apelojnë!....

Sot krahina e tomorricës përbëhet nga 31 fshatra, e cila ndahet në dy pjesë : veri-juglindje nga lumi Tomorricë. Ka dy qendra Administrative: Gjerbës e Zhepë.Nga rreth 15 mijë banorë që kishte deri në vitet '90, sot është rrudhur në 2250 banorë.Lugina e

tomorricës shtrihet në gjërsinë gjeografike duke filluar nga 12 m mbi nivelin e detit e ngjitet deri në 2480 m lartësi.(mali tomorr). Ka një bimës shumë degëshe që fillon nga shkurret mesdhetare si mareja, ilqe, shkoza, frashëri, arra e lajthia,lisi,pisha e zezë, ahu, etj,deri në skajin alpin. Rriten gjithë bimët bujqësore, gruri, misëri, thekra etj.Por edhe pemtaria,vreshtaria, blegtoria e bletaria. (Theksojmë se në mesjetë sipas dokumentave të kohës në tomorricë ishin 66 dy vresht) Kushtet gjeografike natyrore i kanë dhënë mundësi jetese në shekuj banorëve të kësaj lugine,të cilët kanë përballuar me dinjitet rrebeshet e armiqtëve e të natyrës.Para viteve '90, kishte spital, 4 shkolla të mesme, çdo fshat shkollë fillore, 7 shkolla 8 vjeçare, 4 SMT. 4 qendra shëndetsore, Linjë autobusi për udhëtarët, etj.Kurse sot në shekullin e 21 -të të gjitha këto kanë “avulluar” bashkë me shpërbërjen e disa fshatrave që u ka mbetur vetëm emiri i tyre!Migrimi dhe emigrimi e tkurri këtë zonë me shumë vlera si në gjithë Shqipërinë, saqë shtëpitë e fshatrave “heshtin e rënkojnë” për njerëzit e tyre që morën arratinë.Ka shumë për të thënë.....ndaj tomorricarët duke filluar nga Gjogovica e Narta,Përrenjasi e Kërpica bëjnë apel ndaj qeverisë që të kthejnë sytë që të investohet edhe për luginën e vlerave kombëtare të tomorricës.Duke mbajtur mbi shpatull parkun kombëtar të malit Tomorr, Ujvarat e Kërpicës, Shpella ilire në Tërrovë, Guri i Prerë (monument kulture), Kalaja e Vidhanit,Qafa e Gjarpërit,Grëmshi,origjina e vëllezërve Abdyl, Sami, Naim Frashëri,apo kultet fetare ...Teqja e Kulmakut etj, Janë të shumtë tomorricarë e skraparasë që jatojnë në qytete Durrës, Tiranë, Korçë,Lushnje, Vlorë Berat,Kuçovë etj.Ka ardhur koha se duhet investuar për lidhjen me rrugë automobilistike qyteti Gramsh,qyteti Maliq në Korçë me qytetin Çorovodë, duke kaluar rruga nëpër luginën e tomorricës.Jo vetëm kaq, por edhe lidhjen nga Qafa e Dardhës rruga të çon shkurt për në Berat.Janë të shumtë njerëzit e kësaj zonë, pavarisisht se ku banojnë sot, në shqipëri apo jashtë në vendet e tjera si Baki e Neim Zhuri, Yda Ismaili, Vjollca e Sajmir Ajasllari, Dritëro , Ilir e Fatmir Ajasllari,Neritan Hajdari, Idari Carkanji,Nsibi Çipi,Skënder Bako,Luan Mollaj,Riza Nuhu, Bashkim Hysi,Kujtim Kajo etj, thonë se infrastruktura rrugore na pengon, po të kemi rrugë, do kthehemi në vendlindjen tonë për të investuar atje.Ndërtimi lidhëse i dy rrugëve në dy krahët e lumit që lidh fshatrat e gjithë zonës së tomorricës; do sillte zhvillim e progress për banorët e dy Qëndrave Administrative Gjerbës e Zhepë.Nyjet lidhëse me rrugë automobilistike drejt qyteteve Gramsh, Maliq, Korçë, Berat,është një apel i zërit të fuqishëm qytetar i gjithë banorëve të zonave Tomorricë,Sulovë,Vërçë ,Opar,Gorë,Nahije të Beratit,Policanit e Skraparit, sepse kështu vendlindja na pret në gjirin e saj.Këtë kërkon edhe shoqata “Zaloshnja” e cila duhet falnderuar e përkrahur nga ne të gjithë, sepse ajo na bën thirrjen sublime për t’u kthyer te vendlindja jonë.

Durrës, 24 Shkurt 2019

Partizan Bako, me rastin e 30 vjetorit

(Dëshmorittë atdheut Partizan Bako, me rastin e 30 vjetorit)

Përkujtimore

Nën këmbët e malit Koshnicë shtrihet Burranji i bukur, i cili ndodhet në luginën tomorricë të rrethit Skrapar. Fisi Bako, që banon prej shekujsh në këtë fshat, njihet gjerësisht si punëtorë e të lidhur fort me bagëtinë e tokën. Por, shquhen edhe si atdhetarë e intelektualë të zot. Të besës e fjalë ngrohtë, të dashur e të respektuar ndaj bashkëfshatarëve e gjithë njerëzve të zonës e më tej. Kushdo që kalonte për rrugë të gjatë drejtë Sulovës, Beratit apo Korçës, do kthehet e do të pinte një godë ujë të ftohtë! Portat e shtëpive të fisit Bako, qëndronin gjithënjë ditë e natë të hapura. Rrugëtari do merrte me vete edhe një copë bukë e djath me vete. Banorët e fshatit Burranj dhe fisi Bako kanë luftuar për liri e pavarësi. Në luftën e dytë botërore morën pjesë masivisht dhe u bashkuan me Lëvizjen nacional - çlirimtare. Nga ky fis, ra dëshmore për të mos vdekur kurrë, bija e këtij fshati Nafije Bako (Bregu). Eshhtë e vetme femër dëshmore në rrethin e skraparit! Lulet e prillit sa po kishin çelur. Kënga e bilbilave nëpër degët e pemëve lajmëronin ardhjen e pranverës.

- E dëgjon bilbilin sa bukur këndon?- i tha të shoqes Islami.

-Po, ore po, iu përgjigj të shoqit Hysnia, aty për aty.

Kuvenduan gjërë e gjatë të dy bashkëshortët. Ata prisnin të sillnin në jetë fëmijën e tyre të parë. Ishte 7 prilli i vitit 1959 kur lindi Partizan Bako. Jo vetëm lulet dhe bilbilat, por e gurët zunë e kënduan. Sa shumë u gëzuan bashkëshortët e fisi i bakove atë ditë prilli?! Vitet kalonon e Partizani rritej si një pëllumb i shkruar. I ati, Islami, mbaroi arsimin e lartë për mesuesi (degën gjuhë - letërsi) në Elbasan. Kurse e ëma, Hysnia nuk mund të vazhdonte, ngaqë hallet familjare nuk e lejuanë. Ata lindën , rritën dhe edukuan katër fëmijë: Partizani, Krenari , Bardhyli e Arifi. Që të katër me shkollë. Përveç Partizanit , tre të tjerët mbaruan arsimin e mesëm në Dobrenj. Partizani vazhdoi shkollën mjekësore "Jani Minga" në Vlorë. Në vitin 1979 mbaron të mesmen mjekësore. Mbas kësaj vazhdon në Tiranë Universitetin e Mjekësisë. Në vitin 1984 e mbaron përfundimisht arsimin e lartë. Po në qershor të këtij viti, emërohet mjek në qendrën shëndetësore Zhepë, në zonën tomorricë. Ai ishte një djalë i përkushtuar ndaj profesionit të mjekut për t'i shërbyerë banorëve të zonës nga ku ai lindi dhe u edukua. Edhe me fjalë shëronte ai njerëzit që vuanin nga sëmundjet. Partizani i donte dhe i respektonte të gjithë njerëzit. Por, edhe ata e donin atë.

-Buzëqeshja e doktor Partizanit, të ngrohnte shpirtin kur ishte në siklet, dhe të ngrohnte më shumë se zjarri,- thoshnin njerëzit kur shkonin për vizitë në klinikë atje në qendrën shëndetësore. Në shkollë u njoh me një vajzë nga fshati Hermenj të rrethit Gramsh. Në vitin 1980 martohen. Nga martesë me Valentina (Hasani) Bako, sjellin në jetë dy fëmijë: Një djalë e një vajzë. Dy fëmijët ishin si zogj dallëndyshe në fole. Edhe

Valentina ishte infermiere.Për shtatë vjet rresht Partizani punoi me devotshmëri e përkushtim si mjek në shërbim të popullit.I donte njerëzit,ndaj edhe ata e respektonin si djalin e tyre.Por, ai nuk mundi t'i shërbente njerzëve të thjeshtë,sepse një dorë ogurzezë i merr jetën më 10-të gusht të vitit 1990-ës.Ishte viti i pare kur në shqipëri po ndodhnin transformime të mëdha në jetën politike e shoqërore;pra lëvizjet demokratike.Për këtë ngjarje të kobshme, ku mbetën tre të vrrarë e disa të plagosur në një repart ushtarak;jo vetëm shtypi e radiotelevizioni shqiptar, por edhe agjensitë e huaja nëpër botë,dhanë në transmetimet e tyre edhe këtë ngjarje të pazakontë e të trishtueshme.



Atë ditë, retë e bardha mbi Tomorr u nxinë e derdhën lot vajtimi së bashku me të afërmit,miqtë,kolegët,e gjithë ata që e njihnin.Më shumë se kush, dhimbjen e ndjenë prindrit e Partizanit,nënë Hysnia e Islami. Kurse bashkëshortja,Valentina,plagën e dhimbjes e mbante fort duke shtërnguar në gji pas krahorit dy fëmijët: Eraldin e Elën!Ajo qëndroi si një shkëmb,duke sfiduar dhimbjen; rriti,edukoi e arsimoi të dy fëmijët.Vajza ndoqi gjurmët e të atit,dhe u bë doktoresh.Ajo, duke u arsimuar për mjekësi,plotësoi amanetin e të atit i cili i patë thënë:" Ela,vajza ime! -Kur të rritesh,bëhu mjekë që t'u shërbesh njerzëve!?" Vitet ikin, por kujtimet mbeten si zambak i bardhë nëpër shekuj, sepse ato ujiten nga gjaku i dëshmorëve të atdheut.I tillë do kujtohet në shekuj edhe emir i dëshmorit të atdheut Partizan Bako.

Durrës, 09 Gusht 2020

Refleksion

Ecim rrënjëve të atdheut

Të udhëtosh shtigjeve të jetës do pak guxim, intuitë, zgjuarësi, por edhe intelektualizëm, bashkë me atë forcë yjnore të brendshme që buron si burim nga shpirti njerëzor në çdo sekond të jetës sonë. Kjo e parë me syrin e një vëzhguesi në përparësi: me durim e utësi, peshë mendimi, kërkim shtigjesh të reja, rrokje të fjalës së zgjedhur, reflektim ndaj fenomeneve jetësore, këto të para me syrin magjik në aspektin shoqëror, politike, ekonomike e sociale, deri ato familjare; të marra së bashku në korpusin e vargut poetik të poetes Xhemile Aliu, lexuesi do ndjejë atë peshë graviteti plot pathos artistik me mesazhet plot ngjyra letrare te libri me titull aq domethënës “Eciim rrugëve të Atdheut”.

Kjo për vetë poeten nuk është një rastësi, por një rrugë e vështirë e jetës së saj vetiake e lidhur me fije ari të çdo qelize të trupit me vendlindjen e atdheun që e ka emrin Arbëri. Poezitë e këtij vëllimi përshkruhen me një frymë e ndjenjë të lartë atdhedashurie, sa që poetja mesa duket “Fle” e qetë mbi atë tapet të gjelbër të atdheut, e lëndinave “mbjell” lulet e shpirtit duke thurur vargje poetike me mall e dashuri, ku në çdo lot që i rrjedh nga sytë do gjesh të shkruar fjalën më të dashur ATDHE! Duke ecur përgjatë lexueshmërisë nëpër vargjet e kësaj poete, që tashmë ka zënë vendin e vetë krijues letrar në letërsinë shqipe, tek ky vëllim vërejmë një arritje të sukseseshme, sepse tematikat e gjetjes me metaforat artistike që janë përdorur te poezitë në gjithë tërësinë e librit, kryefjala është dashuria për ATDHEUN. Poetja Xhemile Aliu na jep mesazhin e fuqishëm, sepse dashuria për ATDHEUN është vetë jeta, pa këtë s’ka kuptim asgjë nga kjo botë. Prandaj edhe vetë libri ka marrë titullin “Ecim rrënjëve të atdhut”, te rrënja e atdhut gjejmë këngën e JETËS sonë! Në këtë vëllim të ri poetik janë përfshirë 40 poezi, të cilat ne i kemi ndarë në tre (3) planizime letrare për ti analizuar ato. Trinomi i dashurisë për atdheun lartësohet gjer në qiell në simbolokën e zjarrit shpirtëror që ka shqiptari e, poetja në gjithë poezitë e këtij libri u jep jetë nga fryma e saj pavarsisht se ndodhet larg vendlindjes, emrave: Flamur, Atdhe, Liri! Është ky zjarr që u djekë shpirtin gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë e punojnë nëpër botë, prandaj rrënjën e mallit e kanë lënë aty tek ATDHEU, aty ku lulja e kujtimeve dhe e dashurisë për atdheun qëndrojnë të freskta në çdo kohë, u japin shpresë e JETË!

Këto i gjejmë të konkretizuara tek poezitë me titull “Drejt teje atdhe”, “Kosovë”, “Jam Drenicë”, “Atdhe”, “Atdhe, shqetësim shpirti”, “Ty atdhe”, “Shqipëri”, “Ecim rrugëve të atdheut”, etj. Pra, duke i parë në këtë këndvështrim analitik letrar, lexuesi do kuptojë e do ta ketë më të lehtë për të përthithur edhe më shumë ato vlera thirrse plot dashuri për atdheun, të cilat mbajnë në brendësi këto mesazhe aq të fuqishme, por edhe plot dritë dielli që na japin poezitë e këtij vëllimi të shkruara nga poetja Xhemile Aliu.

1. Poezitë që frymojë atdhedashuri:

Qysh në fillim të hapjes së librit në fletën e parë të renditjes së poezive, të shpaloset para syve poezia me titullin kuptimplot që të fton për ta lexuar deri në fund atë. Autorja bën thirrjen e saj si nënë e si poete të gjithë neve si shqiptarë që të ecim drejt atdheut tonë të dashur me sy e mendje për tek vatrat tona stërgjyshore. Vetëm atdheu jot të ngroh shpirtin e kockat ti ruan përjetësisht, - thotë autorja. Ajo takohet me fushat, malet, qiellin, lulëkuqet, flamurin, lapidarët, me nënat që rriten bijtë e bijat e që flijuan për atdheun e lirinë e tij. Këto e të tjera qëndrojnë si gërshetat e reve lart në qiell brenda shpirtit të poetes, ku vargu poetik gjen shtratin e vet tek poezia që titullohet "Drejt teje Atdhe".

" Drejt teje do vij fluturim,
Mbi qiellin e atdheut tim,
Lapidarët lartë të lirisë,
Drejtohen drejtë qiellit;
Nënat, këto fisniket tona,
la ledhatojnë plagët."

E gjithë ajo gamë jetësore, nuk ndalet kurrë, saqë vargu i kësaj poete vrapon drejt gjurmëve të historisë, vargun e gatuan me baltën e atdhut, shfaqet nëpër horizont si shqipet në fluturim, qesh e gëzon bashkë me thesaret e bukura të vendlindjes Kosovë. Ajo e shpreh këtë me atë zjarr të pashuar shpirtëror letrar te vargjet e poezisë "Kosovë", më konkretisht:

"Të kam thesar shpirti,
Dritë nëpër horizont;
Më je e paçmueshmja ime,
Kur qeshë e kur gëzoj.

Yll në qiell frymëzimi,
Ndjenjë shpirti hapërim,
Me je ideal i mbjellë,
Në çdo qelizë të trupit tim".

Ndërsa te poezia "Jam Dernicë", vargu lirik epikohistorik na jep tabllonë e qëndresës nëpër shekuj për lirinë e atdheut, dhe apelon fuqishëm të mos prekni lotin e nënlokes i cili pikon akoma mbi plagët e atdheut tonë.

" U derdhë gjak shumë, porsì lumi,
Loti nënëlokeve, bjeshkët lëkund;
Ndaluni plagë, ju lutem mos mi prekni,
Janë plagë të thella ju nuk po i njihni".

Vargjet e poezive kanë të ngulura thellë rrënjët e tyre në token Arbërore. Janë këto rrënjë të shpirtit të poetes nga ku marrin frymëmarrje që si sythet e pemëve në degë, edhe poezia të "Këndoje" si bilbili i pranverës e të mos ndalet kurrë për nënën Shqipëri,

sepse edhe ZOTAT flasin në gjuhën e arbërit! Këto lexuesi do i gjejë te poezia "Shqipëri". Sa për të orientuar lexuesin e dashamirsin e poezisë po sjellim këto strofa si më poshtë vijon:

" Zogjtë kishin ndalur cicërimën
E lulet ishin vyshkur për çudi,
Kjo atmosferë ma nxinte frymën
Iu luta zotit për ty nenë Shqipëri...
Armikut barbar kurë nuk iu përulën
Rrënjët thellë nen këtë tokë i kemi
Nga kohë kur edhe Zotat flisnin në gjuhën e Arberit,
Ne besë dhe krenarin nga rrënjët e PELLAZGUT...
Sot zgjuar jemi mbi dinjitetin tonë
S'do lejojmë askënd të na cënojë,
Ai qe mendon të shkel mbi këtë tokë
Përballë do t'i këtë dhjetë milionë".

Ndërsa te poezia "Ecim rrënjëve të atdheut", autorja Xhemile Aliu ka ditur të na i thotë bukur me vargun e saj aq prekës, saqë plagëve të shekujve mbi trupin e atdhut u lë si ilaç shërimi dhimbjeve të padrejtësive vargun poetik për të bërë drejtësi koha e cilvizuar që jetojmë sot në shekullin e 21-të. Pikërisht, nga kjo poezi ka marrë edhe titullin libri më i ri i kësaj autore, ku temat e poezive pulsojnë më shumë për atdheun. Konkretisht:

" Ece rrënjëve të atdheut
Anë e mbanë të shpërndarë,
Ecim rrugëve të dhembjeve
Me zemër të vrarë...
Ritmet e zemrës
I Akordon valvola,
Kombin e bashkuar
E kërkon vetë koha".

2. Një vend të rëndësishëm zënë poezitë me temën e dhimbjes shpirtërore
Lexuesi do rendi si një marathonomak e s'do ndalet duke shfletuar flet pas flete gjithë poezitë e shkruar prej Xhemiles, saqë aty do "takohet" jo vetëm me poeten e ndjenjat e shprehur në vargje, por do "preki" edhe tharmin e shpirtit të tij. Kjo është e dukshme, sa e trishtueshme aq edhe e gëzueshme. Në fund të fundit kjo është pjesa e jetës që ne jetojmë, vjen një ditë e largohemi bashkë me ëndrrat, por pas lëmë shpresat e së ardhmes. Çdo njeri prej nesh e ka të nevojshme të ripërtërihet. Kjo është e natyrshme, e pritshme... Por, asnjëherë nuk duhet të harrojmë gjurmët tona nga kemi ardhur, këto të na bëhen pjesë e jetës sonë, e brezave për nesër, sepse vlen shumë e shkuara, të flas e sotmja për rrugën nga e cila kemi kaluar për të mbritur deri këtu ku jemi. Ky mesazh që na jep autorja e këtij libri vlen për t'u theksuar që kurrë të mos harrohet në breza të shkuarën historike. Gjithçka është e jona, është pjesë e historisë dhe e jetës sonë, e së cilit nga ne. Këto poetja Xhemile Aliu i thotë duke i "puthur" në heshtje gjithë mesazhet shpirtërore nëpërmjet poezisë "Gëzuar ditëlindjen tënde të 10 Kosovë

heroike” dhe vazhdon me vargjet...,

“ Nënë e çeliktë,- kreshnike,
E bijave e bijve t’u legjendar;
Tmerr i armikut ndër shekuj,
Gjaku i pastër i tonit Dardan,

Heroin e shekujve të përflakur,
Me ballinë lartë por dhe krenar;
Jo kurr e përlulur as e përbaltur,
E ngritur e rilindur mbi hirin tënd” ...,

Ose te poezia “Larg teje, larg”:

“ Larg teje larg,
Këngë edhe vaj;
Shpresë si ujëvarë,
Për ditë të bardha;
Që do të vijnë,
Në atdheun tim.

Larg teje larg,
Të uroj nga shpirti;
Rritje dhe zhvillim,
Të shtetit forcimin,
Të kombit bashkimin,
Qofsh i bekuar,
O vendi im”.

Por poetja pi sisë e nuk ngopet nga gjiri i atdheut. Ajo vret ankthet e jetës e gjen qetësinë e shpirtit kur ulet e shkruan për ATDHUN! Ajo i kthehet vlerave më të mira edukative, si në trashgimi, qëndrim e veprim, por edhe në marrdhënie me njëri-tjetrin si njerëz e fqinj, apo komb me kombin për një bashkëjetesë midis tyre duke respektuar larinë e njëri-tjetërit. Lexuesi do i gjejë te poezitë “Mbretëresha Teutë”, “Lidhja vazhdon”, “Çfarë ndjenjë e art e shpirtit zjarr Arbëror”, “Në ditëlindjen tënde”, “Jam shqiptar, në këtë tokë dua një varr!”. etj. Pra, poetja ka ditur të reflektojë me shumë dashuri që i buron nga shpirti për gjithë fenomenet e kësaj bote që na rrethon. Më konkretisht:

“Po ku ishte Ilirija e bekuar, gjerë ku shtrihej
Trashëgimia jonë pellazge e nga fronti na thërriste,
Burrëria, trimëria, fjala dhe besa, e dhenë në shekuj,
Qen virtyte të të parëve tanë dhe ne sot duhet ndjekur.

Gjaku i derdhur ndër shekuj na thërret me qetësi,
Bresë pas brezi nder beteja në zjarr dhe barot

Moj tokë arbërore moj dhembje e jona shekullore,
Çdo pëllëmbë e juaja e mbjellë me varre e njomur me lot.”.

Pra, vargjet poetike qëndrojnë të varuara si fustanellë e verdhë atje mbi hënë, e poetes i qan shpirti në trup të ATDHEUT ARBËROR! Si rrjedhojë e tingujve muzikore letrarë me gjetjen stilistike të mirëformuar artistikisht, libri lexohet e këndohet bashkë me këngën e JETËS SONË! Kjo me ecjen e pandalshme për te rrënjët e atdheut tonë të shtrenjtë. Ajo është vërtet fizikisht larg atdheu por me shpirt e zemër ndodhet në atdhe.

3. Vend tjetër po aq të rëndësishëm zënë poezitë me tematikë shoqërore.

Në të vërtetë, poetja është treguar e kujdesshme edhe në këtë temë po me aq rëndësi për vetë shoqërinë tonë në veçanti e përgjithësi, ka thurur vargje me penën e saj edhe për aspektet shoqërore e sociale . Jep mesazhe të gdhendura artistikisht rinisë, këtij brezi rinor që të punojnë e mendojnë në çdo çast për vendlindjen e tyre.

Te poezia “Ndjej”, “Brezi i ri rinia”, “Ecim rrugëve të lirisë”, janë një domethënie që lartëson por edhe pi në grushtin e atdheut dshuritë deri në pavdekësi.

“ Që nga koha e lashtë antike
Përmes përbindëshash shpëtove;
E tkurrur e molisur e lodhur tej mase
Tokë e bekuar Arbërore,
Kurrë e pa përkulur në stuhitë e mëdha.
Nëpër të ç’përfytyruara cunami
Kohë të tmerrshme, perandori pas perandorie
Kaluan mbi trungun tënd, të fort si shkëmbi
E ti qëndrove, nga hiri u ngrite, u lartësove...

...Me pushkë në krahë, me zemër të zjarrtë,
Luftuan për ty o tokë hyjnore e bekuar nga zoti,
Dhe bijtë tuaj trima, të fort por si shkëmbi
Askujt s’iu përkulën, me gjak e ujitën,
Me jetë e mbrojtën, mburojë iu benë dhe ranë për mëmëdheun.”.

Kështu, poetja Xhemile Aliu e përmyll gjithë librin e saj me titullin “Ecim rrënjve të atdheut”, dhe na bën ftesën që të hapim fletët e këtij vëllimi të ri poetik për të lexuar vargjet poetike kushtuar atdheut tonë të shtrenjtë. Të ecim me hapin e dashurisë për jetën, sepse rrënjët tona janë tek ATDHEU! Ky është një mesazh i fuqishëm filozofik, atdhetar e letrar, fjala është shkruar e gatuar bukur artistikisht, që na përcjill me anën e poezive autorja Xhemile Aliu për tek gjithë lexuesit.

Durrës, Qërshor 2019

Kemi zonjën Amerikë!

Ese

Edhe pak ditë na ndajnë kur gjithë shqiptarët me të drejtë vote do u drejtohen kutive të votimit më 30 qershor 2019. Kjo është një e drejtë kushtetuese, e si rrjedhojë s'mund ti ndalojë dot askush. Të dyja kampet politike, si PD, e PS, nuk lëshojnë asnjë fije peri njëra –tjetrës. Njëra palë, pra kampi opozitar ngul këmbë se 'Pa hequr Edi Ramën, s'ka zgjedhje!'. Mazhoranca, dhe vet Kryeministri Shqipërisë, thotë se zgjedhjet janë konformë ligjeve kushtetuese! Deri këtu jemi të qartë. I kemi dëgjuar deri më tash, polt potre politike deri demagogji aspak demokratike....por thirrja e ndërkombëtarëve, për qetësi, urtësi e sjelle demokratike nga të dyja palët, ka kërkuar e kërkon me vendosmëri zbatimin e ligjeve të shtetit demokratik. Aspak asnjans, por të vendosur e preazi na thonë që të shkohet drejt kutive për të zgjedhur drejtuesit e Bashkive. Mazhoranca kërkon zbatimin e ligjit kushtetues për zgjedhjet vendore, kurse opzita e vjetër, e cila u vetëazgjesua me djegien e mandateve parlamentare, i vë kushte mazhorancës nga jashtë parlamentit duke i kërkuar 'Rama ik!', 'Nuk hyjmë në zgjedhje!' etj, etj. Largimi e djegja e mandateve të deputetit, ishte e vullnetshme e atyre që po bëjnë tre muaj duke thirrur rrugëve 'Rama ik!', etj. Flasin për larinë demokratike, për votën e lirë, deri për vjedhjen e votave.....Sa çudi! Sa çudi! Po kujt do u mbushin mendjen këta, si të djathtë e të majtë, se vota paska qenë e lirë këto 30 vjet pluralizëm!? Qytetarët kanë shkuar me vullnet të lirë drejt kutive të votimit, dhe kanë votuar atë parti që ka patur program më të mirë i cili ka qenë më afër problemeve e halleve të tyre për tu zgjidhur. Por, vota e qytetarit, nga të zgjedhurit këto 30 vite është shpërdoruar, deri aty sa vota ka ikur sa djathtas e majtas, pra partitë e të zgjedhurit me votën e lirë nga populli e kanë shpërdoruar besimin e këti të fundit duke bërë "kumar politik" në emër gjoja të zgjedhësve për të mirën e vendit. Kjo na ka dëmtuar ne si votues, si të majtë e të djathtë, deputetët e ministrat kanë shikuar vetëm interes e tyre personale. Thirrjet "hajdut, hajdut" e shumë të tjera fraza të shëmtuara nëpër mitingje janë bërë të neveritshme për popullin kur i dëgjon akoma edhe sot këto thirrje rrugëve nga politikanët që u ka dale boja, siç thotë një shprehje e popullit tonë. Ne s'jemi popull hajdut, por kemi politikanë hajdut. Ata e shprehin vetë nga mëngjesi e darkë duke sharë e akuzuar njëri- tjetrin. Si PD e LSI, deputetët u larguan me dëshirën e tyre, madje me entuziazëm nga parlamenti, e braktisën si ushtari frontin e luftës politike parlamentare, e dolën si haxhi pishmani rrugëve duke sulmuar institucionet e shtetit me gurë e deri molotovë! Tymi e flaka na ka irrituar shumë ne si qytetarë, na ka dëmtuar edhe në sytë e botës demokratike. Vetëprjashtimi nga gara politike të partive opzitare në këto zgjedhje Bashkiake, do të thotë se misioni tyre ka mbaruar, e si rrjedhojë janë pa vizion. Opozita e re parlamentare, si dhe marrja pjesë në këto zgjedhje lokale e partisë Bindja Demokratike, po tregon vlera demokratike. Shembulli që dy kandidatet për të marrë kreun e bashkisë së Durrësit nga dy zonja të nderuara, na bën që të reflektojmë ne si qytetarë në gjithë Shqipërinë. Ato shpalosën qartë e ballë përballë vizionin e tyre për katër vitet e ardhshme në drejtimin e Bashkisë së Durrësit në prani të simpatizantëve

në një sallë bashkë të PS BD. Qyteti i Durrësit ka ditur të rrezatojë vision e kulturë në çdo kohë., e jo si në disa bashki të vendit që dogjën madje edhe shkolla....!
Të dhunosh institucionet e shtetit tënd, është e pa pranueshme, anti demokratike e ligjore. Protesto, kërkto të drejtën si qytetar, kërktoji hesap qeverisë, por jo të dhunosh!
Shkak për këtë shkrim u bë një qytetar i thjeshtë I cili me modesti e kulturë ndërhyri në një debat për zgjedhjet e tridhjet qërshorit 2019. Ai recitoi këto vargje të poetit Ali Asllanit:

*"Hani, pini dhe rrëmbeni, mbushni xhepe, mbushni arka,
të pabrek' ju gjeti dreka, milionier' ju gjeti darka!
Hani, pini e rrëmbeni, mbushni arka, mbushni xhepe,
gjersa populli bujar t'ju përgjigjet: peqe, lepe!..."*

Që të dy debatuesit të cilët diskutonin për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të 30 qërshorit për Bashkitë e vendit, e dëgjuan me vëmendje, i dhanë të drejtë personit në fjalë, pohuan me kokë se më 30 qërshor do shkojmë në zgjedhje për Shqipërinë Evropiane , jemi antari i NATOS, kemi zonjën Amerikë!

Poetja emigrante Xhemile Aliu fluturon bashkë me vargun poetik nëpër krahët e erës...!

Të them të vërtetën, u ndjeva pak i ndrojtur para se të shkruaja këto rreshta vlerësuese rreth këtij vëllimi të ri poetik të autores kosovare, tashmë të mirëpritur dhe e mirënjohur nga lexuesi ynë, Xhemile Aliu. E nisa kështu , sepse duhet t'i them lexuesve dhe lexuesit që e do letërsinë, fjalën e shkruar shqipe, por dhe poezinë në veçanti, sepse poetesha Xhemile Aliu e ka qëndisur bukur atë gjerdan vargjesh të derdhura në "hojen e bletës" mjaltin shpirtëror tek vëllimi më i ri me poezi të titulluar " Në krahët e erës fluturoj". Ky libër është i 6 vëllim me poezi që ka botuar poetja emigrante, që tashmë lexuesi do e ketë së shpejti në dorë për ta lexuar e vlerësuar atë. Mesazhet që jepen nëpërmjet vargut janë të qarta: i ngjajnë dritës së diellit, ndjenja reflekton bashkë me vargun për te shpirti i lexuesit, aty do gjesh plot muzikalitet, dëgjon cicërimën e zogjve me këngën e tyre nëpër lisa të vendlindjes së poetes, gurgullimën e burimeve, por edhe ngjyrat e e ylberit diellor, bashkë me notat e pentagramit të tharmit krijues të cilat ato bëjnë atë ngacmim të botës së brendshme shpirtëror; të zgjojnë mendimet duke i ngritur ato në fluturim deri tek yjet në kozmosin tonë të paanë. Duke lexuar hap pas hapi të gjitha poezitë, do vëresh se autorja shkruan në vetën e parë me një varg sa të thjeshtë, por edhe aq domethënës ku rrezaton me ngrohtësi mesazhi i jetës, dashuria për njerëzit, e mbi të gjitha dashuria për vendlindjen e atdheun. Poetja i rri pranë me vargun e saj si një kurorë buçet lulesh fshatit të lindjes

Korroticë e Epërme, sepse aty "fle" bashkë me ëndrrat, pavarësisht se ndodhet shumë larg tij. Ajo udhëton çdo ditë nëpër rrugët, rrugicat, kopshtet, krojeve, apo livadheve nëpër lëndinat e fshatit, duke derdhur shiun e lotëve, kurse për "jastëk e jorgan" Xhemilja ka vendosur t'i lërë përjetësisht vargun poetik të shkruar me aq fines e mall shpirti që i djeg si një prush vullkanik deri në asht. Vargu i poetes në këtë vëllim shtegton kudo, merr me vete atë dashuri të zjarrtë nga shpirti dhe e çon atë deri në çdo qelizë të trupit të atdheut. Impulsiteti i poetes ndihet dhe ngrihet fuqishëm duke kapur edhe yjet e qiellit, sa që fluturon bashkë me erën duke marrë me vete ëndrrat e jetës, dhe u jep dritë nga shpirti saj të derdhura me mjeshtëri artistike tek ku vëllim poetik "Në krahët e erës fluturoj". Poezia e kësaj krijuese është ngrohtë si vetë dielli. Këtë e shpreh me vargjet tek poezia me të njëjtin titull qysh në fillim të këtij libri. Vargu të rrëmben pas vetes e nuk të lë të ikësh prej tij. Ai të fton për ta lexuar deri në fund poezinë, dhe si i tillë të befason me atë forcë shpërthyesë e të jep forcën e shqiponjës së malit për t'u bërë ballë rrebesheve të stuhisë së jetës. Një sprovë e gjallë e këtij realiteti është edhe vetë poetja Xhemile. Prandaj, mendoj se, lexuesi do gjejë me shfletimin e fletëve e poezive të këtij libri poetik: dashuri, mall e nostalgji, shtigjet e vështira të jetës, të vërtetën e gënjeshtrenë, por e Diellin e Jetës! Konkretisht :

"Dielli lind çdo ditë, një shpresë e re,
Një ditë hyjnore që pret ndryshimin,
Mendo të ardhmen, mos hezito
Diellin e jetës, kërko jetësimin".

Tingulli i fjalës është mjeti me të cilin ne lidhemi me njëri -tjetrin, por fjala e shkruar mbetet në themel të asaj që ne e quajmë "fjala magjike", e cila shpreh ndjenjat tona të botës që na rrethon, atë ndjenjë shpirtërore prej drite hënë të grisur që ndriçon në errësirën e natës, pra ajo zgjon ëndrrat e shpresave e të së nesërme. Por, për poeten fjala udhëton deri atje në qiell e bisedon edhe me yjet, rrugëve të jetës nga shëtisim.... Te poezia me titull "Bisedoj me hënë dhe yje" ajo na jep edhe këto vargje :

"Bisedoj me hënë dhe yje,
Që m'përkdhelin timin shpirt,
Dritëzim sjellin në memorie
Rrugëve të jetës nga shëtisë".

Autorja e do natyrën e gjithë mjedisin që e rrethon, ndaj e shikon me syrin e një dashurie nëne e si poete nga ku edhe i kushton varg poetik. Pa një dashuri ndaj mjedisit s'ka jetë, - thotë ajo te mesazhet e poezisë "Natyra". Këtë thirrje që i buron nga shpirti e shpreh në gjithë gamën e poezive të këtij vëllimi. E gjejmë te poezitë "Sot", "Imazhi kohë", "Rrebesh ndjenjash" "Natyra", "Sodisja rrugët të qytetit tim" etj.

"Sodisja rrugët e qytetit tim t lashtë
Ecja kalldrëmeve të gurta si biluri;
Dukeshin aq shumë të ngurtësuar
Sikur të ishin rrënjë lisash shekullor....

Tregojnë çart' lashtësinë e këtyre trojeve biblike
Atëherë ku Pellazgët mahnitnin me kulturën e tyre;
Atëherë kur sykaltri mbretëronin qiell dhe tokë
Eh, sa të pashëm ishin, raca Dardane ,racë biblike!"...

Ashti si cekëm edhe më lart në vështrimin e optikës rreth këtyre poezive, (e para): ka edhe disa nën nënndarje të tjera. E dyta: është përfshirë dhe poezia politikoshoqërore e sociale. ku fenomenet negative të politikëbërjes së qeverive nuk janë në ato nivele të duhura për t'u përgjigjur në kohë rritjes së mirëqenies së gjithë shoqërisë njerëzore. Drejtësia e barazia rrit besimin e zhvillimin e shoqërisë atëherë kur zbatohen drejt

ligjet. Stili i të shkruarit nga kjo poete është e dallueshme nga të tjerët, sepse kjo e shpreh drejt për drejt atë që e ndjen, godet fenomenet negative ,dhe kërkon drejtësi, por edhe dashuri e respekt ndaj ligjit. Metaforat e përdorura me mjeshtëri artistike në gjerësinë e gjithë poezive të këtij libri i rrit vlerat letrare e mesazhet e tyre që përcjellin te lexuesi. Psh. Te poezia "Ligjet", "Jam unë poeti", "Çast", "Rrugë, rrugë e vetëm rrugëtim..." , "E vërteta plagë e rëndë me dhimbje", "E ëmbël qenka karrigia e pushtetit", "Zinxhirët"etj. E treta: një vend të rëndësishëm zënë poezitë me temë të mërgimit. Poezitë me vargun e tyre i dalin nga shpirti i ngurtësuar duke thyer akujt shpirtëror që kërkojnë ngrohtësinë diellore, por edhe puhizën pranverore bashkë me krahët e fluturës e cila merr aromën e luleve e ngjitet lartë në kozmos të takojë ëndrrat e shpresave të jetës! Këto lexuesi do i gjejë me tërë forcën e dhimbjes në shumë poezi të shkruara nga kjo poete, e cila vetë ajo është pjesë integrale e jetës si emigrante prej shumë vitesh në Gjermani. Ajo e shpreh me zemër të çiltër brengën e shpirtit të copëtuar e të grisur nga plaga e emigracionit te poezia "Iku dhe kjo ditë", Ah ,kjo botë", "Ju lutem " "Meditim" , "Testamenti"etj. Për ilustrim ne shkëputëm dy strofa nga poezia "Testamenti", ku poetja bën thirrjen e saj prej nëne, zemërmadhe e të dashur, por me një merak të madh që ia ciflos shpirtin atje në emigrim e kërkon ilaçin shërues të asaj plage mërgimtare për t'u kthyer atje një ditë në vendlindje, në vatrën e të stërgjyshërve e gjyshërve tanë. Shpiti i poetes vetëm atëherë do gjejë paqe e qetësi, kur biri saj do plotësojë këtë amanet bashkë me nipa e mbesa, që kënga e jetës të këndohet në atdhe. Dhe ja si shkruan poetja Xhemile Hoxha –Aliu, mesazhin thirrës plot dritë :

‘ Këto vargje që i shkrova
 Testament ti mbash or bir,
 Pemën e rrënjës së familjes
 Ta vaditësh si është ma mirë....,
 ‘ Kur fëmijët tuaj të lindin
 Mi ktheni me fytyrë nga atdheu!
 Të kujtoni nga keni ardhur
 Mos harroni vatrën e dashur".....

Së katërti: Poetja ka shumë ëndrra....dhe më e bukura e kësaj ëndrre tek ajo qëndron si një shkëmb bjeshke Liria e fjalës,simboli Kombit, Flamuri kuq e Zi me shqiponjën në mes, ATDHEU! Ky trinom është mbjellë në çdo poezi të këtij libri,, saqë marrin udhën bashkë me mendimet , ndjenjat, shpresat dritë jete,për tek vendlindja. Është ndjenja e atdhedashurisë, shpirti i gatuar me baltën e tokës mëmë, gjaku arbëror i derdhur në shekuj që zgjon dashurinë e zjarrtë tek çdo shqiptar,të cilët ngado që shkojnë nëpër botë, Atdheun e Flamurin e kombit e ruajnë brenda trupit tyre, duke i dhënë frymëmarrje e oksigjen fjalës shqipe. Poetja Xhemile e fakton këtë, duke lënë të shkruar fjalën e bukur shqipe, bashkë me trinomin domethënës, sa patriotik aq edhe artstikisht letrar. Ajo e lartëson dhe e përjetëson me vargjet poetike në këtë libër , por edhe e ndërgegjshme për çka shkruan në gjithë "Detin" shpirtëror letrar tek ky vëllim poetik "Në krahët të erës fluturoj".Për poeten s'ka e s'do ketë furtunë oqeanike të ndali shpresat e shqiptarëve për të jetuar të lirë e sovran në trojet e vatrën e tyre shekullore. Ndaj edhe ëndrrat shpresëjete i fluturojnë bashkë me erën fluturuese dhe ndalin atje tek vendlindja e saj e dashur Karrotec i Epërm, në Kosovën martire, e çdo ditë kur zgjohet nga gjumi atje në emigracion i thotë: mirë mëngjes ATDHE! Por, poetja syrin e përletur e mban gjithmonë zgjuar, kur thotë Atdhe, Flamur, NËNË ! Sigurisht, , ndjenjat e saj fluturojnë e s'kanë të ndalur nëpër kozmosin , bashkë me ëndrrat e ditës së re! Me plot metafora e krahasime letrare, vargu shpërthyes te poezia "Në krahët e erës fluturoj" nga ku ka marrë edhe titullin libri, ndalet të pushojë e të flas shqip aty në

vendlindje, te Atdheu ynë i shtrenjtë, me emrin më të bukur në botë SHQIPËRI !Dhe vargjet e poezisë të rrëmbejnë pas tyre për t'i lexuar,ndjen madhështi e krenari ,sepse aty flet shpirti i vet poetes që përcjell imazhe jete tek të gjithë ne.

‘ Zgjuar më ka kjo puhizë pranverore
Më mori në krahët e saj porsi një flutur,
Më mbërthen me aromën e këndshme,
Më bëri sikur fluturoj lartë nëpër kozmos.

Më zgjoi këndshëm zëri i bilbilit
Cicërimat e ëmbla të zogjve në kor,
Por si simfoni e shpirtit në netët e vona
Më rrëmbeu ky mëngjes pasionant.
Ndërsa një dallëndyshe në një degë qershie
Çukitë ma të vegjlit e saj në një fole,
Më kujtoi ditën më të bukur në jetën time
Kur epitetin e nënës me madhështi ndjeva”.

Thjeshtësia në të shkruar, gjetjet e tematikave dhe ato letrare, krahasimet bashkë me gjuhën e fjalën e vargut të thjesht stilistik , e përshkonin gjithë librin nga fillim deri në fund Kjo të bën edhe më tërheqës që t’i shkosh deri në fund së lexuar librit me poezi të autores Xhemile Aliu.Mesazhet gdhendin muret e shpirtit tonë të trazuar, ato ngjallin shpresat e ëndrrave tona të jetës. Poezia është lirikë që del nga skutat e shpirti tonë, e cila ka përmasa dimensional dhe universale që na jep mundësinë për njohjen e matjen e botës që na rrethon.Pikërisht ,këto ndjenja universale i ka edhe poetja jonë Xhemile Aliu,. Ajo këtij qëllimi i mbart vetes, kërkon me ngulëm shpresat e jetës te vargu poetik , për ta transmetuar këtë të fundit për tek lexuesi. Bashkë me erën lozonjare fluturon që nga larg si mërgimtare drejt qytetit të ëndrrave rinore për tek qyteti që i dha armën më të bukur: PJEKURINË E DITURISË! Konkretisht shkruan vargjet:

‘ Ai ishte qyteti im ku erën e jetës përsëri ndjeva
Prishtina ime, qyteti i ëndrrave të mija të rilindura;
I brumosur thellë në zemrën time të rinuar
Është dhe mbeti idhulli ku me dije për jetën u armatosa”.

Dhe....vërtet poetja ka të drejtë, sepse dija shpalos JETË !

Na mbetet për t’i thënë autores : Suksese librit, e nesërmja me një tjetër libër ku të flas shqip!

INTELEKTUALË QË PËRCJELLIN DIJE E VLERA

QYTETARIE NË SHOQËRI

Portrete

Janë të shumtë ata njerëz të cilët kanë zbritur nga zonat kodrinore e malore të vendit drejt qyteteve e fshatrave të bregdetit tonë aq të bukur Jonian e Adriatik. Në këto vite tranzitore migrimi brenda vendit, por edhe jashtë tij nëpër shtetet të ndryshme të globit,; kudo shqiptarët kanë gjetur veten duke u integruar me vlerat e kulturën intelektuale, e si rrjedhojë me punën e dijet e tyre kanë shpalosur vlera të mirëfillta integruese për zhvillinin e ekonomisë e shoqërisë.

Të tillë njerëz janë edhe skraparas, të cilët shpalosin çdo ditë ato vlera intelektuale, që me dijet e tyre e përkushtim ndaj punës, po pulsojnë fuqishëm në gjithë fushat e shkencës e të ekonomisë, duke dhënë vlera nga vetja e tyre në dobi të gjithë shoqërisë sonë. Edhe në qytetin bregdetar të Durrësit, komuniteti skraparas, i cili renditet i dyti komunitet më i madh pas atij durrësak, po japin vlera qytetarie integruese në gjithë fushat e jetës të këtij qyteti. Ata e kanë gjetur veten e tyre duke u organizuar edhe në shoqatën "Tomorri" dega Durrës, që tashmë i japin tonin jetës kulturore e atdhetare mbarë qytetare e kombëtare. Edhe njerëzit inelektualë të prifesioneve të ndryshme skraparas kanë dhënë kontribute e po japin kontributet e tyre në zhvillimin e çdo fushe të jetës shoqërore të këtij qyteti me vlera historike,ekonomike,arsimore,kulturore.

Mësuesi Engjëll Seferasi,i dashur me të gjithë

-Kë kërkoni, u lutem!-Mësues Engjël Seferasin, iu përgjigja unë. Ishte data 18 korrik 2019, ndonëse ditë pushimesh, në shkollën e mesme profesionale "Beqir Çela" gumzhinte nga puna për ndërtimin e ambjenteve të reja të kësaj shkolle, por edhe riparimin e asaj ekzistueses.Aty takojmë jo vetëm mësues Engjllin, por edhe të tjerë mësues e nxënës që punonin në atë shkollë. Gjithë vëmendja e tyre ishte përqëndruar tek mbarvajtja e punumëve, riparimeve e zbukurimin e ambjenteve të jashteme të oborrit të këtij instuticioni deri tek lulishtet e ato çlodhëse. Takojmë mësues Engjëllin. Ai, si gjithmonë i thjeshtë, i qeshur, dashamirës me të gjithë njerëzit. Këto përshtypje për atë i morëm sapo u përshëndetë në hollin e shkollës me kolegë e nxënës, por nuk munguan edhe puntorët që punonin aty në këto ditë të nxehta korriku.Mësues Engjëll Seferasi është nga fshati Leskovë të Skraparit. Është i datlindjes 1969.



Foto Xh. Cirongu. Mësues Engjëll Seferasi

Arsimin e mesëm e mbaroi në vendlindje, kurse arsimin e lartë për matematikë- fizikë e kryen në vitin 1991 në Universitetin "Aleksandër Xhuvani " në Elbasan. Mbas mbarimit të universitetit fillon punë në arsim në shkollën 8 vjeçare Grevë, viti 1993, e më pas në shkollën e mesme "Pelivan Dorozhani" Zhepë, viti 1994-1995, i cili ka qenë drejtor shkolle. Por,..lë arsimin e degëdiset siç thotë populli rrugëve të kurbetit për në Greqi, ku punoi 14 vite rresht atje. Lë fshatin Leskovë e vendoset në vitin 1999 me banim në qytetin e Durrësit. Kështu pas një shkëputje të lodhshme e sakrifice ekonomike, në vitin 2012, rifillon përsëri profesionin aq të dashur të mësuesit në shkollën e mesme profesionale "Beqir Çela" Durrës. Ai kujton ato vite të arratisë në emigracion, loton e na buzëqesh sërish, sepse arsimi e mësimdhënia për të tjerët janë pjesë e jetës e profesionit të mësues Engjëllit. Idajet Qorrasi, punëtor e qytetar i këtij qyteti na thotë se mësues Engjëll Seferasi është njeri i dashur e gëzon respekt tek kolegët, nxënësit e gjithë njerëzit e tjerë...Ne largohemi nga ambjentet e shkollës profesionale 'Beqir Çela' duke marrë me vete përshtypjet më të mira si njeri e intelektual për mësues Engjëll Seferasi.

Nuri Jaupllari,- piktori që i ngjan valëve të detit

Të shkosh për tek studio e piktorit Nuri Jaupllari në lagjen 13 Plazh, m'u desh të merrja autobusin e dy linjave, sepse nga Shkozeti është shumë larg. Me të vërtetë është larg....(!?) Por më duhej të shkoja vërtet atje, koha ishte shumë e shkurtër, kisha edhe takime të tjera për efekt pune, sepse redaksia e gazetës "Dielli i Tomorrow" ishte në pritje të shkrimit tonë....Pas një ore ne mundëm të takojmë piktorin skraparas Nuri Jaupllarin. E gjejmë duke punuar në studjon e tij, ku pikturat na thoshin në heshtje "Mirëse erdhe mik!".

Nuriu, si gjithnjë miqtë e vizitorët, para se të joshin pikturat i fton ata për të pirë një kafe miqësisht, (pavarsisht se i njuh apo nuk i njihen vizitorët apo klientët), sepse mikpritjen e kanë në gjak skraparasit. Ata këtë traditë e reflektojnë kudo që ndodhen, si në vendlindjen e tyre por edhe atje ku jetojnë e punojnë. I tillë është edhe piktori Nuri Jaupllari, i cili ka vite që banon e punon familjarisht në lagjen 13 të Plazhit të qytetit Durrës.



Foto Xh. Cirongu: Nga e majta në të djathtë: Artjeta Haliti, Nuri Jaupllari, Elsa (Zhonga) Çela.

Qysh herët lë fshatin Përenjas të tomorricës e vendoset në qytetin Poloçan. Aty merr për here të pare penelin e pikturon. Sot ai me të drejt mburet si profesionist në fushën e piktrës, sepse me punën e talenit ia ka arritur qëllimit të vetes, si rrjedhojë ka arritur rezultate të kënaqshme si Brenda vendit e në ato ndërkomëtare. Edhe ne si qytetarë kemi seç të themi për këtë njeri punëtor, i dashur e që di të përcjelli kulturë profesionale tek njerëzit e tek ambientet e lagjes të qytetit në lagjen 13 Plazh. Pikturat jo vetëm në telajo, por edhe ato murale që gjenden rrugicave të lagjes 13 të këtij qyteti, janë tërheqëse për vizitorin e qytetarët e tjerë. Nuriu ka 54 vite pune si piktor. Në qytetin e Durrësit ka plot 17 vjet. Aktiviteti i këtij piktori skraparas tashmë është i njohur nga qytetaria Durrsake.



Ollga Myller e Nuri Jaupllari

Atje në qytetin e Poliçanit, te "Shtëpia e Pionierit" merr alfën e ngjyrave të pikturave të gatuar me baltën e ujët e lumit Osum, por edhe me freskinë e qiellit të tomorrit bashkë me kaltërsinë e qiellit plot shkëlqim. Nga dora e piktorit Nuri kanë dalë shumë emra të mirfillt që shquhen në fushën e artit të pikturës. Si: Flamur Kalemi, skulptor (i pari nxënës), Arben Kazaferi, Oljana Jaupllari, Artjeta Haliti, piktores, Ledisa Nuredini, Jori Tabaku etj. Nuriu ka hapur 20 ekspozita në shqipëri. Por edhe ndërkombëtare si: Lukseburg, Paris, Zyri, Strasburg etj. Ai është edhe Anëtar i Akademisë Evropiane të Artit. Këtë vit galleria është pagëzuar me emrin "Tomorri", kjo në kuadrin e 10 vjetorit të krijimit të saj. Nga ky autor krijues janë mbi 100 tablo të lëvuara në shumë shtete të ndryshme të botës, dhe kanë marrë vlerësimet e tyre nga ekspertët e artit. Nga piktorët e moshave të vegjël ne shkëputëm emrin e piktores Elsa (Zhonga) Çela nga fshati Kapinovë, e cila ka premise positive për t'u bërë një piktores me emër, na thotë Nuri Jaupllari. Vlerësimet për krijuesin në fushën e pikturës për Nuri Jaupllarin ka dhënë edhe piktorja me famë botërore gjermania Ollga Myller.



Në foto "ArtGaleri"

MËSUES FLAMUR ÇELA, "FLAMUR" KRENARIE NË FUSHËN E SPORTEVE...

Të shkruash për mësuesin Flamur Çela, sigurisht të duhet një kohë e gjatë pune e interviste. Kishim kohë mendimi më parë që ti kushtonim një shkrim këtij njeriu me plot pasion në fushën e sporteve. Por, ja ashtu si ato rrufetë në qiell, ne po sjellim pak rreshta në këtë shkrim për këtë njeri kurajoz, por edhe guzimtar, sepse me aktin e një njeriu të mençëm, guximtar, intelektual profesionist, theu atë malin e "akullt" të antraktidës që kishte prej vitesh që i ishte ngritur brenda shpirtit të tij, dhe vjen një ditë e i thotë "Ndal" shtrigës sëmundje e vendos atë plan si një luan për veten e profesionin e mësuesit. Flamuri mbaron fakultetin e Mjeshtërisë Sportive në Tiranë me rezultate të shkëlqyera.



Në foto: Mësues Flamuri me nxënësit e skuadrës sportive të shkollës "Qemal Mici" Durrës.

Si mësues fizikure punon për një fare kohe të shkurtër në shkollën e mesme Zhepë, e prej andej emërohet në Gjerbës të tomorricës. Por ne këtu në këtë shkrim do sjellim faktin se si mposhti sëmundjen e rëndë që iu shfaq kur ishte me banim në qytetin e Lushnjes pas viteve '90 –të....Aty ndërpret marrdhëiet me arsimin ...kalon me invaliditet....Ka disa vite që banon në qytetin e Durrësit. Një ditë më thotë mua: do filloj prap në arsim! Si! Po ti je me raport mjekësor!? Me të qeshur, ashtu duke shfaqur guximin e vendosmërinë ma përsërit prapë: E kam vendosur, do filloj punë në arsim, në zanatin tim! –Epo mbarë ta bëftë zoti o Flamur, i thashë unë. Dhe me të vërtet, Flamuri kishte fituar portalin, i treti në shkallë republike...dhe ai sot është mësues i edukimit fizik te shkolla "Qemal Mici" në qytetin e Durrësit. Vendlindja e Flamurit është fshati Gostëncë të Skraparit Shpirti guximtar i mësues Flamurit është i bardhë e ka fortësinë e gurëve të malit të vendlindjes, aty marrin udhë ëndrrat për jetën e profesionin aq të dashur të mësimdhënësit për brezat e djeshëm e të sotëm, por edhe për ata që do vijnë, sepse shembulli i këtij njeriu profesionist kanë jetëgjatësi! Puna e talenti i mësues Flamurit shkëlqen kudo në edukimin e brezit të ri në fushën e edukimit fizik. Një shembull që duhet të reflektojmë në të gjithë si qytetareë të këtij vendi. Mësues Flamur Çela meriton më shumë se kaq. Sigurisht, nesër do takohemi prapë me këtë intelektual guximtar! Tashmë shkolla "Qemal Mici" është bërë shembull për gjithë si motrat e saja të qytetit të Durrësit.

Durrës, 18 korrik 2019

Biografia e Skënder Kapitit

Skënder Sadri KAPITI lindur me 08 09 1959 në Durrës. Prindërit e tij kanë lindur dhe kaluar rininë në Kosovë, në Zallç të Istogut. Ata u vendosën në Shqipëri pikërisht në qytetin e Durrësit pas vendosjes në Kosovë të regjimit kriminalo- komunist udbasho-rankoviçjan i cili ishte njëloj antishqiptar dhe genocidist si ai i serbosllavisë së krajlëve. Në formimin e personalitetit të tij antikomunist dhe sidomos atdhetar e patriotik ka ndikuar Babai i tij, patrioti Sadri KAPITI. Ne, Bedri Tahiri dhe Xhevahir Cirongu duke i njohur nga afër Kapitët në takimet e shpeshta që kemi pasur kryesisht me Skënder KAPITIN, i cili gjithmonë na thoshte se nga Babai ai kishte mësuar për Kosovën, për luftrat dhe herojtë e saj, për historinë e lavdishme të saj, për krimet barbare dhe genocidin serb mbi shqiptarët e Kosovës. Kjo sepse në Shqipërinë ideologjike komunisto-marksist-leniniste nuk mësohej pothuajse asgjë për Kosovën, dhe për këto arsye, pra, se Kapitët ishin antikomunistë politika e Tiranës asnjëherë nuk i ka parë me sy të mirë familjen e Sadri KAPITIT.

Të ishe antikomunist në Shqipëri regjimi të cilësonte armik të partisë dhe armik të klasës, dhe ndëshkoheshe rëndë deri edhe me pushkatim, me burgim, internim dhe përjashtoheshe nga e drejta për votim, për punësim dhe për shkollim, pra persekutoheshe. Në ato kushte të luftës së egër ideologjike dhe të luftës së klasave fëmijët e Sadriut nuk kishin të drejtë as për shkollimin e lartë, pra iu kishte mohuar e drejta e studimit.

Pas përpjekjesh të pandërprera dhe me shumë vështirësi Skënder KAPITI në kohën kur regjimit komunist në vitin 1988 filluan t'i lëkunden themelet, në

fund pas shumë përpjekjesh e kërkesash të vazhdueshme atij iu dhe e drejta e studimit me korespondencë për Fakultetin Agronomi, për një degë e cila ishte tërësisht kundër vullnetit të tij, dhe të cilën ai e përfundoi para kohe. Me rënien e komunizmit ai kreu edhe fakultetin e drejtësisë dhe atë për diplomaci e të Drejtën Ndërkombëtare. Pikërisht realiteti i pakëndshëm i regjimit ateisto-komunist, kundërshtia ndaj tij, ky ishte edhe një motiv shtesë që e kishte detyruar dhe nxitur Skënder KAPITIN që ai në mënyrë autodidakte të mësonte dhe të interesohet shumë për studimin e historisë së vërtetë kombëtare shqiptare nga babai i tij, të studionte literaturë perendimore demokracie dhe sidomos filozofinë e filozofëve të mëdhenj botëror që ishte e ndaluar rreptësisht në atë kohë në Shqipëri. Ai si parim kishte që: atë literaturë e filozofi perendimore letrare, historike, politike dhe folozofike të cilën e ndalonte, e urrente dhe kritikonte literatura dhe ideologjia marksist-leniniste ai në kushtet e një izolimi e censure të tmerrshme antiperendimore me intuit gjente të vërtetën se përse ato ishin të ndaluara nga regjimi, nga ideologjia e genjeshtrave socialiste dhe realizmi socialist. Pra në kërkim të të vërtetave, ai i kërkonte ato jashtë perdes së izolimit dhe kundër kulturës dhe ideologjisë socialiste të cilat edhe historinë, edhe trashëgiminë, edhe filozofinë i trajtonin sipas këndëvështrimit ideologjik komunist e ateist. Në kushtet e rënda të shtetit ateist shqiptar ai studionte edhe fenë. Në formimin e tij filozofik ka ndikuar studimi prej tij i filozofisë së Platonit, Hegelit por sidomos Filozofia e Immanuel KANTIT, Kryevepra e tij, “KRITIKË E ARSYES SË PASTËR”. Skëndëri na thoshte se ai gjithnjë kishte qenë i interesuar për trashëgiminë patriotike dhe për fenë, për këto dy gjëra të rëndësishme për kombin, pasi sipas tij: nëse kombit i zhduket trashëgimia e vyer dhe feja atëhere çfarë i mbetet njeriut, individit, familjes dhe shoqërisë?!

Ai madje na tregoi se kur ishte në Gjimnaz, u bë një pyetsor ku njëra prej pyetjeve ishte pak a shumë e tillë se: cilën lëndë e doni më pak? Skëndëri kishte shënuar letërsinë. Këtë e kishte bërë pasi në letërsinë e asaj kohe

mësohej partishmëria proletare sovjetike, krijimtaria e realizmit socialist sovjetik dhe atij shqiptar të realizmit socialist; mësohej ateizmi, proletarizmi dhe ajo pak letërsi patriotike, edhe ajo ishte proletarizuar dhe partizanizuar komunistikisht, bizantinisht dhe sllavisht. S.KAPITI e urrente letërsinë, literaturën dhe pseudoshkencën e Realizmit Socialist pasi sipas tij, pothuajse që të gjithë intelektualët, historianët, shkenctarët madje dhesidomos, sidomos shkrimtarët e asaj kohe duke filluar e mbaruar edhe me I.Kadarenë ishin thellësisht komunistë në shpirt dhe në vepra; ishin intelektualë të cilët e shenjtëruan të shqiptarët Leninin e Stalinin, marksizëm-leninizmin e terrorit dhe të luftës së pandërprerë revolucionare të klasave; e shenjtëruan E. Hoxhën dhe krimet klasore, revolucionare dhe reformat antihumane të regjimit të tij dhe ia ngritën kultin atij; ata ishin mbështetja intelektuale e ishregjimit dhe si servilë të pashëbullt e futën diktatorin në Tempullin e Lavdisë; ata ishin oksigjeni që ia zgjatën jetën regjimit antihuman stalinisto-enverist. Në veprat, opinionet dhe në kritikën e Skënder KAPITIT argumentuar me fakte reale prej tij ai verteton se kjo frymë jo vetëm politike por edhe letërsie e historie vazhdon akoma edhe të shkrimtarët dhe letrarët edhe të sotëm në Shqipëri, dhe jo vetëm të ata, por edhe mediat, drejtësia dhe shoqëria civile në Shqipëri janë dhe kanë akoma frymë autoritariste, anshmërie e shërbimi, servilizmi e mercenarizmi ndaj politikës dhe pushtetit, kujdo pushteti që vjen në qeverisje. Deri në vitet 1990 asgjë nuk mësohej dhe as nuk përmëndej asnjë shkrimtar nga Kosova. Edhe shqiptaro-kosovarizmi i Skënder KAPITIT ishte një arsye tjetër shtesë që familja shqiptare KAPITI me origjinë nga Kosova, edhe kjo ishte një arsye tjetër pse familja KAPITI nuk shihej me sy të mirë nga regjimi komunist në Shqipëri, pasi atij regjimi i interesonte vetëm ideologjia dhe pushteti dhe jo interesi kombëtar gjithshqiptar, pra as Kosova. Atij regjimi i interesonte vetëm pushteti dhe sundimi i asaj Shqipërie të vogël dhe as nuk e kishin fare në interesim, as prioritet dhe as si strategji jo se jo për Çështjen kombëtare shqiptare. Një politikë të tillë ai e konstaton se vazhdon mjerisht akoma edhe sot, si në Shqipëri dhe në Kosovë, pikërisht politika e pushtetit, e

interesi personal dhe e atij korruptiv të cilat edhe kanë kapur dhe sundojnë shtetin në Shqipëri dhe në Kosovë duke i mbajtur të dy shtetet në prapambetje në rrugën e zhvillimit e të qytetërimit, të progresit e të mirëqënies, të integritit dhe të konsolidimit të shtetit modern e ligjor. Dhe për ndryshimin e këtij realiteti të sotëm, për daljen nga ky udhekryq dhe realitet i hidhur dhe i pakendshmëm, bllokues e pengues i zhvillimit dhe progresit mendojme se janë edhe motivet që e kanë shtyrë Skënder KAPITIN që ai t'i drejtohet Kombit me këto 5 letrat e tij, pasi në mënyrën se si praktikisht zbatohet demokracia në Shqipëri ajo deri më sot rezulton si një mashtrim i ri, si një thashethemnajë demokratike larg demokracisë reale dhe të vërtetë.



Skënderi shprehet në opinionet e tij se dhe në paskomunizëm, në Shqipëri pushteti vetëm sa ka ndërruar maskën, pasi ka mbetur si premtimshtrues, demokraci pa demokracitet, si demokraci pa patriotizëm e cila nuk po gjëndet në popull por larg tij, si demokraci oligarko-partizane dhe e korruptuar. Ai gjithmonë në kohën e regjimit komunist ka qenë i interesuar për filozofinë antimarksiste dhe ka qenë kundër ideologjisë së vogëlsirave, hipokrizisë së

gënjeshtrave komuniste të cilat i shkaktuan trauma të mëdha kombit shqiptar në veçanti. Ai madje kujton edhe atë se çfarë i kishte thënë Babai i tij, Sadriu se: “çfarë mësoni sot në shkollë mosohen vetëm ato se çfarë thotë e dëshiron Partia Komuniste, dhe shiko se sa e vogël, sa pak fletë ka Historia e Shqipërisë dhe krahasoje me volumin e stërmadh të Historisë së Partisë Punës Shqipërisë”. Ideologjia komuniste ishte filozofia dhe shkenca bazë që dominonte Shqipërinë, shkollën, letërsinë, shkencën, kulturën, ekonominë etj. Patriotizmi socialist ishte internacionalizmi proletar. Marksizëm-leninizmi stalinist ishte provim shteti edhe në shkollë të mesme por edhe nëpër universite e fakultete.

Pra, kjo përrallë dhe e pavërtetë e madhe e regjimit ideologjik komunist u shkaktoi trauma e tragjedi të mëdha shqiptarëve duke qenë se ishte edhe praktika dhe “filozofia dhe shkenca” bazë në Shqipëri. Skënder KAPITI, prandaj duke qenë i tillë, i formësuar me trashëgimi, me bindje dhe me edukatë të thellë kombëtare, kundër ideologjisë së gënjeshtrave dhe të pavërtetave, kundër letërsisë e historicizmit të realizmit socialist sllavo-bizantin ai edhe ka shkruar vepra me tematikë patriotiko-kombëtare si:

Kryeveprën “TRIUMFI I KOMBIT”; ka shkruar veprën e madhe filozofike “NJERIU FILOZOF, ETIK E POLITIK”. Si studiues i fesë, moralit; i të drejtës romake, angleze, gjermane, franceze, amerikane, ai ka shkruar librin “MORALOKRACIA”. Është autor i Librit tjetër me temë filozofiko-kombëtare “PESË LETRA DREJTUAR KOMBIT”. Përveç këtyre librave kryesorë të tij ai ka shkruar edhe shumë vepra filozofike dhe morale, ka shkruar e botuar shumë e shumë analiza, opinione, poezi dhe ese me tematika për kombin, moralitetin, drejtësinë, demokracinë, dhe për patriotizmin real kundër demokracisë spekulative dhe patriotizmit fals. Është një kritik i ashpër i atyre të cilat ai i quan mashtrimdemokraci dhe si “të këqijat demokratike” Demaskon amoralitetin politik, keqbërësit publik të pushtetit të keq,

mashtimin e tradhëtinë publike e kombëtare të politikës dhe politikanëve të pushtetit dhe manipulimin e manipulorët, spekulimin e spekulorët dhe hipokrizinë demokratike. Ai ka dhënë një kontribut të madh me dhjetra shkrime në ndërgjegjsimin dhe në propagandimin e domosdopshmërisë për miratimin e VETTING-ut në Shqipëri, të cilin për nga rëndësia jetike e quante reformën më të madhe pas Pavarësisë Kombëtare. Skënder KAPITI i kundërvihet në veprat e tij dhe demaskon ashtu si në shumë e shumë shkrime dhe ese të tij, ai kritikon dhe proteston guximshëm kundër politikës së krimit, korrupsionit, hajdutërisë dhe tradhëtisë publike të saj; demaskon hipokrizinë dhe amoralitetin e politikës dhe të pushtetit të cilët kanë kapur shtetin dhe mbajnë peng zhvillimin, progresin, ligjin, intelektualizmin pozitiv, patriotizmin dhe integrimin. Ai i drejtohet kombit, bën thirrje dhe kërkon që të çmontohet në Shqipëri dhe në Kosovë sistemi i korrupsionit, krimit politik dhe të atij gjyqësor duke studiuar kundër injorancës, duke vepruar e guxuar me trimëri e mënçuri kundër pushtetit të keq, politikës së kriminalizuar dhe kundër drejtësisë së korruptuar, duke bërë thirrje për një VETTING gjithpërfshirës. Skënder Sadri KAPITI është veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës së bashku me vëllezërit e tij për kontributin e madh dhe të veçantë që ka dhënë Familja e Sadri KAPITIT në Luftën për çlirimin dhe Pavarësimin e Kosovës, kontribut i cili është përjetsuar edhe në Librin “Patriotizmi jeton në përjetësi”.

Bedri Tahiri & Xhevahir Cirongu

“Drenica” e Durrësit, 20 vjetori i Qendrës së mobilizimit të luftëtarëve të UÇK

Në themelet e ngjarjeve të mëdha të historisë më të fundit të popullit shqiptar, si një pasuri e çmueshme , e pashlyeshme dhe e paharrueshme në histori qëndron dhe do të mbetet edhe qendra më e madhe dhe më e rëndësishme e rekrutimit dhe e mobilizimit të luftëtarëve të UÇK-së, “Drenica ” në Durrës, e cila u ngrit dhe filloi të funksionojë me 1 prill të vitit të lavdishëm për Kosovën, të vitit 1999, menjëherë pas fillimeve të bombardimeve të NATO-s mbi ish-Jugosllavi për Çlirimin e Kosovës të cilat filluan me 24 Mars 1999.

Pra, përderisa viti 1999 është Viti i NATO-s , i 20 vjetorit të ndërhyrjes së saj, ashtu sikurse është Viti 1999 edhe Viti i Konferencës së Rambujesë, edhe Viti i Çlirimit të Kosovës me 12 Qershor 1999, po kështu 1999-ta, Prilli i 1999-ës është edhe viti i mobilizimit të madh të luftëtarëve nga trojet gjithëshqiptare dhe sidomos nga diaspora te “Drenica” e Durrësit e familjes patriotike të Sadri Kapitit, të cilën avokati i njohur, politikani i shquar dhe patriot, Spartak Ngjela, ka deklaruar se: “Kjo është një Fortesë, një Kështjellë e pamposhtur, që politikanët nuk e kanë shumë për qejfi... “Drenica” e Durrësit dhe familja atdhetare Kapiti, meritojnë shumë , por, mjerisht, kjo është politika jonë e sotme”.(Spartak Ngjela , Durrës 5 Gusht 2008). Kjo ngjarje që ka të bëjë me Qendrën “Drenica” ka rëndësinë e saj si një faqe e lavdishme në historinë tonë kombëtare, pasi këtu duke iu përgjigjur thirrjes dhe kushtrimit për liri, mbërritën me mijëra e mijëra vullnetarë nga të gjitha shtetet ku kishte diasporë Shqiptare, nga Perëndimi, Gjermania, Italia, Franca, Britania, Suedia, Austria e deri nga SHBA, Australia e Kanadaja si dhe luftëtarë patriotë e liridashës nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi e Kosova Lindore. Qendra “Drenica” e Durrësit të sjell në kujtesë Lidhjen gjithëkombëtare të Prizrenit. “Drenica ” e Kapitëve të Durrësit u bë epiqendra kryesore që tërhoqi vëmendje jashtëzakonisht të madhe ndërkombëtare, ku për çdo ditë aty instaloheshin mediat kryesore ndërkombëtare perëndimore dhe botërore; ku nga aty pasqyrohej mbërritja dhe rekrutimi i luftëtarëve të UÇK-së, nga aty ato merrnin informacion edhe për gjendjen dhe situatën

në Kosovë prej dëshmitarëve realë dhe okularë pasi për çdo ditë mbërrinin te "Drenica" e Durrësit qytetarë të dëbuar e të përndjekur nga makina ushtarake vrastare dhe genocidiste serbe; ku te "Drenica" e Kapitëve të Durrësit përveç vullnetarëve të UÇK-së bëhej edhe takimi e bashkimi i familjeve kosovare. Te "Drenica" e Durrësit bëhej takimi edhe i prindërve e pjesëtarëve të familjeve me bijtë dhe me bijat e tyre që vinin vullnetarë nga perëndimi për t'iu bashkangjitur luftëtareve të UÇK-së. "Drenica" ka qenë si të thuash pika e parë e kontaktit, si porti dhe porta pritëse dhe përcjellëse panshqiptare ku vinin, priteshin e përcilleshin në ditë për në betejë qindra vullnetarë e luftëtarë të lirisë ashtu sikurse me të drejtë shkrimtari Thanas Mustaqi e ka quajtur "Drenicën" e Durrësit "Mekë atdhedashurie". Prej "Drenicës" bëhej ndërkombëtarizimi mediatic i Çështjes Kombëtare Shqiptare dhe i Ushtrisë më të re të Europës, i UÇK-së, karakteri luftarak dhe çlirimtar i një lufte burrërore, të pastër dhe heroike e cila kishte si aleat të saj Fuqinë ushtarake më të madhe botërore, NATO-n e drejtuar nga SHBA.

Nga "Drenica" e Durrësit UÇK-ja u quajt me meritë prej sekretarit të saj si këmbësoria e NATO-s. Te "Drenica" e Durrësit mbërriti Batalioni i Atlantikut nga SHBA. Te "Drenica" e Durrësit mbërritën dhe iu bashkangjitën vullnetarëve të UÇK-së shumë e shumë vullnetarë me kombësi të huaj nga vende e shtete të Europës Perëndimore të cilët e kishin parë dhe kishin mësuar për qendrën e rekrutimit "Drenica" të Durrësit nga mediat e televizionet kryesore europiane e botërore, mediat të cilat mësonin dhe informonin opinionin ndërkombëtar për masakrat çnjerëzore që bënte ushtria kriminale serbe me torturimin, vrasjet, djegiet, rrënimin dhe shkatërrimin e shtëpive, fshatrave dhe të qyteteve në Kosovë. Për "Drenicën" e Durrësit është folur, shkruar, filmuar dhe dokumentuar shumë sidomos nga ish-vullnetarë të UÇK-së, nga shkrimtarë, gazetarë, media kombëtare e ndërkombëtare, intelektualë, historianë, akademikë, ushtarakë, familjarë dëshmorësh dhe heronjsh nga Shqipëria, Kosova e diaspora.

Për "Drenicën" e Durrësit, për këtë qendër të historisë sonë kombëtare dhe për Familjen e Sadri Kapitit, për kontributin e saj për Kosovën është shkruar edhe një libër voluminoz i autorit Bedri TAHIRI me titull

“Atdhetarizmi jeton në përjetësi”, një libër hulumtues, evidentues dhe vlerësues i historikut kombëtar si një pasuri e madhe enciklopedike dhe e jashtëzakonshme gjithëkombëtare ilustruar me fotografi, biseda, intervista me personazhe realë dhe dëshmitarë të veprimtarisë së madhe patriotiko-kombëtare të familjes së Sadri Kapitit , bijve dhe bijave të tij të cilët vunë gjithçka në shërbim të atdheut e të kombit për lirinë e Kosovës ku po citojmë disa prej tyre: “Drenica” e Durrësit është qendra kryesore e frymëzimeve atdhetare... është Tempull atdhetarie. Më vjen mirë që kjo shtëpi lirie e tempull i atdhetarisë u pagëzua nga poetët dhe artistët. Ajo e ndërshqiptarizoi këtë vend, nga i cili buroi jetësimi i çështjes sonë madhore , çlirimi kombëtar”. (Nga poeti dhe akademiku i shquar Xhevahir Spahiu). “Emri i nderuar “Drenica” do të kujtohet gjithashtu edhe si kontribut atdhetar e patriotik i djemve të familjes së respektuar Kapiti. Ajo meriton që të bëhet një qendër e edukimit atdhetar dhe patriotik të brezit të ri”. (Nga Bujar Muharremi, ish-diplomat e ambasador i Shqipërisë në Kosovë) numër i madh personalitetesh të lartë, akademikë dhe intelektualë si dhe shumë shoqata kombëtare kulturore, artistike e patriotike kanë propozuar te institucionet më të larta të Shtetit Shqiptar që “Drenica” të shpallet muze, dhe po gjithashtu kanë propozuar edhe për dekorimin e familjes së Sadri Kapitit për kontributin e madh të tyre dhënë për çështjen kombëtare.


Ilir Malindi & Xhevahir Cirongu - gazeta "Shekulli".

Kulturë

Libri është porta e cila të fton në “galerinë” e dijeve....!

Të kesh një libër me vete, pra në xhep, në shtëpi apo aq më mirë ta kesh si pasuri në raftin e bibliotekës personale, jo vetëm pasuron dijet që merr prej tij duke e lexuar atë; por edhe prej tij ke fituar një pasuri të pazvëndësueshme e cila mbetet në breza. Tek libri çdo shkrimtar lë historitë njerëzore të kohës së vet që e jeton atë, plus rrëfimet e treguara nga të tjerët, por edhe copëza jetësore e ju jep frymë e jetë pavdekësie të radhitura gur mbi gur që lëshojnë zjarr e dritë për gjatë rrjedhave të ngjarjeve në librat

që shkruajnë. Si rrjedhojë e një pune sa të lodhshme e fisnike, autorët e librave me shkrimet e tyre lënë thesaret e vlerave të dijes e kulturës për gjithë shoqërinë njerëzore në shekuj. Tek librat lexuesit do gjejnë në “galerinë” e librave thesaret e diturisë. Pa këto dije s’do të kishte zhvillim e civilizim shoqëria njerëzore. Libri është miku më i mirë dhe i afërtë që të ndodhet në çdo kohë e rrethanë, të këshillon e na fal dije! Le të njihemi shkurtimisht me dy autorë shkrimtarë të cilët kanë dalë me botimet e tyre para lexuesve që e adhurojnë librin.



Studuesi, historian e publicisti Meçan Kodhel Hoxha:

Pas një telefonate nga miku e shkrimtari Meçan Hoxha, i cili më ftoi për një kafe tek shtëpia e tij, unë nuk refuzova, por mbas dy ditësh shkova atje. Me atë mikëpritjen karakteristike gramshiote dhe bisedave sa miqësore, po aq edhe historike e letrare e ngrohën atmosferën e bisedave të asaj ditë të ftohtë të muajit shkurt. Rrjedha e bisedave mori udhën e saj drejt vendlindjes së shkrimtarit. Dikush trokiti në derën e mikut Meçan! – Eja, hyr brenda se kemi edhe një mik tjetër këtu. Si u prezantuam, Meçani nuk vonoj e merr dy libra “kontribute

letrare” dhe “Gramshi në jetën time” ai kishte bërë këtë dediktim “Xhevahirit, poetit dhe shokut tim të mrekullueshëm”. Me shumë respekt, firma!”. E falnderova nga zemra për këto dy dhurata të shtrenjta që më dhuroi miku Meçan.

E bëra këtë parantezë, sepse miku jonë i lertave, M. Hoxha, di të fali dashuri e respekt tek miqtë e letrave, por edhe atë pjesë të shpirtit të tij, fjalën e shkruar aq bukur e me tharm historik, patriotik, publicistik e letrar. Aurori ka ditur të përzgjedhë në mesin e shumë shkrimeve të tij të botuara në vite, ashtu si bleta lulet, dhe vendos nektarin e shpirti në librin me titull “***Gramshi në jetën time***”, (citojmë se ky është i 9 libër i botuar deri më tani nga autori). Libri ka 418 faqe, i shoqëruar edhe me fotot përkatëse, të cilat i japin kolor këtij botim dinjitoz. Në faqen 176 të këtij libri autori M. Hoxha shkruan se “Atdhetaria është një ndjenjë që s’plaket e nuk vdes kurrë!...”. Duke u referuar tek kjo frazë e shkrimtarit, më shumë se një libër është e do të mbetet një dokument i gjallë si për të djeshmen, të sotmen, por edhe për të nesrmen e brezave psardhës. Libri i autorit M. Hoxha, është një përmbledhje sa studiuese po aq analitiko- historike e mendimit kualitetative që ka ngritur lartë vlerat atdhetare, patriotike e kulturore të Gramshit e Gramshiotëve për gjatë rrjedhave të historisë të kësaj treve. Lexuesi përveç njohjes me shkrimet historike e kulturore të vendlindjes së autorit, do njihet edhe me ngjarjet e

trevave të tjera të Shqipërisë që kanë lidhje patriotike e historike me trevat e Gramshit .Tërheqëse është midis të tjerave edhe fotografia e bërë në vitin 1986 te kulla e Mic Sokolit, si dhe shkrimet për Çamërinë kosovën, etj. Për kontributet ndaj historiografisë e kulturës sonë kombëtare, intelektual z. Meçan Hoxha ka marrë disa vlerësime.Ne shkëputëm vetëm dy prej tyre.Me vendim të Këshillit Bashkiak Gramsh Nr. 14, datë 27.02.2008,i jep titullin “Qytetar Nderi” me këtë motivacion:“Qytetar i denjë i Gramshit, historian e publicist i pasionuar në paqyrimin dhe përcjelljen e vlerave tona historike e kulturore, duke dhënë një ndihmesë të veçantë në përjetësimin e tyre”. Nga Bashkia Durrës në vitin 2013 merr Mirënjohje e Qytetit me këtë motivacion: “Për ndihmesën e shquar si publicist, studiues e veprimtar shoqëror”. Por, autorin në fjalë lexuesi do ta gjejë edhe poet. Te poezia “Burimi im” ne shkëputëm këto vargje:

“Një burim me ujë t’kulluar,
Pash ku s’pari hodha sytë,
Dhe tani që jam i moshuar
Them:si ai s’ka asnjë të dytë”

Pra, autori i këtij libri është i lidhur aq ngushtë me vendlindjen e tij fshatin Kukur, saqë etjen e mallit për Gramshin e gramshiotët , bashkë me ëndrrat ai shuan etjen e moshës dhe u jep jetë me ujët e burimit!

Gramshi është një gonxhe trëndafil që rri përherë i çelur mes malesh buzë lumit Devoll bashkë me historinë e kulturën e tij të lashtë, por edhe libri “Gramshi në jetën time” të autorit Meçan Hoxha lartësohet edhe më shumë si mali Tomorr . Lotin e syrit për vendlindjen Meçani e mban të fshehur brenda shpirtit, dhe atë lotdhimbje e dashuri, lexuesi në tërësi e gramshiotët në veçanti,do i gjejnë të shkruara tek ky libër me shumë vlera historike, por bashkë me këto vlera udhëton edhe emri i shkrimtarit M. Hoxha.Na mbetet për ti thënë, shëndet, suksese e Jetë mikut tonë Meçan!

Autori Bajram Halil Gashi, del para dashamirsëve të librit me librin të titulluar “Ah..., Shqipëri mos thuaj mbarova!”, Ky libër i kushtohet legjendës së folklorit shqiptar Dervish Shaqja, Demush Neziri dhe Grupit Kosovar. Është një libër, i cili qysh në titullin e tij lexuesin e bën për vete dhe e fton në “sofrën” e tij për ta shfletuar flet pas flete duke i shkuar leximit deri në fund. Autori ka botuar dy libra deri më tani.Në vitin 2013 boton librin” NJË SHEKULL NË UDHËN E DIJES”, kushtuar 100 –vjetorit të shkollës së parë shqipe në Shënavlash. Por,



Bajram Gashin e ngacmonte prej vitesh ajo ndjenjë e brendshme e cila i bënte thirrjen

sublime me bardhësinë e shpirtit si plisat e bardhë mbi krye të ulej e shkruante diçka edhe për ikonën rapsodike të folklorit shqiptar për Dervish Shaqen. Me një përkushtim e devotshmëri si mësues ka punuar në disa fshatra të rrethit Kavajë e të Durrësit. Sot ai është në pension, por si një "zog" shtegëtar ai grumbulloi e shkroi tegime, episode, rrëfenja historike, bisedat jetësore rreth odave të miqve, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë. Libri ka 360 faqe duke u shoqëruar edhe me foto ku së bashku me stilin e portretizimeve të ngjarjeve për gjatë rrjedheve historike, autori ka ngritur me të vërtetë "skulpturë" do ta quaja pa frik për grupin rapsodik folklorik kosovar me në qendër kryemadhështorin emblëm Dervish Shaqen.

Vetë titulli "Ah, SHQIPËRI, MOS THUAJ MBAROVA!" botuar në "Mileniumi i ri" është treguesi më domethënës ku shkrimtari Bajram Gashi tregon sakrificat, vuajtjet, por edhe atdhedashurinë e madhe të bjë e bijave kosovare që luftuanë e sakrifkuan edhe me jetën e tyre për bashkimin e trojeve shqiptare. Edhe kënga e Dervish Shaqes me "Grupin Kosovar" të rapsodëve të Rrashbullit ishin këngë barot lirie! Grupi folklorik i rapsodëve të Rrashbullit mori përmasa jo vetëm në Shqipëri, Kosovë, e trojet e tjera shqiptare, por edhe më gjerë. Ndaj, jehona e tyre dëgjohen sot e do të dëgjohen e këndohen në shekuj. Bajram Gashi me orgjinë është nga fshati Prigodë i Komunës së Istogut, por vendlindja e tij është Shënavlashi, fshat i rrethit Durrësit. Ka lindur në vitin 1946, ka kryer arsimin e lartë për gjuhë - letërsi. Ne sollëm disa episode të shkurtër, sa për njohje, sepse lexuesi kur të njihet me librin do zbulojë dalë-ngadalë madhësitinë historifolklorike atdhetare e lridashëse nëpërmjet këngëve e të veprimtarisë kushtuar Dervish Shaqes dhe Demush Nezirit. Libri ka gjithësej 15 kapituj. Intervistat e portretizuara në këtë libër janë të shumta, ku autori Bajram Gashi na i përshkruan me një lirikë të bukur sa historike po aq artistike letrare. Ne shkëputëm këto rreshta të **Ali Gecit** i cili midis të tjerash thotë: " *Ai mbajti ndezur, një gjysmë shekulli eshkën në zemrat e djalërisë shqiptare. Me dhimbje i këndoi Kosovës së serbizuar, por gjithmonë ishte optimist si rilindësi Naim: "Ditë të mira, paskëtej vijnë". Dervishi "U dogj si qiriri" i Naimit. Ai sakrifkoi jetën e tij, të cilën e projektoi në këngë e vargje, siç përmendet:*

*"Kur ta kthyem Kosovë shpinën,
E lam "bar" e gjetëm dimër".*

Ai i këndoi Kosovës, dhe Shqipërisë, Prevezës dhe Çamërisë, siç shprehet tek kënga e Ahmet Delsë:

"T'u shqiptart, kush t'ka than' me hi?!

A e din', që k'tu i than' Shqipëri?!". (fq.268, Gashi Bajram)

Njerëzit e artit kanë vetëm JETË!

Autorit të librit na mbetet për ti thënë shëndet e suksese me të tjerë libra në të ardhmen!

Durrës dt.19 Mars 2019

Veprimtaritë mbajë gjallë historinë tonë

(Me rastin e 75 vjetorit të çlirimit të atdheut)

Një nga veprimtaritë e zhvilluara këto ditë në qytetin bregdetar të qytetit Durrës, ishte ajo e Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve të Atdheut e cila u zhvillua në një ambjent komod e mbreslënës. Kjo organizatë shoqërore e atdhetare po bën një punë të dobishme për ruajtjen e transmetimin e vlerave patriotike e atdhetare për te brezat më të reja. Raportin e analizës së punës një veieçare e mbajti kryetari i kësaj organizate z. Edmond Agolli. Kjo organizatë veprimtarinë e saj atdhetare e ka shtrirë në gjithë hapësirën e dy bashkive, atë të qytetit Durrës e të qytetit Shijak. Në këtë takim pune pjesëmarrësit ishin jo vetën nga qyteti Durrës, por të pranishëm aty ishin nga gjithë organizatat duke filluar nga Ishmi, Manza e Shikjaku.



Gjithashtu, në këtë veprimtari pune analitike merrte pjesë edhe Dailan Buxholi, Sekretar i Përgjithshëm të LANÇ. Në këtë takim, u mbajt një minut heshjtje në nderim të dëshmorëve e të pasardhsëve të tyre, të cilët janë ndarë nga jeta!

Si nga raporti i mbajtur, ashtu edhe nga diskutimet të cilat ishin të shumta, dolën në pah puna e bërë deri tani nga organizatat që zhvillojnë veprimtaritë e tyre atdhetare në rrang bashkie. Eventet janë të shumta të kësaj organizate, duke ruajtur vlerat atdhetare, pasyrimin e tyre me vlera të reja të harruara nga koha, përkujtimore të datave historike, siç ishte veprimtaria përkujtimore e 7 prillit 2019, e cila u organizua në qytetin e Durrësit me rastin e rezistencës të popullit shqiptar kundër fashizmit Italian më 7 prill 1939 etj. Në raport u theksua që bashkëpunimi midis Organizatës Kombëtare të Dëshmorëve

veprimtaria e saj duhet të shtrihet në gjithë shkollat si në ato 9 vjeçare, po ashtu edhe të mesme, që vleit atdhetare të përvetësohen e njihen nga brezat e rinj. Një shqetësim i kësaj organizate ishte ruajtja e relikeve e armëve të Luftës Parë e Dytë Botërore në Mauzoleumin e qytetit të Durrësit, i cili është një nga muzet e rrallë në ballkan e më gjerë. Për vlerat atiketurore të këtij muzeu kanë dhënë vlerësimet edhe të huajt si Francezët e Italianët, kur kanë bërë vizitat e tyre tek ky Mauzoleum. Projekti i ri i paraqitur para disa vitesh për rikonstruktuar e shtuar edhe një kat tjetër ka mbetur në letër. Si rrjedhojë e ngushtimit të hapësirës në këtë muze, relike të luftës, por edhe disa buste të dëshmorëve rrinë në disa hapësira jo të përshtatshme.

U kërkua nga ky takim, që bashkia Durrës, sektori i Kulturës si në bashkitë e prefekturë, të investohet në riparimin e shkallëve egzistuese me mermer të kuq e bardhë, dhe diku aty në ambientin egzistues të vendosen bustet e 6 dëshmorëve. Një detyrë e kësaj organizate ishte edhe për ngritjen e një muzeu në Porto Romane, sepse aty është një pjesë e historiës e popullit tonë në shekuj. Kjo do ja shtonte edhe më shumë vlerat historike qytetit të durrësit, por edhe do tërhiqte më shumë vizitorë të huaj në njohjen e historisë sonë për gjatë shekujve në lidhje edhe me popujt e tjerë, si ballkanas e perndimorë. Një tjetër aspekt njohja e vlerave që ka muzeu entografik "A. Moisiu" nga brezat e rinj, apo vizitorët nga vendet e tjera të cilët i pret me kënaqësi qyteti ynë turistik me histori e kulturë të lashtë. Durrësi ka mjaftë hapësira publike nga ku mund të vendosen shumë buste të dëshmorëve të atdhut. Ligji ri që është miratuar nga qeveria për statusin e dëshmorëve, jep hapësirë për njohjen edhe të atyre të cilët në rrethana të ndryshme kanë dhënë jetën e tyre për atdheun.

Në këtë takim foli edhe Dailan Buxholi. Në fund të takimit u bënë pranime të reja të pasardhësve të familjeve të Dëshmorëve të Atdheut. Gjatë mbledhjes u bënë mjaft sugjerime, por edhe detyra të cilat u përfshinë në planin e punës kalendarik që do zbatohen në muajt e ardhshëm të vitit 2019, që është viti i 75 vjetorit të çlirimit të atdhut. Organizata Kombëtare të Dëshmorëve të Atdheut, ka një bashkëpunim të ngusht e parësor me degën e Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të qytetit Durrës, të cilët me shkrimet e tyre pasqyrojnë tek revista "Pavdekësia" veprimtaritë që zhvillon shoqata.

Durrës 21 Prill 2019

1 Prill 1999 – 1 Prill 2019,- 20 vjetori i Qendrës së mobilizimit të luftëtarëve UÇK-së, "Drenica" Durrës

" Kjo është një Fortesë, një Kështjellë e pamposhtur,që politikanët nuk e kanë shumë për qejfi... "Drenica" e Durrësit dhe familja atdhetare KAPITI, meritojnë shumë , por, mjerisht, kjo është politika jonë e sotme".(Spartak Ngjela , Durrës 5 Gusht 2008) Shumë nga ata të cilët e kanë shfrytëzuar dhe kanë spekuluar me luftën dhe me sakrificat e saj për lirinë dhe për shtetësinë e Kosovës, ata të cilët pas lufën e shfrytëzuan për interesa personale politike e pushteti nuk u bie në mend dhe as nuk janë të

interesuar për tjetër por vetëm për veten e tyre, për interesat e ngushta personale, klanore e familjare. Prandaj edhe doli parashikimi i politikanit Ngjela që: “Kjo është një Fortesë, një Kështjellë e pamposhtur, që politikanët nuk e kanë shumë për qejfi”. Kjo ngjarje që ka të bëjë me qendrën “Drenica” ka rëndësinë e saj si një faqe e lavdishme në Historinë tonë kombëtare, pasi këtu duke iu përgjigjur thirrjes dhe kushtrimit për liri, aty mbërritën me mijra e mijra vullnetarë nga të gjitha shtetet ku kishte diasporë Shqiptare nga Perëndimi si: Gjermania, Italia, Franca, Britania, Suedia, Austria e deri nga SHBA, Australia e Kanadaja si dhe luftëtarë patriotë e liridashës nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi e Kosova Lindore.

Qendra “Drenica” e Durrësit të sjell në kujtesë Lidhjen gjithëkombëtare të Prizrenit.

“Drenica” e Kapitëve të Durrësit u bë epiqendra kryesore që tërhoqi vëmendje jashtëzakonisht të madhe ndërkombëtare, ku për çdo ditë aty instaloheshin mediat kryesore ndërkombëtare perëndimore dhe botërore; aty pasqyrohej mbërritja dhe rekrutimi i luftëtarëve të UÇK-së, nga aty ato, mediat ndërkombëtare, merrnin informacione edhe për gjëndjen dhe situatën shumë të rëndë në Kosovë prej dëshmitarëve realë dhe okularë pasi për çdo ditë mbërrinin te “Drenica” e Durrësit qytetarë të dëbuar e të përndjekur nga makina ushtarake vrasëse dhe genocidiste serbe, ku te “Drenica” e Kapitëve të Durrësit bëhej edhe bashkimi i familjeve kosovare të dëbuara nga genocidi serb. Te “Drenica” e Durrësit bëhej takimi edhe i prindërve e pjestarëve të familjeve me bijtë dhe me bijat e tyre që vinin vullnetarë nga perëndimi për t’iu bashkangjitur luftëtarëve të UÇK-së. “Drenica” ka qenë pika e parë e kontaktit, si porti dhe porta pritëse dhe përcjellëse pashqiptare ku vinin, pritëshin e përcileshin në ditë për në betejë qindra vullnetarë e luftëtarë të lirisë ashtu sikurse me të drejtë shkrimtari Thanasi Mustaqi e ka quajtur “Drenicën” e Durrësit “MEKË” ATDHEDASHURIE. Prej “Drenicës” bëhej ndërkombëtarizimi mediatik i Çështjes Kombëtare Shqiptare dhe i Ushtrisë më të re të Europës, i UÇK-së, karakteri luftarak dhe çlirimtar i një lufte burrërore, të pastër dhe heroike e cila kishte si aleat të saj Fuqinë ushtarake më të madhe botërore, NATO-n e drejtuar nga SHBA. Nga “Drenica” e Durrësit UÇK-ja u quajt me meritë prej sekretarit të saj, si këmbësoria e NATO-s.

Te “Drenica” e Durrësit mbërriti Batalioni “Atlantiku” nga SHBA.

Te “Drenica” e Durrësit mbërriten dhe iu bashkangjiten vullnetarëve të UÇK-së, shumë e shumë vullnetarë me kombësi të huaj nga vënde e shtete të Europës Perëndimore të cilët e kishin parë dhe kishin mësuar për qendrën e rekrutimit “Drenica” të Durrësit nga mediat e televizionet kryesore europiane e botërore, mediat të cilat mësonin dhe informonin opinionin ndërkombëtar për masakrat çnjerëzore që bënte ushtria kriminale serbe me torturimin, vrasjet, djegiet, rrënimin dhe shkatërrimin e shtëpive, fshatrave dhe të qyteteve në Kosovë. Për “Drenicën” e Durrësit është folur, shkruar, filmuar dhe dokumentuar shumë sidomos nga ish-vullnetarë të UÇK-së, nga shkrimtarë, gazetarë, media kombëtare e ndërkombëtare, intelektualë, historianë, akademikë, ushtarakë, familjarë dëshmorësh dhe heronjsh nga Shqipëria, Kosova e diaspora. Te “Drenica” e Durrësit në përkujtim të kësaj ngjarjeje të madhe kombëtare është ngritur edhe memoriali i “Luftëtarit të Lirisë”. “Drenica” e Durrësit është edhe një vënd peligrinazhi shumë i vizitueshëm nga turistë e pushues që vijnë dhe e vizitojnë qytetin turistik të Durrësit. Madje këtë vënd historiko-gjithkombëtar e kanë vizituar edhe ish-vullnetarë të huaj të UÇK-së si dhe gazetarët e reporterët e mediave të huaja të cilët kanë qenë aty në kohën kur te “Drenica” bëhej mobilizimi dhe rekrutimi i luftëtarëve të UÇK-së. Për “Drenicën” e Durrësit, për këtë qëndër të historisë sonë kombëtare dhe për Familjen e Sadri KAPITIT, për kontributin e saj për Kosovën është shkruar edhe një Libër voluminoz i autorit Bedri TAHIRI me titull “Atdhetarizmi jeton në përjetësi”, një libër hulumtues, evidentues dhe vlerësues i historikut kombëtar, si një pasuri e madhe enciklopedike dhe e jashtëzakonshme gjithëkombëtare, ilustruar me fotografi, biseda, intervista me personazhe realë dhe dëshmitarë të veprimtarisë së madhe patriotiko-kombëtare të familjes së Sadri Kapitit, bijve dhe bijave të tij të cilët vunë gjithçka në shërbim të atdheut e të kombit për lirinë e Kosovës ku po citojmë disa prej tyre:

“Drenica” e Durrësit është qendra kryesore e frymëzimeve atdhetare... është Tempull atdhetarie. Më vjen mirë që kjo shtëpi lirie e tempull i atdhetarisë u pagëzua nga poetët dhe artistët. Ajo e ndërshqiptarizoi këtë vënd, nga i cili buroi jetësimi i çështjes sonë madhore, lirimi kombëtar”. (Nga poeti dhe akademiku i shquar Xhevahir Spahiu). “Populli e ka shpallur me zemër “Drenicën” e Durrësit një “Mekë” atdhetashurie”. (Nga publicisti dhe gazetari Thanas Mustaqi) “Emri i nderuar “Drenica” do të kujtohet gjithashtu edhe si kontribut atdhetar e patriotik i djemve të familjes së respektuar Kapiti. Ajo meriton që të bëhet një qëndër e edukimit atdhetar dhe patriotik të brezit të ri”. (Nga Bujar Muharremi, Ish-diplomat e ambasador i Shqipërisë në Kosovë) “Ky është një monument historik, i cili si i tillë duhet të përjetësohet nga të dy qeveritë tona, në Tiranë e në Prishtinë”. (Nga Ilir Malindi, avokat dhe shkrimtar)

Gjithashtu një numër i madh personalitetesh të lartë, akademikë dhe intelektualë si dhe shumë shoqata kombëtare kulturore, artistike e patriotike kanë propozuar te institucionet më të larta të Shtetit Shqiptar që “Drenica” të shpallet muze, dhe po gjithashtu kanë propozuar edhe për dekorimin e familjes së Sadri KAPITIT për kontributin e madh të tyre dhënë për Çështjen kombëtare.

SOCIALE

Invalidët duam zbatimin e ligjit, jo premtime

Duke ndjekur disa intervista në disa televizione, të cilët kishin intervistuar përfaqësues të shoqatës së invalidëve të punës e të verbërve, më bëri përshtypje se ende s’po gjen zbatim ligji i qeverisë e udhëzimet e saj nga agjencitë e autobusëve të udhëtarëve. Nga pyetjet e intervistat e transmetuara edhe nga televizori “Adriamedia” publikut iu bë e njohur se, agjencitë e transportit të automjeteve me autobus ndërqytetëse, ende nuk zbatojnë ligjin e transportit të udhëtarëve me 50 për qind të vlerës, pra të invalidëve në përgjithësi e, në veçanti, invalidët e punës.

Ky problem e shqetësim që kanë Shoqatat, dhe, më konkretisht, Shoqata e Invalidëve të Punës, ka vite që ngrihet si problem pranë institucioneve përkatëse, por edhe sot ky shqetësim sa i drejtë dhe ligjor nuk po gjen zbatim konkret. Kjo u bë shkas dhe e drejta ligjore, e me të drejtën që u jep ligji këtyre drejtuesve të shoqatave, të cilët kërkojnë vetëm zbatimin e ligjit nga agjencitë e transportit të udhëtarëve. Vetiu del pyetja: Kur do gjejë zbatim

konkret në teren ky ligj?!Mesa duket shkelësit e ligjit kanë rënë në ujdi me aferat korruptive në kurriz të xhepit të boshatisur të invalidëve. Të tillë njerëz janë të pa shpirt dhe jo human, deri në arsyen e të "fortit" edhe ndaj ligjeve të shtetit. Nga intervista te transmetuara televizive, ato lanë gjurmë të shëndosha tek dëgjuesi ynë, por na habit fakti se asnjë institucion shtetëror e përfaqësues të dikastereve s'e morën mundimin e të bënte replikë me këta të fundit, pra kryetarëve të shoqatave si përfaqësues ligjorë në mbrojtjen e të drejtave të 70 mijë invalidëve në shkallë vendi. Udhëtimi falas për kategoritë e udhëtarëve (të invalidëve) kur ata udhëtojnë brenda qyteteve, ligji ka gjetur zbatim korrekt, e duhet falënderuar këto agjenci, sepse në radhë të parë zbatojnë ligjet e shtetit, ky i fundit është në shërbim të qytetarit, në rastin konkret të invalidëve të të gjithave kategorive. Por problemi qëndron tek mos zbatimi i këtij ligji për linjat e autobusëve të udhëtarëve që vijnë nga rrethet e ndryshme të vendit drejt kryeqytetit tonë, Tiranës. Invalidët akoma paguajnë biletë të plotë kur ata udhëtojnë për arsye të ndryshme drejt Tiranës. Kjo është shkelje e hapur, duke i thënë ligjit të shtetit "jam unë pronari, ligjin e bëj si të dua vetë". Shtrohet pyetja: Kur do gjejë zbatime dhe në këto linja të transportit të udhëtarëve ndër qytetëse për invalidët!?



Kur?Kjo është e saktësuar edhe në botimin e fletores zyrtare të Republikës së Shqipërisë, dt. 24 nëntor 2016, (Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare). Aty ku

zbatohet ligji qytetari ndihet më komod, por edhe ndërgjegjësohet tërë shoqëria. Pra, i ndërpritet rruga keqbërësve, e duke zbatuar ligjin e shtetit i themi: "Këtu ndalu beg, se ka hendek!". Por, ky ligj i qeverisë dhe udhëzimi i ministrisë përkatëse s'po gjen zbatim të plotë nga disa pronarë apo individë autobusësh të linjave ndër qytetëse. Këta "pronarë" apo individë të veçantë të pandërgjegjshëm dhe abuzues ndaj ligjeve të shtetit, duhen ndëshkuar sipas ligjit, por edhe nga tërë shoqëria. Të abuzosh ndaj invalidëve, të kësaj shtrese fatkeqe të shoqërisë, duke i trajtuar me një sjellje arrogante, deri në fyerje (morale e financiare), i ke vrarë për së dyti herë, i ke diskretituar me këtë mënyrë e vrarë moralisht e shpirtërisht! Njerëz të tillë janë të pashpirt, ata jo vetëm s'duan t'ia dinë për këtë shtresë të shumëvujtur të shoqërisë, por arrijnë deri aty sa të ngrenë dorën "vrastare" edhe ndaj ligjeve të shtetit, si rrjedhojë duke iu futur "dorën" edhe në xhepin e invalidëve financiarisht. Në fletoren zyrtare drejtuar shoqërive urbane, por edhe shoqatave të ndryshme deri tek Shoqata e Invalidëve të Punës, kërkon në udhëzimin e saj që të zbatohet me përpikëri ligji nga këto të fundit, ndryshe ato do ndëshkohen. Në interesam pranë Shoqatës së invalidëve të punës dega Durrës, për mbarëvajtjen e zbatimin e këtij udhëzues të qeverisë "Rama". Shkak u bënë denoncimet nga vetë invalidët në përgjithësi e, në veçanti, invalidët e punës që kanë depozituar biletat e autobusëve të linjave të ndryshme, ku këta të fundit kanë paguar biletën e udhëtimit 100 për qind, sepse dëshmia invaliditetit të paraqitur prej tyre nuk është marrë parasysh nga faktorino dhe pronarët e autobusëve. Si rrjedhojë e kësaj, invalidë të ndryshëm shprehen, se edhe janë kërcënuar me zbritjen nga autobusi apo edhe ofenduar me fjalë fyese. Kjo sjellje nuk i përket shërbimit të kulturuar ndaj qytetarit e njerëzve, por me të rëndojnë me dashje e pa dashje xhepin e qytetarit (në rastin konkret, invalidin), udhëtarin por diskreditojnë e shkelin në mënyrë flagrante ligjin e udhëzimet e tij. Në shoqatën e invalidëve të punës, dega Durrës, nga janari – tetor 2018, janë me dhjetëra denoncime të tilla nga invalidët që u ishin shkelur të drejtat ligjore për udhëtime me vlerën 50 përqindëshit të pagesës së biletës. Më konkretisht në linjat; Tiranë- Durrës, Durrës- Fier, Kamzë – Durrës, Durrës – Golem etj. I sollëm këta shembuj për të treguar, se akoma s'po gjen zbatim ligji e udhëzimi i qeverisë, tashmë i shpallur edhe zyrtarisht edhe në fletoren zyrtare

që prej 3 vitesh. Vetë shteti dhe organet përkatëse, duhet t'i ndëshkojë këta të fundit që nuk respektojnë të drejtat e qytetarëve, por edhe shkelin ligjet e shtetit, me pretendimin absurd "ne jemi privat, s'pyesim shtetin, apo duke u shprehur deri aty sa 'unë e zbatoj ligjin (në fakt s'e zbaton), invalidët lozin bixhoz". Mendojmë se në çdo autobus udhëtarësh duhet të ketë të afishuar ligjin përkatës, që ligj-shkelësi të mos ketë mundësi për abuzime apo përdorimin e shprehjeve banale ndaj qytetarit në përgjithësi, e në veçanti ndaj invalidëve të çdo kategorie. Kjo do i ndërgjegjësonte abuzuesit e ligjit, por edhe shoqërinë në përgjithësi në respektimin e ligjit, por udhëtarëvetë shtresës së invalidëve! Duke iu referuar edhe fletores zyrtare, ne shkëputëm këtë paragraf të tij:

"Mbajtësi i licencës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr.7889/94, të ndryshuar, nr.7663/93; nr. 8626/00, të ndryshuar ku aty përcaktohet se: *"Invalidët e punës, invalidët e Luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë me 50 për qind të vlerës së biletës"....* Pra, ligji e thotë qartë, shkelësit duhen ndëshkuar, sepse siç thotë e cituar në fletoren zyrtare, ka masa administrative, plotësuese e pezullimit të licencës nga 6 deri në 12 muaj. Invalidët kërkojnë zbatimin e ligjeve, jo të diskreditohen deri aty duke u marrë edhe qindarkën e fundit nga xhepi nga njerëz të papërgjegjshëm e shkelës të ligjit. Me të drejtë invalidët shtrojnë pyetjen legjitime: Kur ligji do bëhet funksional i shprehur edhe në letër; 8308 dt. 18.03.1998, i botuar edhe në fletoren zyrtare të qeverisë, a do gjejë zbatim konkret që qytetari invalid ta ndjejë vetën më komod, e të thotë se paska vërtet shtet! Invalidët kërkojnë dinjitetit e tyre që u jep ligji dhe jo lëmosh. Me të drejt shoqatat e invalidëve shtrojnë pyetjen: Pse ligji zbatohet me dy standarde!?

Botuar në gazetën 'telegraf' dt. 11 dhjetor 2018

Nën petkun e “Pandamisë” korrupsioni po zhvat edhe xhepat e invalidëve

Mjetet e transportit publik në qytetin e Durrësit, kanë katër muaj që nuk njohin Dëshmitë e invaliditetit për udhëtim për këto kategori udhëtarësh. Ligji i shtetit shqiptar e ato ndërkombëtare ua japin të drejtën ligjore, por “maliqtë” e qytetit të Durrësit kanë dalë mbi ligjet e shtetit. Përgjigjen nga strukturat shtetërore ligjore si në Bashki ashtu edhe në Prefekturë, deri më sot janë në nivelet e serixhinjve. Si rrjedhojë e kësaj ,po poshtërojnë këtë kategori fatkeq duke zhvatur ende edhe sot xhepat e invalidëve të gjithë kategorive. Statusi ligjor ua jep këtë të drejtë legjitim , por mesa duket “maliqtë” të cilët kanë detyra funksionale në strukturat qeveritare lokale,preferojnë më mirë të shkelin ligjet e shtetit sesa ta zbatojnë atë. Për zgjidhjen e problemit të invalidëve e gjithë udhëtarëve që përfitojnë për udhëtim me mjetet e transportit publik falas, Shoqata e Invalidëve të Punës, kanë trokitur disa herë në këto zyra, por ende problem s’ka gjetur zgjidhje. Në autobusa janë afishuar lajmërimi se “Pritet një urdhër i dytë” ...Por kanë kaluar katër muaj, e akoma nuk dihet se kur do marri fund ky ankth “pretjeje”, që invalidët si të punës ashtu edhe të luftës të udhëtojnë me dinjitet me autobus, e jo duke i poshtëruar me mos njohjen e dokumentit ligjor që ua jep ligji. Ata s’duan mëshirë, por zbatimin e ligjeve të shtetit, dhe gjetjen faktike zbatueshmërie të së drejtës që ua jep ligji edhe ai ndërkombëtar. Përgjigja skeletive e strukturave të qeverisjes lokale, veçse ka rënduar xhepat e invalidëve në këto katër muaj të mos njohjes së dokumentit ligjor të cilët disponojnë. Lind pyetja : Deri kur do presin invalidët zotrinj zyrtarë !? Apo siç flitet sa andej – këndej se, të shohim nga fundi i këtij viti, jemi në pandemi të covidit – 19. Sa çudi !? Sepse çudishkelësit e ligjit, vazhdojnë me mashtrime dhe pa u hyrë gjembi në këmbë,vazhdojnë të zbrazin xhepin e invalidëve.Ku është shteti dhe qeveria në këtë rast? Po e drejta e qytetare dhe zbatimi i ligjshmërisë që ua jep ligji, kur do gjejë zbatim konkret edhe për rastet e udhëtimit ndërqytetase nga kjo kategori?! Shkelësit e ligjit duhen ndëshkuar nga strukturat shtetërore, dhe jo të bëjnë rolin e shirxhiut e të korrupsionit.Invalidët kërkojnë ndërhyrjen urgjente nga qeveria e gjithë strukturat e saj, sepse po u bëhet një padrejtësi duke shkelur ligjet e shtetit.Nën petkun e “Pandamisë” korrupsion po zhvat edhe xhepat e invalidëve. Katër muaj s’janë pak duke iu thënë invalidëve se, nuk i njohin dëshmitë ligjore të lëshuara nga shoqata e tyre.

Gazeta “Bulevard” dt. 20 qershor 2020

REFLEKSION

‘Imagjinata VS’ një krenari e vetëdijshme që mbartë vlera letrare

Duke i hedhur një vështrim të përgjithshëm librit të autores Vlora Banushaj Krasniqi me titullin aq domethënës „Imagjinata VS”, ndjen një krenari të vetëdijshme kur i lexon tregimet të

formëzuar në ese. Ato marrin me vete atë pjalm e polen gjallërie përgjatë lexueshmërisë sonë si lexues, saqë të rrëmbejnë pas tyre për t'i lexuar gjër në fund. Në tregimet e shkruara prej autores Vlora Banushaj Krasniqi, do gjesh atë frymëzim që na jep jetë e dashuri njerëzore në pafundësi. Në stilin e saj të shkruar, Vlora, dallohet për një arritje cilësore letrare me mënyrën e stilit kur ajo merr penën për të derdhur mendimet në letër. Kjo e bën autoren që t'u shkojë hap pas hapi rrugëtimit krijues, si një gërshet të thurur me fjalën magjike plot tharmë poetik, fjalëve të shprehura në formën e prozës. Në gjithë tregimet e paraqitura tek ky vëllim i dytë prej saj, na rrëfen atë dialog letrar me shumë fines e plot ngjyra letrare. Kur lexon këtë vëllim, jo vetëm të tregimeve, të cilat i ngjajë pemës së lulëzuar pranverore, të ngrohin shpirtin njerëzor dhe të fusin në labirintet e kthjellta të imagjinatës së detit e të oqeanit krijues. Si rrjedhojë e kësaj imagjinate me plot iluzione shprehëse optimiste; na duket sikur fluturojmë drejt hapësirës blu të qiellit që nuk ndalet kurrë. Pikërisht, kjo ka ndikuar që edhe vetë titulli i librit të marrë trajta e forma interesante, i cili e mban të mbërthyer lexuesin tonë që t'i shkojë deri në fund lexueshmërisë së librit me titullin „Imagjinata VS”. Si një fjongo gërsheti të një vajze, përshkruhen edhe titujt e tjerë nga këta autorë tek ky libër. Në themelin letrar artistik të këtij vëllimi, qëndron DASHURIA NJERËZORE! Lajtmotivi i Imagjinatës shkon deri aty ku na thotë qartazi se: „Imagjinata të çon deri aty në kufirin më të bukur që ne e quajmë kopshtin e LUMTURISË!”. Dhe kjo është mëse e vërtetë. Ajo mposht çdo dhimbje, e si rrjedhojë të lartëson drejt qiellit të kaltër për të kapur yjet e dritën e tyre, pra DRITËN E JETËS! Po tu hedhim një vështrim të përgjithshëm brumit letrar tek ky libër, do gjejmë pa frik atë tharm letrar të shkruar bukur artistikisht, si rrjedhojë do gjesh tharmin e jetës. Këto i gjen me krenari që shprehin mall e gëzime, dhimbje e optimizëm, dashuri njerëzore, ku loti bëhet si një „meteor” i florinjte e rrezaton si dielli duke shëruar plagdhimbjet njerëzore.

Pra, shkrimtarja është vetvetja, prandaj ajo shkruan në vetën e parë, me një imazh domethënës: DASHURINË për JETËN! Në gjithë lëmin krijues të paraqitur në këtë vëllim të ri „Imagjinata VS”, duket si drita e diellit, si varka lundruese që përshkon „detin e oqeanin” me lirikën e stilit të shkruarit që lexuesi do i gjejë pa vështirësi në këtë libër. U ndala për të bërë këtë parantezë, sepse dua që lexuesin të mos e lodh shumë, por ai të kapi valët magjike të lumit letrar që na përcjell ky libër. Në brendësi, përveç tregimeve të formatuara në ese, janë shkruar edhe thënie filozofike, ku mesazhet që na përcillen ne si lexues, janë të fuqishme, plot kolor me filozofinë e tyre frymëzuese për jetën tonë të përditshme. Por edhe poezitë të një forme pentagramesh, të japin atë ndjesi të brendshme, ku reflektohet hapur ai zjarr i pafund i dashurisë njerëzore.

Ne pa japim disa sekuenca rreth këtyre lëndëve shkrimore të refleksionit letrar analitik, sepse autorja ka ditur të na sjellin atë tharm letrar të spikatur te libri „IMAGJINATA VS”. Mesazhet janë të dukshme, ato shkrepitjnë si rrufetë qiellore e bëjnë dritë në shpirtin tonë njerëzor. Këto i gjejmë tek tregimet „NË PRAG TË VITIT TË RI, U ULA DHE SHKROVA...”, „NË MBRETËRINË E TRËNDAFILAVE”, „UDHËTIM NË VIJË KOHORE...”, „KOPSHTI I MIQËSISË SË ARTË”, „PARA PASQYRËS SË JETËS”, etj. E gjithë gama e shkrimeve ka një

frymëmarrje, ku spikatet me gjithë ngjyrat e jetës brumi letrar. Si rrjedhojë, mendimet e imagjinatës arrijnë të prekin çdo skutë të qelizës sonë njerëzore, sepse me një mjeshtëri të kulluar artistike është gdhendur fjala e mendimi imagjinar, i afrohet të së vërtetës e botës shpirtërore njerëzore. Këtu, marrin udhë të gjitha iluzionet tona me qëllimin e vetëm: Në lëmin e Dashurisë për tek kopshti i trëndafilave të JETËS! Po japim disa fragmente të shkurtra të shkëputura nga disa tregimet prej këtij libri, si më poshtë vijon: nga tregimi "Në prag të viti të ri, u ula e shkrova", „*Por, ky muaj ma solli në dorë një ëndërr që e kisha kur isha në moshën e artë të fëmijërisë. Dhurata me e veçantë nga një qenie e veçantë m'u dhurua. Jeta ime atë ditë e kishte emrin Lumturi.„Imagjinata V*” është përmbledhur e përgatitur e tëra. *Kështu quhej ëndrra ime e jetësuar! Dhe tash erdha këtu pra në muajin dhjetor... dhe çfarë mund të them për këtë Vit?!*”, apo tek tregimi „Në mbretërinë e trëndafilave”, „...*Dhe për çudi, në mesin e këtyre ngjyrave hyjnore, e ndjej vetën si mbretëreshë në një mbretëri trëndafilash, - e herë si engjëll që endem nëpër petalet e këtyre trëndafilave. Dhe sa herë që e ndjej vetën si një engjëll, unë thur dëshira për një shkëlqim. Por, edhe kur e ndjej vetën si mbretëreshë nën mbretërinë e trëndafilave, unë shpërndaj aromë për një shkëlqim.*” Dhe vazhdon tek tregimi „Udhëtim në vijë kohore”: „*Kështu, që rrugëtimi vazhdon në rrugën e tij të shtruar në dje-sot-nesër, e jo nesër, e pastaj në sot, ngase e SOTMJA i jep jetë të NESËRMES. Çfarë ngjyra do të hidhen sot, edhe piktura do të jetë e tillë!*”. Një fragment i shkëputur nga tregimi „Kopshti i miqësisë së artë”, „*Dhe sa herë që dallim nga aty, për t'u ritakuar në ditën tjetër, me vete marrim shkëlqimin që na jep ylberi i harkuar në qiellin vezullues, si kurorë e një miqësie të vërtetë njerëzore*”. Lajmotivi i tregimeve (ese) janë si një buzëqeshje zemrash, ku në themelin kanë Jetën, e në boshtin e tyre filozofik qëndron fort ai mendim si një gonxhe trëndafili, ku petalet zbresin ashtu ngadalë për tek ZEMRA TONA NJERËZORE! Kurse te tregimi "Para pasqyrë së jetës" na jep këtë fragment të bukur sa artistikisht aq edhe filozofik: „*Duke menduar kështu, e dëgjova një zhurmë! U drejtova në drejtim të asaj që e dëgjova më tej, -ishin "ca pika shiu"... e pas kësaj rrezet e arta të diellit takohen me shikimin tim, dhe më duket se e mora një përkrahje të fuqishme në këtë rrugë të gjatë që jam nisur...*

E unë vazhdoj të mendoj me zë para pasqyrës së jetës sime, sa herë takohem me vetën...?!

Unë vazhdoj ta lexoj jetën...! Vazhdoj t'i dëgjoj tingujt e jetës, dhe sigurisht t'i buzëqeshë asaj që e ka emrin JETË!”

Sigurisht, Vlora Banushaj Krasniqi kërkon nga vetja e nga të tjerët, që në zemrat tona përgjatë rrugëtimin të jetës, të lundrojnë gëzimet me qëllimin e vetëm: aty në zemrat e njerëzve të buzëqeshin në kopshtin e artë përherë GONXHET E JETËS! Ajo e përmbyll aq bukur këtë mesazh, sa që vetja të duket sikur rrugëton me të vërtetë nëpër kopshtin e trëndafilave. „*Në vesh një trëndafili i thash: A e din se çfarë ka të re? Unë prapë jam zgjuar, unë prapë do ta hedhë një emocion në fletët tuaja. E, Ai trëndafil lehtas më buzëqeshi, e më tha: U gëzova shumë! Shkruaj të lutem. se kështu dua të të shohë, përherë të zgjuar, duke shkruar vazhdimisht...!* „*E kur arrita këtu ku jam, ZEMRA po më thotë të shkruaj kështu: „SA MË SHUMË RRUGË TRËNDAFILASH PAQI NË JETËN TUAJ, TË GJITHË JU O NJERËZ TË MIRË*”.

Është befasuese, por edhe e kuptueshme, sepse autorja e këtij libri, ka gjetur atë rrugë të gjatë, por me buzëqeshje JETE! Gjithë lumturinë e saj ia ka lënë kohës së pafundme... e si rrjedhojë e kësaj gjen atë KOHË të ARTË, e ulet e krijon edhe me Sabir Krasniqin (ku bashkudhëtojnë së bashku si një e të pandarë), duke shkruar fjalët e bukura shqipe në letër. Këtu merr një kah tjetër me të vërtetë jeta e PAVDEKËSISË së tyre. E themi këtë, jo për parantezë, por është më se e vërtetë: Dy mendje e dy zemra hedhin të shkruara në letër mendimet e tyre. Kjo është sa magjike, ashtu edhe HYJNORE, sepse fjala e shkruar mbetet në shekuj, ajo të PËRJETËSON! Me thëniet e arta të formuluar prej tyre, është një domethënie e madhe, ka peshën e maleve e të deteve. Të bashkosh dy mendime në një të vetëm, sikur janë mendimet e dy autorëve të këtij libri „Imagjinata VS”, është sikur të bashkohet qielli me tokën. Por ja, kjo ka ndodhur me të vërtetë. Lexuesi do e gjejë fare të lehtë tek „Thëniet e arta për jetën” në brendësinë e librit. Po e ilustruam konkretisht me disa shprehje me përmbajtje filozofike e letrare të formuluar prej tyre... Dhe shkruajnë... ”Një petal buzëqeshjeje me gjithë zemër, derdhi plot nektar, nga i cili u ushqyen e po ushqehen, pandërprerë qeniet tona, dhe të gjitha këto petale formuan lulen e MIQËSISË TONË TË ARTË!”.

-Dhe vazhdon...

„Sa herë hapet një petal i Miqësisë

Shpirtërisht yjet në engjëj i kthen,

Paraajsën gjithmonë në tokë e sjell,

Magjinë hyjnore në dëshirë ta ndjell.

Sa herë hapet një petal i Miqësisë

Aroma e saj si nektar jete, shpirtra ushqen,

Bashkë me ngjyrat me të bukura të jetës

Shkëndijat e shuara në shkëlqim të artë i rikthen.”

-Dhe e mbyllin me këtë paragraf letrar filozofik:

„Miqësia është më shumë se një fjalë e thjeshtë. Mund të tentojmë ta përshkruajmë, por, vetëm një komunikim maratonik me letra që transmetojnë mendime, ide, porosi brilante dhe të arta që jetojnë nëpër kohë, i japin kuptimin e drejtë dhe të mirëfilltë. Lum kush e përjeton këtë MIQËSI HYJNORE!”.

Pa buzëqeshje s'ka jetë. Pikërisht, ajo është burimi i të gjithave, i mirësisë kur, i buzëqesh nga zemra, me pastërtinë Hyjnore të PERËNDISË! Vlora Banushaj Krasniqi, e shpreh fuqishëm këtë në gjithë pentagramet letrare me përmbajtje filozofike. „Mbështetu në BUZËQESHJE! „Një nevojë e imja, por, jo vetëm e imja, besoj e secilës qenie njerëzore në këtë univers, Buzëqeshja!” Të urresh, thotë autorja është gjëja më e shëmtuar e kësaj bote. Urrejtja është manifestim i brendshëm që e kultivojnë vetëm ata njerëz, të cilët kanë një botë shumë të vogël në shpirtin e tyre. Pra, të urresh, është dështimi më i keq i qenieve njerëzore. Prandaj autorja bën një reflektim të qartë e thirrje nga zemra e saj, që të mbjellim dashuri sa të jemi në këtë botë! Kjo reflektohet edhe në tregimin „Mesazh festiv” ku, me bashkautorin S. Krtasniqi, shprehen kështu „Të kultivojmë vetëm farën e dashurisë - frymën hyjnore, në të gjithë hapësirën e këtij Kopshti të parajsorë, që frutat e saj t'i ndjejmë, t'i shijojmë, t'i përjetojmë, ...Urojmë që kjo perlë e lumturisë ta stolisë zemrën e secilit nga ju - zemrat e gjithë njerëzimit! GËZUAR!” Tek poezia „Miqësia e artë”, bashkautorët na sjellin një tjetër tablo, ku mendimi e fjala e formësuar në fjali poetike, jep atë mesazh drite që na ngroh zemrat ne si qenie njerëzore. „Miqësia e Artë zbret nga lartësitë më të pastra hyjnore, prandaj i ngre gjithnjë lart në pedestal ata që e mbartin. Prej këtyre njerëzve bota zbukurohet e ndodhin mrekullitë!” apo, „Mik i vërtet është dikush që e njeh melodinë e zemrës tënde dhe e këndon atë kur ti ta kesh harruar!..., dikush që të dhuron nektar jete... sa herë që je i mërçitur, dikush që të plotëson, atëherë kur ti harron diçka, dikush që të kupton edhe kur heshtë!”. Dhe në mbyllje tek këto fragmente letrare, por që mbartin zërin letrar filozofik na shprehen kështu: „Rrezet e Miqësisë së Artë e shndrisin qiellin e shpirtit edhe atëherë kur aty mbretëron errësira e plotë!”. ...dhe finalizojnë me shprehjen LAPIDARE: ”Le të jetë miqësia jonë një fanar drite në det, kur ne të ndihemi të humbur në anijen me emrin JETË!”.

Një tjetër dukuri që lexuesi do gjejë në këtë libër, është se do gjejë edhe formën tjetër të një stili letrar të shkruar. Kjo ja rrit edhe më shumë vlerat librit. Të bën kurajoz, sepse forma e dhënë ndërtimore, prek pak poezinë e traditës, por në fakt nuk është poezi e mirëfilltë. Kjo rrymë e stilit të shkruarit, në veprimin e të menduarit e mesazhin që përcjellin, është e formës pentagrame të shkurtra të formatit poezi. Kjo e bën që të ketë atë dallim esencial letrar. Por, që tenton t'i afrohet poezisë së mirëfilltë letrare. Ne, p.sh. po sjellim disa nga këto vargëzime poetike, të cilat të rrëmbejnë në lëmin e tyre të grunjtë, vala e dashurisë ndihet kudo deri në univers. Dhe këto lexuesi i gjen tek poezia me titullin „Çast”, si:

„Kërko dikë që di të të bëjë të buzëqeshësh,

Gjej atë që e bën të qeshë zemrën tënde...

Pasi njeriu më i bukur është ai që sjellë buzëqeshje kudo që vjen!

Mjafton vetëm një buzëqeshje e tij,

për ta kthjelluar qiellin e universit tënd nga çfarëdo lloj vranësire...,

*„Jeta është vijë,
ngjyrën e te cilës e shohim sot,
ndërsa ngjyrat që dëshirojmë t'i shohim
i pikturojmë në galerinë e shpirtit....;*

*„Lumturia është pranë secilit prej nesh,
Mjafton vetëm të hapim zemrën,
dhe ta lejojmë diellin e jetës të shkëlqejë mbi ne!...,*

*„Njerëzve që kanë ditur dhe arritur,
bashkë me ty,
të ndërtojnë Kopshtin parajsorë:
BUKURINË E PËRKRYER TË JETËS!”.*

Vetë JETA jonë është KËNGË! Ajo duhet të këndohet në çdo ditë, sekondë, muaj e vite... Po, po, ajo është burim që s'shteron kurrë e mbjell fidan lumturie në zemrat tona. Kënga e zbukuron shpirtin tonë, shëron plagët, zbut dhimbjet, me tinguj e saj na jep ngrohtësi në çdo qelizë të trupit tonë. E ku ka më bukur se kënga! Autorja e këtij libri Vlora Banushaj Krasniqi na vjen me një arsytim tjetër, në stil, formë ndërtimore të lëndës letrare, në mesazhe, por edhe në paraqitjen e botës së brendshme, ku figurat letrare lëvizin me shpejtësi në gjithë dinamikën e lëndës së këtij libri. Kjo ja ka rritur edhe më shumë vlerat librit.

Simbolikat e përdorura tek tregimi „Monolog” janë kuptimplote; ajo bisedon me vetveten, dhimbja për babain i ka lënë atë plagdhimbje, por edhe dashurinë e madhe që e ruan në folenë e zemrës së saj. Çdo ditë e gjen duke bashkëbiseduar me të atin, në rrugëtimin e vazhdimësisë së jetës, ai i gjendet pranë, në gëzime apo hidhërime. Loti i ngrirë në sytë e saj, ndrit si yjet që zbresin nga malet që vështojnë qytetin e lindjes Pejë, si rrjedhojë i bëjnë dritë në shpirt dhe i japin buzëqeshje. Lot drite, fjalë e shkruar për babain tek ky monolog, është i larë me ujë floriri. E ku ka më bukur të shkruash për prindërit, e sidomos për BABAIN!? Ja si shprehet

Vlora Banushaj Krasniqi tek ky fragment që po sjellim për ilustrim, çka ne kemi thënë si më lartë përmendur:

„...Dhe sa herë që më jehonin këto fjalë inkurajuese në vesh, unë buzëqeshja në heshtje. Doja t'ia plotësoja dëshirën, sepse ashtu ishte dëshira e asaj mendje që unë të buzëqeshë sa më shumë, por, edhe unë sa shumë kam dëshirë që t'ia rikthej këtë nektar jete!...

Të shikoja çdo ditë se si të shuhej jeta dalëngadalë në sytë e tu. E fsheha lotin nga Ti babë. E mbulova dhembjen. I palosa kujtimet për t'i ruajtur me kujdesin ma të madh. Ti ike nga ne me buzëqeshjen, dashurinë, ngrohtësinë, bujarinë, universin e pafund...!

Duke e mbyllur këtu këtë analizë letrare, iu urojmë autores Vlora Banushaj Krsniqi, suksese të mëtejshme në rrugën e bukur të krijimtarisë. Libri „Imagjinata VS” le të ndriçojë semaforët e tij drejtë imagjinatave të JETËS e LUMTURISË NJERËZORE!

Durrës dt. 22 Tetor 2019

“Librat janë ushqim i djalërisë, zbavitje e pleqërisë, stoli e përparimit, mbroje dhe prehje në mundime, dritë në shtëpinë e errët, shokë dite, natën, në ndjenja dhe në udhëtim”

Ciceroni

Studim

Fatmir TERZIU

Celulari mjet më i ri ‘frymëzues’ për krijuesit

Celulari është mjeti më i ri që ka hyrë si një ‘frymëzim’ në krijimtarinë shqiptare. Janë mjaft poezi dhe tregime të krijuesve shqiptarë që kanë si bazë këtë mjet tejet popullor elektronik të komunikimit masiv. I tillë është tregimi i **Roland Gjozajt** “*Tryeza e bukës, celulari dhe i panjohuri*”, tregimi i **Vullnet Matos** “*Celulari flet nga varri*”, që siç vetë Mato shprehet është një tregim i shkurtër disi i veçantë, pasi ngjarja e tij është e vërtetë. Kjo ngjarje ka ndodhur me të birin e aktorit **Kadri Roshi**. Emrat e vërtetë autori i tregimit i ka ndryshuar në funksion të linjës artistike. Një tjetër tregim interesant është ai i krijuar nga dora e papërtueshme e krijuesit

durrsak, **Xhevahir Cirongu** me titull “*Celulari i dashurisë*”. Në mjaft krijime të tjera celulari është thuar një ‘mbret’ i fjalës së bukur. Kështu e transformon atë poeti **Kostaq Duka** në poezinë e tij “*Celulari*”. Duka sjell këtë poezi mes këtyre fjalëve brilante që tregojnë dhimbje dhe përjetësim, përkushtim dhe familjaritet: “*Plotësoi shërbimin celulari, më duhet ta ndërroj....?Më dhimbset./Nëpër mushkëritë e tij/Shpirti im i drithëruar la gjurmë,/Në mijra shpirtra të tjerë rregjistruar./Duke marrë një tjetër më të ri/Më ngjan sikur braktis një mik /Që koha e nxorri në pension.*”

Nuk janë tregimet ato që janë ndikuar për përgjimin e telefonit celular dhe as njerëzit që kanë telefonat celularë si mjet të përgjimit për të siguruar të ardhura në mjedise të ndryshme, objekti i frymëzimit të krijuesve shqiptarë për krijimtarinë e tyre. As ajo që i lidh disa gazetarë në Londër, të cilët kanë përgjuar me telefonat celularë mbi 3.000 njerëz të profilit të lartë, si Elle McPherson, Gwyneth Paltrow dhe madje edhe vetë Kryeministrin.

Telefonat celularë këto ditë janë shndërruar në mini kompjuterë. Ata kanë një sistem operativ. Por ata janë edhe mjeti i ri në meditimet e krijuesve.

Bashkim Sali, duke mos u ndikuar fare me këto ndërlikime, në persiatjen e tij “Biseda të zakonshme, ndërmjet krijuesve” na sjell në ndihmë faktin, se celulari është vërtet një mjet komunikimi, por edhe frymëzimi për krijuesit. Po kështu vepron edhe profesor **Murat Gecaj** kur sjell për lexuesin forcën e këtij aparati të vogël që bashkon kontinentet në bisedë dhe frymëzim krijuesish. “*Nëna ime në Amerikë*” e **Roland Gjozës** është tipike dhe tipologjike në këtë kontest. Më tutje celulari është bërë edhe një frymëzues i këngës. Mjafton të citojmë këngën ‘*Celulari*’ nga **Arjan Korini** dhe shohim se sa fuqi merr ai nën ritmin e saj.

Por më me forcë na vjen humori dhe sarkazma me të cilën godet tregimi “*Teknologji në xhenet*” shkruar nga **Xhenc Bezhi**. Në këtë tregim celulari luan më shumë: “*Ja mori telefonin Saliu, ma i riu prej vëllazënve. Sa e hapi, dëgjoi një za që sikur vinte prej thellësive:*

- Mos u mërzitni për mue, bijtë e mi! Baca juej asht në xhenet ... - dhe biseda u pre pa e mbarue mirë fjalën. E kishin dëgjue të gjithë, se Saliu e kishte lëshue me za të nalt. Verdh, dikush dorën në zemer, dikush zanë kryet me to, ishin shushatë, sa, si i thonë fjalës, me i pre nuk u dilte gjak. - Hoxhë! – iu drejtue Shpendi hoxhë Idrizit, që kishte ardhë t’u bante shoqni në atë mbramje mortore – Ti, çka thue?! - **Me shkue e me hapë vorrin ... Me i marrë celularin!** – foli hoxha gjithë frikë mos po e linte zemra. Pa e zgjatë shumë, u ngriten, moren veglat, pesë-

gjashtë ndriçues dore, dhe u banë gati me shkue drejt vorerezave. Tek po zbrisnin shkallëve, u doli para një tufë trumcakësh, që shqyheshin në gaz. - Baca Shpend! - mezi arrijti me folë njëni prej djelmëve – Shpirtin e tyt eti, që prehet në xhenet, me e folë sherrxhinë. Para se me i vu celularin në arkivol, njëni prej nesh i ka heqë skedën. Me folë, pak ma parë, fola unë ... Zemrimi i burrave ishte një tërbim i vërtetë, po nuk zgjati as dhjetë sekonda e ia shpërthyen gazit edhe ata.”

Ndoshta mjaft mirë na e sjell në fabulën e filozofinë e tij edhe **Spiro Xhavana** tek “*Pjesë nga fjalori i tranzicionit*” kur na sqaron se celulari është “Aparat që përdoret në mes të dashuruarish, në variantin: "Të vi?" ose "Eja, se iku!"”. **Timo Mërkuri** e shtron termin celular në një mjedis me kompjuterin, por disi për të shuar mërzitjen dhe trishtimin tek “*Aty ku s’jam...dërgoj zemrën time*”. Mërkuri thekson midis të tjerave në këtë tregim se “Kjo histori mu kujtua ndërsa mbyllja telefonin celular, i ulur para kompjuterit dhe një trishtim më kaploi të tërin.” Tek tregimi “*Ujku i gënjeshtërt...*” i shkrimtarit **Odise Kote**, gjejmë jo një celular, por tre të tillë “Martin Kola nxorri tre celularët që mban gjithnjë me vete, sepse është biznesmen dhe na tregoi. Na tregoi mesazhet e shkruara aty.” **Pozaet Qose** e përdor tek tregimi i tij “*Këshilltari i ministrit*” thujse në një kënd tjetër. Ngjashëm mund të lexohet tek tregime të tilla të autorëve Përparim Hysi tek “*Gjarpëri*”, “*Krokamat*” nga Fatmir Terziu, “*Mesazhet e çuditshme*”, pjesë humoristike nga **Spiro Xhavana**, “*Hingëllimë prilli*” nga Izet Shehu apo edhe tek cikli me poezi i **Roland Gjozaj** “*Nëna ime në Amerikë*”.

Për të bërë disi më të kuptueshëm rolin frymëzues të celularit sot në krijimtari, mjafton tu sjell ndërmend mjaft faktorë të tjerë ndikues e frymëzues në kohëra të ndryshme. Le të sjellim një fakt: Kuajt. A nuk ka mjaft poezi, krijime të ndryshme me kuaj në sfondin frymëzues?

Për intelektualët Fatmir Terziu, Eshref Ymeri, Fahri Dahri, Vilhelme Haxhiraj, Resmi Osmani...etj.

Skënder Sadri KAPITI

Këtë letër të nderuar zotërinj Fatmir Terziu, Eshref Ymeri, Fahri Dahri, Resmi Osmani, Fatmir Minguli, Vilhelme Haxhiraj, Bedri Tahiri, Xhevahir Cirongu, Kadri

Tarelli, Shpendi Topollaj, Ilir Malindi, Vladimir Muça, Agim Bajrami, Vaso Papaj dhe të tjerë; pranojeni prej meje Skënder Kapiti si shenjë respekti e mirënjohje të thellë intelektuale për atë kontribut kombëtar të madh tuajin. Këtë letër drejtuar Juve më nxiti që ta shkruaj një shkimi Profesor Eshref Ymeri me titull: **”Letër miqësore për intelektualin e njohur nationalist Skënder Kapiti** botuar te Gazeta **“BULEVARD”** e intelektualit dhe botuesit **Z. Artur Llana**, të cilit unë dhe të gjithë intelektualët e sipërcituar i jemi dhe duhet t’i jemi falenderues dhe mirënjohës botuesit Llana pasina ka dhënë mundësinë që të njihemi ndërvete dhe të botojmë te **Gazeta e tij këtu në Shqipëri**, në një kohë kur pothuaj se të gjitha mediat e gazetat e tjera të Tiranës u kanë vënë embargo intelektualve të mirëfilltë, atyre antipolitik, kritikë realë dhe jo servilë, të aftë dhe nationalistë.

Pasi e lexova me vëmendje këtë letër dhe pasi e falenderova z. Ymeri, kjo leter më shtyu që tu drejtohem edhe Juve në mirënjohje e respekt për përkushtimin e madh intelektual e artistik, akademik, politik, historik, moral e shkencor tuajin në shërbim të çështjes dhe të interesit të lartë kombëtar. Dhe vlerësoj se është shumë mire dhe ka dobi të madhe kombëtare aktiviteti dhe kontributi juaj i jashtëzakonshëm intelektual në të mirën kombëtare gjithshqiptare, për njohjen dhe edukimin akademik e patriotik të brezave. Si një individ me trashëgimi, me educate dhe contribute familjare patriotike. Unë ndjehem shumë mirë moralisht dhe shpirtërisht në ato se çfarë ju kontribuoni me përkushtim intelektual dhe kombëtar tuajin për në të mirën e përgjithshme gjithdimensionale kombëtare. Prandaj dhe për këtë po ju shpreh mirënjohjen dhe respektin tim të veçantë dhe më se të merituar për ju. Duke marrë shkas nga kjo letër e shoh të arsyeshme që të citojmë këtë rast diçka nga Libri im **“TRIUMFI I KOMBIT”**:

“Ky pseudo intelektualizëm me dëshmi, diploma e me tituj fals dhe të blerë, inferior dhe i sëmurë joshet lehtë nga lëmoshat e pushteteve, e bën mire punën e servility dhe “apologjinë” e dështimeve të qeverisjeve të korruptuara. Egoizmi sëbashku me korrupsionin ia kanë arritur qëllimit mjaft mire deri diku duke përjashtuar aftësinë, moralin, dhe ndershmërinë intelektuale nga institucionet qendrore dhe ato bazë të sistemit. Ky realitet ka sjellë dekurajimshpirtëro rdhe bllokimine kapaciteteve dhe aftësive, të ekspertizmit dhe të profesionalizmit duke goditurrëndë personalitetin, lirinë, lartësinë dhe krenarinë intelektuale nga

njëra anë,por edhe demokracinë e patriotizmin nga ana tjetër.(TRIUMFI I KOMBIT, faqe34).Atë të përbashkë tqë unë e kam konstatuar te veprimtaria Juajintelektuale janë shqetësimi dhe hirraJua jqë buron nga shpirti dhe ndjesia e thellë shpirtëror e drejtuar popullit shqiptar dhe nteligjencës shqiptare që të angazhohen dhe të zgjohen nga letargjia; është një thirrje modeste, por edhe ftesë për guxim e veprim për të bërë më të mirën dhe ndryshimin.Ju drejtova Juve pasi te Ju shoh një intelektual me zëmër krejtësisht dhe si një antitezë karshi intelektualizmi politik injorant, mercenar, servile dhe dështak që kanë kapur shtetin dhe shoqërinë shqiptare. Nga Ju ka se çfarë të mësojë shoqëria shqiptare: të duhurën, të domosdoshmën dhe vlerat. Ashtu sikurse nga Ju, intelektualizmi shqiptar ka se çfarë të mësojë dhe duhet që t’iu referohet edhe mendimtarëve dhe filozofëve botërorë si p.sh. nga Immanuel KANT: ***“Vepra në atë mënyrë që, parimi juaji veprimit të bëhet vetvetiu një ligj për të gjithë botën”***. Dhe ky parim duhet lexuar e kuptuar sot si domosdoshmëri intelektuale për të vepruar e punuar me përkushtim, pa egoizëm, pa servilizëm, dhe jo si mercenarë të parasë, materializmit e as të pushtetit; thirrje për të vepruar e punuar ndershmërisht dhe me guxim për të gjetur, paraqitur dhe mbrojtuar të vërtetat, të moralshmen, të drejtën dhe të gjitha ato që ishërbejnë interes të përgjithshëm kombëtar; duhet vepruar e punuar me guxim kundër korrupsionit dhe të pavërteteve e të pafytyrësisë së pushtetit dhe politikës mashtruese dhe të dëmshme.

Me respekt nga Skënder Sadri KAPITI, Durrës

Durrës, 5 Dhjetor 2020

Ishte njeri i vlerave intelektuale. Neki Cirongu do mbetet i tillë edhe pas vdekjes.



Po arfton data 17 marsi. Ende lotët e shkurtit s'janë tharë në sytë tanë. Ata lotojnë sërish të bashkë me lulet e bardha të marsit, qëndrojnë në heshtje duke vajtuar atje te varri pranë oficer Nekiut. Ditët kalojnë, por edhe dhimbja jonë për këtë njeri të mrekullueshëm e intelektual, nuk rresht së vajtuari. Sëmundja e shekullit Covid-19, e cila ka mbërthyer gjithë globin, po lë plagët e tija në shoqërinë njerëzore. Sa dhimbje e vuajtje po ndjen njerëzimi!? Kjo flamë e së keqes, po merr jetë njerëzish ashtu tinzare nuk po kursen "dorën e zezë" mbi njerëzimin kudo në botë. Ishte pikërisht data 17 shkurt 2021, ashtu si një kuçedër i merr parakohe jetën shokut, mikut e bashkëfshatarit tonë oficerit Neki Cirongu.

Neki u lindi e u rrit në një familje patriotike...

Ai u lind në fshatin Leskovë të Skraparit më 18 Tetor të vitit 1955 në fisin e Cirongu. Fisi i Cirongve shquhet për atdhedashuri, arsim e kulturë. Edhe familja e Shefqet Cirongu, shquhet për patriotizëm, arsim e kulturë. Gjyshi i Nekiut, Alo Cirongu ka ndihmuar luftën e Vlorës më 1920. Po kështu më 1939 kundër pushtimit fashist Italian të Shqipërisë, kundër grekëve në vitet 1914 e në 1940. Në vitet 1941- 1944, pra deri në çlirimin e vendit nga okupatori nazifashist, xhaxhai Isa Cirongu rreshtohet në formacionet partizane bashkë me kushëririn tjetër Ibrahim Cirongu. Alua ishte antër i këshillit nacional çlirimtar të fshatit. Shtëpia ishte një bazë e fuqishme e luftës partizane. Xhaxhai i Nekiut, Isai, edhe pas çlirimit të vendit qëndroi në radhët e ushtrisë popullore në Elbasan, i cili shërbeu me devotshmëri deri sa doli në pension (sot ai nuk jeton). Edhe Neki u rrit bashkë me këto veti e cilësi atdhedashuri, ndaj qysh i vogël e

donte rroben e ushtarakut. Kur binte fjala se çfarë do bëhej ku të rritej, ai përgjigjej me një herë: Oficer ! Me mbarimin e shkollës fillore e atë 8 vjeçare në vendlindjen Leskovë me rezultate të larta, i del bursa për të vazhduar shkollën e Mesme Mekanike në Lushnje. Ishin vitet 1970- 1974, kur Neki u kryen me rezultate të mira shkollën Mekanike, por ëndrra e tij ishte e paplotësuar Meraku i tij ishte të bëhej oficer. Kështu, në vitet 1974 – 1977, përfundon Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, në specialitetin logjistikës “Prapavijë”. Në vitin 1978 titullohet oficer dhe emërohet në Berat filimisht intendent batalioni dhe më pas shef ushqimi në Brigadën e Tankeve në Poshnje të Beratit. Me krijimin e Divizionit “Riza Cerova” në Berat në vitin 1983 emërohet shef ushqimi në Divizion, i cili shërbeu deri në vitin 1990. Ndryshimet e trazicionit politik e shqëror, Neki Cirongu s’ju nda misionit të vet si ushtarak, por pas viteve 1990 ai shërbeu në disa institucione të rëndësishme shtetërore si: Në detyrën e shefit të shtabit në Bazën e Furnizimit të logjistikës në Garnizonin - Berat. Më pas transferohet në Gardën e Republikës në detyrën e logjistikës, dhe së fundi, deri në momentin e ndarjes nga jeta kryente detyrën e shefit të logjistikës në Spitalin e Burgut në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në Tiranë. Neki la tre fëmijë: një djalë dhe dy vajza. I kja e parakohshme nga kjo botë na pikëlloi të gjithëve, por ai la pas fjalën e dashurisë njerëzore kudo që punoi e jetoi. Janë të shumtë ata që pikëllimin e tyre të asaj date 17 shkurti 2021 të cilët e shprehën edhe me fjalën e tyre. Ne mundëm të sjellim disa prej tyre në këtë memorie kujtimi si :

Agim Alimadhi:

“Me shumë dhimbje sot mora vesh për ndarjen nga jeta të njeriut të mirë, sa fisnik dhe bujar, kurajoz, i gjendur kudo për çdo njeri. Do na mungosh o shoku ynë i mirë. Do kujtojmë me dhimbje shakatë e tua, që gjithmonë bëje me shokët. Do ta ndjejmë ndarjen e parakohshme nga ky flamë virus të shkut tonë me të mirë. Lamtumirë e qoftë dheu u lehtë. I pa harruar kujtimi i tij.”

Blerim Çela:

I madhi Neki Cirongu !

“ Do mbetesh gjithmonë njeri i rrallë dhe me vlera për shoqërinë. Më kujtohet dita e parë kur u njoha me ju në QS Burgjeve..Një njeri i thjeshtë, sportiv dashamirës për të gjithë ne. Ngushëllime familjes Cirongu nga Familja Çela!”

Pëllumb Bajarktari :

*“Do na mungosh Neki i dashur të të shohim, por do jesh në zëmër. Nuk besoj të mos dëgjoj zërin tënd të ëmbël këtej e tutje. Nuk hiqen nga mëndja vitet tona të punës dhe shkathtësia jote për t’u gjendur kudo dhe për këdo. Nuk do të harrojmë jooooo kurrë!
Të qoftë dheu i lehtë vëlla!”*

Dilaver Hoxha :

*“ Kjo flamë e tmerrshme po na bën dëme të pariparueshme !?
Na mori dhe një njeri tjetër te talentuar, Nekiun e jashtëzakonshëm.
Zemërmirin, fjalëmblin, shokun e vërtetë ideal. Një mik që ishte i veçantë në llojin e tij.
Nuk më besohet – Ai ishte frymëmarrja për të gjithë familjen dhe dashamirësit e shumtë - Ai me fjalët, buzëqeshjen, shpirtin prej idealisti, të ndihmonte vetëm me prezencën, jo më me përkushtimin që nuk i ka munguar kurrë.
I drejtohem familjes NEKIUT TË MIRË, - Ju lutem kurajo për ta nderuar dhe lumturuar engjëllit tonë që u ngjit në parajsë, në duart e Zotit.
Ngushëllime bashkëshortes, ngushëllime vajzave, ngushëllime djalit që është mjaft larg.
I përjetshëm dhe i pa harruar kujtimi i të madhit Neki Cirongu*

Bashkim Shatro :

“Na iku shoku yonë i fëmijërisë, ashtu papritur para kohe. Zemra ime u drodh, sytë lotuan për bashkëshatarin tonë të mirë e intelektual. Ishte një njeri me plot vlera ! ”

Por...17 marsi po afron, e ditë e muaj të tjerë do ikin, por Neki Cirongu do kujtohet gjithmonë, sepse ai la gjurmë të mira mirësie në shoqëri e në institucionet shtetërore ku punoj gjithë jetën në shërbim të atdheut. Ishte në prag të pensionit të pleqërisë, por Covidi i preu ëndrrat në mes. Ai do kujtohet si një baba e shokë i rrallë ku spikatnin vlerat njerëzore.

Durrës dt.08 Mars 2021

Shkrimtari Arben Kurteshi, del para lexuesve me romanin e etij të parë me titullin “Plisi”

Duke lexuar romanin me titullin “Plisi” të shkrimtarit Kosovar Arben Kurteshi, desha apo nuk desha, u rroka menjëherë në gjithë brendësinë e tij, sepse për gjatë rrugëtimit të lexueshmërisë, ai më tërhoqi si me magnet, e më thoshte:” Më lexo deri në fund, nuk të lë në mesin e rrugës!”. Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Në tërsinë e këtij romani, zbulohet dalëngadalë si pala e flamurit tonë kombëtar, tregohen disa ngjarje kulmore nga ngjarjet historike të poullit tonë, i cili ka luftuar në shekuj kundër armiqëve të shumtë, të egër, të pa besë, për të fituar lirinë e për të jetuar të lirë në vatrat stërgjyshore. Romani në vetvete ka një përshkrim historik, nga ku ka marrë edhe temën e rrëfimit letrar, të saktë, të qartë, me frymëmarrjen plot oksigjen, ku ngjarjet shtjellohen rrjedhshëm, aty spikatin karaktere të ndryshme të personazheve si pozitive ashtu edhe ato negative. Romani me titullin aq domethënës “Plisi” ka një gjetje interesante me një shtrat historik kombëtar të popullit shqiptar, siç është simboli pra, qeleshja e bardhë si bora e maleve, ai me emrin “PLISI” që mbajnë mbi kokë burrat e gratë shqiptare. Autori ka ditur ta përshkruajë bukur dhe me një stil të veçantë tërë brumin shkrimor letrar të këtij romani; ku lexuesi do njihet me shumë episode të cilat kanë të veçantën e vetë artistike e letrare. Në gjithë dinamikën e ngjarjeve në këtë roman, kanë si fokus luftën e vitit 1999, që u zhvillua në Kosovë për liri e pavarësi kundër bishës pushtuese shekullore serbe. Lexuesi do zbulojë se, romani paraqet copëza historie të ndodhura vërtetë në Kosovë, por shkrimtari i ri nga Gjilani, Arben Kurteshi, na e sjell të gëdhundur historinë në formën letrare, dhe me bazë të atyre fakteve që ndodhën në ato vite në Kosovën tonë kreshnike. I gjithë romani ka nën ndarje prej tre pjesë kapituj. Në çdo kapitull të tij, stili letrar përshkruhet me një fill artistik gjerdani të artë, ku frazat e fjalët që përdor autori, kanë një lirikë të pëlqyeshme, lexohet rrjedhshëm si ujët e burimeve shqiptare, ose më qartë, si burimet e vendlindjes së autorit. Kornikat e ngjarjeve zbërthehen me çiltërsinë e shpirtit, ku personazhet pozitive flasin me dashuri të madhe me njëri – tjetërin, kanë mall e

dashur për veten e të tjerët, pavarësisht se nga cili vend e komb janë ata. Por, edhe ngjarjet negative të prura në roman, si dhe personazhet që zbërthehen e përshkruhen në atë mënyrë që të ngjallin neveri, e deri në urrejtje, sepse ata kanë sjellë ligësi me pa të drejtë në familjet e vatrave shqiptare. Shembulli pozitiv në këtë roman është familja e Shaban Krasniqit, një familje atdhetare e punëtore, por edhe shumë e dashur dhe e respektuar në shoqëri. Ishte akti atdhetar i baba Shaban Krasniqi, i cili frymëzoi dhe ushqeu ndjenjat e atdhedashurisë bashkë me bashkëshorten e tij Zaidja për tek fëmijët e tyre, por edhe më gjerë në rrethin shoqëror. Kjo familje vuri në dispozicion të LIRISË për Kosovën gjithë potencialin e saj shpirtëror, material, deri me jetën e kryefamiljarit Shaban Krasniqi, i cili humbi jetën në burgun serb nga torturat më ç'njerëzore. Por, me gjithë ato vështirësi si nga ana psikologjike, ekonomike, përndjekje, familja 'Krasniqi' u rezistoi deri në fund torturave të regjimit gjakatar serbosllav. Në atë punishte të vogël familjare, punohej Plisi i bardhë për ta vendosur mbi kokë demonstruesit në Prishtinë, Prizren e në gjithë Kosovën. Në roman del forca e arsyes së brendshme e ligjetime të një logjike dashamirëse për gjithë kombet, që jeta e tyre të jetë e lirë, pa shtypje e diskriminim midis tyre. Pra, të bëjnë jetën në paqe, ashtu si na e ka dhuruar vetë Zoti! Familja "Krasniqi" ashtu si gjithë edhe familjet e tjera në Kosovë, ndihmonin luftën e drejtë ligjetime të UÇK, me gjithë mjetet e duhura. Dhe bërja e plisave nga Iliri, si në Kosovë e në Zvicër për demonstruesit shqiptarë që protestonin para ambasadave të huaja, është një shembull admirues dhe spikat vlerat atdhetare e lridashëse që kanë të rinjtë shqiptarë ndaj atdheut. Kjo tregon se figura letrare që ngre autori me anën e personazhit kryesor të romanit me emrin e Ilirit, e bën më interesante brumin artistik e letrar që përshtjellon në të tre kapitujt. Pra, në mënyrën artistike shkrimtari Arben Kurteshi ja ka arritur qëllimit të tij në këtë vepër letrare; dhe lë një gur themeli në vetë historinë e shtetit më të ri siç është Kosova, duke ngritur lartë vlerat historike në këtë vepër letrare. Në gjithë hapësirën e romanit, ngjarjet e personazheve janë në lëvizje e sipër, ata ngjiten e ulen si meteorët në qiellin e historisë e të lirisë, duke filluar nga Kosova, Shkupi, Zvicra, Belgjika, Gjermania, Suedia, SHBA, etj.

Krahas Ilirit, personazhi tjetër që spikat në këtë roman me titullin "Plisi", është edhe nëna e Ilirit, Zaidja, por edhe motrat Liria e Bukuria. Njëra prej motrave

bëhet pjesë e formacionit të UÇK-së. Pra, kur Iliri shkon te daja në Zvicër nga përndjekja e militarëve serbë, malli e dashuria për njerëzit e zemrës e Kosovës rritej edhe më shumë. Por edhe aty, Iliri gjen mundësinë, dhe sakrifikon duke brë qeleshe për demonstruesit shqiptarë. Ai lidhet me Shoqatat Atdhetare atje, të cilat koperonin edhe në Belgjik, Gjermani, Suedi e gjetkë. Duhet theksuar, se me këtë vepër letrare, autori Arben Kurteshi, edhe duke qenë një njohës i mirë i gjerdanit historik të kohës, ai ka bërë ta skalisi me mjeshtëri e artistikisht veprën letrare të këtij romani, i cili është i pari roman që shkruan ky autor, që tashmë lexuesi do ta ketë në bibliotekën e tij. Por, romani "Plisi" do zërë një vend të duhur në rrafshin artistik e letrar në letërsinë shqipe. Ne po sjellim sa për ilustrim këtë frazë për lexuesin të shkëputur nga kapitulli parë i këtij romani.

“ Mbas vetëm një jave lajmëruan avokatin e Shaban Krasniqit që i akuzuari që ndodhet në paraburgim vdiq.

Avokati i shqetësuar telefonon Ilirin.

-Të lutem eja urgjent në zyrën time. Iliri menjëherë shkon tek avokati dhe kur e shikon që ai e fton të ulet dhe s'po dinte si ti thoshte, Iliri ngre zërin fol he burr, çfarë ka ndodhur?! Avokati me gjysem zëri, o sa keq me vjen.. Babai yt ndërroi jetë.

Iliri viri duart në kokë dhe quante me ngashërim. Avokati e la të qante disa minuta, ja largo duart nga koka, i dha një pecetë letre për të fshirë lotët, dhe i tha: -Barrë e rendë të ka renë djalë, shko ne shtëpi kujdes për nënën, ditë të mira ardhshin për ty !.. ”

Duke qenë edhe redaktor i librit me përmbledhje në poezi, tregime e fraza filozofike, aty pash se, autori Arben Kurteshi kishte të ardhme edhe në fushën e tregimit të gjatë, dhe bëra sygjerimet e duhura, që shkrimtari i ri Gjilanas, ka një prepspektivë e porta letrare krijuese premtuese. Dhe, vërtetë nuk paskam gabuar, Arben Kurteshi iu ngjit majës së malit të krimtarisë nga tregimi i shkurtër, për te tregimi i gjatë, siç është romani. Me punë e vullnet sigurisht arrin aty ku do, sepse optimizmi e këmbëngulja, çajnë shtigjet e vështira, dhe fundi djellëron. Kështu ndodhi edhe me shkrimtarin Arben Kurteshi. Dhe ja, na vjen me librin më të ri, romanin ” PLISI si një buqetë ku çelin lulet e shpirtit të shumëvuajtur si lulet e majit të LIRISË!

Në kapitullin e dytë, ngjarjet në roman kanë si bosht të tyre qëndrimin e personazhit kryesor të këtij libri, të Ilirit në Zyhri të Zvicrës. Ai aty takon dajën e vetë e shumë djem nga Kosova e vende të tjera, të cilët kishin emigruar aty nga shumë arsye e rrethana gjeopolitike dhe ekonomike. Mbas një ndërhyrje nga ana e dajës, Iliri fillon punë si kamarier. Njohja me çiftin Mayer, e bën edhe më krenar djalin kosovar, sepse aty gjeti një përkrahje të ngrohtë, pa racizëm, dhe kjo i jepte forcë e kurajo që të punonte për veten, familjen në Kosovë, por edhe për çështjen kombëtare në çlirimin e Kosovës nga okupatori shekullor serb. Kjo ndikoj që edhe aty të merrte përsipër prodhimin e plisave për protestuesit shqiptarë, e në veçanti për rininë që ishin në emigracion sidomos në Zvicër, Belgjikë e Gjermani. Aty njihet më nga afër edhe me shoqatat atdhetare e shtëpi besnikë që luftonin në teren me fjalën e tyre para ambasadave të huaja. Kjo pati një ndikim të madh në arenën ndërkombëtare, saqë ndërhyu edhe NATO, në Kosovë. Në shtratin e vet romani sjell plot sekuenca ngjarjesh edhe episode të ndryshme nga njerëz të ndryshëm, që kanë dhimbjen e tyre, por edhe dashurinë ndaj atdheut e kombeve të tjerë. Lexuesi, sigurisht do ta ndjejë veten si një pjesëmarrës në këto ngjarje të rrëfimit letrar që përshkruan autori Arben Kurteshi. Dhe kjo, të bën të mendohesh thellë në kohë të shkuara e të tashme, sepse çdo detajë e rrëfimit të të treguarit mbi rezistencën që kanë bërë shqiptarët në shekuj ndaj pushtuesve, e në veçanti shtypja shekullore të kosovarëve nga serbosllavët në fundshekullin e XX, duhet të reflektojmë të gjithë, që kombi ynë të bashkohet rreth trungut të vet, në një flamur, në gjuhë për të jetuar i lirë në tokën e vetë stërgjyshore. Ky lajmotiv na përcillet në formën letrare nga autori, nëpërmjet figurave e personazheve simbolike aq të dashura, dhe të shkrira në një trup të vetëm: Te LIRIA e Kombit tonë !

Dhe siç tregon autori te romani PLISI, se gjëja më e çmuar e kësaj bote qënka LIRIA e vërtetë në tokën ku lind e flitet gjuha e nënës. Pa këto, nuk mundet të jesh i lirë, sepse ato janë thesaret e vërteta të shpirtit tonë, e kthehen në materie JETE tek ne si njerëz !

“ U deshën dy diët për tu ndodhur në Shkup. U ndanë me shferin dhe menjëherë u ndodhën në autobusi e linjës Shkup- Kosovë... Iliri nxorri kapuçat nga çanta dhe ngriti zerin:

-Djema, shokë e miq të mirë, edhe ju jeni në historinë e jetës time...! Në historinë Kosovare edhe pse nuk luftuat, keni ndihmuar ekonomikisht... Luftë pa armë me ndihmë e kurojo, që UÇK të mos ti mungoshin armë, ushqim dhe rroba...

Rroftë UÇK,- bërtitën të gjithë një zëri ! ”

Ne jemi munduar të sjellim disa nga këto episode këtu tek kjo parathënie, sepse ato janë të shumta, të cilat janë përshtjelluar artistikisht nga autori Arben Kurteshi. Këto pak sekueca ndihmojnë lexuesin, për një referim sa më të shkurtër në njohjen e brendësisë së romanit, dhe ja kemi lënë lexuesit që do romanin për të vazhduar vetë të zbulojë tërësinë e ngjarjeve, sepse ato aq sa kanë trishtimin e tyre, po aq kanë edhe madhështinë e dashurinë e dliërë në thelbin e kullës së shpirtit njerëzor. Ne po sjellim edhe një paragraf të mbylljes së romanit, ku spikat fuqishëm ajo ndjenjë e lartë që arrin deri në kupën e qiellit e takon yjet plotë dritë JETE PËR TË GJITHË NE E BREZAT QË DO VIJNË PAS NESH ! Më konkretisht:

“Dhe ndërkohë, Hyjnë Xhaxhi Murat, Bujari, Mentori...

U përqaftuan dhe zunë vend pranë tavolinës, muzgu i mbrëmjes sapo kishte rënë. Mungonte vetëm SHABAN KRASNIQI të gjithë kishin shpëtuar... Së shpejti dhe atij do ti bëhej busti me plis në kokë ” .

Na mbetet për ti thënë autorit të këtij romani me plot vlera letrare, suksese në rrugëtimin tënd krijes, sepse arti e letërsia është pashaporta e një kombi.

Durrës, më 6 Maj 2021.

Petraq Misto Proko vjen para lexuesve me librin të titulluar “Jetë brezash”

Duke ndjekur në gjithë dinamikën e krijimtarisë së tij, autorin Petraq Misto Proko, i cili ka botuar deri më tani 10 libra me tematika të ndryshme. Midis tyre autori ka botuar edhe një vëllim me përmbledhje me poezi. Botimet mnografike, historike e kulturore , autori na sjell atë larmi kolori historik kohor të ndërthurura me një frymë rrjedhshërie para lexuesit. Si rrjedhojë e një përkushtimi , që për vetë autorin i del nga shpirti ajo thirrje e ndërgjegjes së brendshme shpirtërore, për të lartësuar gjithë ato ngjarje në librin e titulluar “Jetë brezash”. Ngjarjet dhe

historitë e treguara nga të tjerët, por edhe nga dokumentat, për autorin e këtij libri një vend të rëndësishëm zënë edhe ngjarjet e jetuara nga ai vetë. Si rrjedhojë e këtyre ngjarjeve përjetësuese, edhe nga personazhe të tjerë, të cilët janë pjesë e këtij libri, autori na tregon atë pjesë të historisë e të kulturës të Përmetit, të vendlindjes së tij fshatit Kaludhit, të cilat janë pjesë e kulturës shqiptare. Këto e të tjera ngjarje që përfshihen në tre kapitujt e këtij libri, ndërtohen ajo "Kështjella" prej guri të sakalitura me fjalë aq domethënëse që përmban histori e pjesë kulture nga krahina e Përmetit. Me shpirt e zemër autori përshkruan bukur historinë e fshatit të lindjes Kaludh. Ai tregon e shkruan me imtësi gjithë zhvillimet historike e ata shoqërore të civilizimit shoqëror, ekonomik e kulturor të vendlindjes. Si rrjedhojë e këtij preceptimi të udhëtimit deri në disa shekuj, lexuesi do njihet edhe më shumë për prejardhjen e formimin e fiseve e të vetë fshatit Kaludh. Ngjarjet në këtë libër, të shkruar nga ky autor, vijnë natyrshëm, dhe na tregojnë me ngjyra të ndezura si zjarri atë dashuri për vendlindje, për njerëzit e për çdo gjë, duke filluar nga Kaludhi, Pëllumbari, Petrani, Zhepa, Bënja, Frashëri, Stërmbeci, Vlora, Fieri, Durrësi, etj. Por, si një kurorë "nuse" na shpalos edhe malin e Nëmërçkës, burimet e krojet me ujë të ftohtë që zbresin e takohen me banorët e fshatit Kaludh, me fshatrat për rreth tij duke u "Puthur" me lumin Vjosë. Si një gjerdan me thurje fjalësh, në librin "Jetë brezash", lexuesi do njihet edhe me traditat e dasmave Kaludhiote, si pjesë e kulturës dhe e raditës sonë shqiptare. E themi këtë, sepse këngët e vallet e kësaj treve, janë pjesë e artë e kulturës komëtare shqiptare. Aty përshkruhen bukur ritet e dasmave Kaludhiote, por edhe këngët e vallet, të cilat janë sot pjesë e shpirtit të kulturës mbarëkomëtare, thesare të vërteta që do mbeten në shekuj. Pra, nga ky këndvështrim, autori Petraq Misto Proko, ka bërë gjetjen e bukur për ta sjellë edhe një herë para lexuesit traditat shqiptare, si pjesë e jetës sonë të trashëguar në shekuj nga të parët tanë, pra kjo "Stoli" siç thotë autori në këtë libër, duhet ta trashëgojmë edhe brezave pasardhës. Kjo thirrje e autorit, vjen si një këmbanë e fuqishme në ditët e sotme, ajo duhet kuptuar me gjithë ndjenjat shpirtërore, që këto vlera e thesare të mos harrohen, por ti zhvillojmë edhe më tej. Pra, pa këtë vlera kulturore, arsimore, ekonomike e shoqërore nuk mund të përparojë shoqëria e vendi. Në gjithë gamën e kapitujve të këtij libri "Jetë brezash" autori Petraq Misto Proko, na përcjell fuqishëm deri në çdo qelizë të trupit tonë atë dashuri

njerëzore, duke ngritur lart vlerat e njerëzve, e në veçanti të të dashurve të zemrës tij. Në monologun që përshkruan në mbylljen e këtij libri midis të tjerash shkruan : *“Në këtë moment u ngrit dhe daja Gore,që vlerësoj dhe tha këto fjalë që buronin nga zemra. “Ju djemtë e vajzat e Mistos e të motrës time Aleksandra, të jeni krenarë për babain e nënën. Ju keni qënë mësimdashës, keni ecur në jetë vetë me kurajo e guxim, ku s’ja ua ka ngrënë qeni shkopin asnjëherë,i lumtë Gathos e të gjithëve ju që keni nderuar babë e nënën, por edhe veten tuaj.”*

Na mbetet për ti thënë autori të librit, suksese e rrugëtim të mbarë për tek lexuesit librit me titullin aq domethënës “Jetë brezash ”.

Durrës, dt. 20 Prill 2021

Gazeta “Muzgu” një yll polar e fjalës letrare Shqipe!

@ Në larminë e botimeve të gazetave që botohen sot në Shqipëri, si një uragan letrar është bërë pjesë edhe gazeta letrare “ Muzgu”. Kjo gazetë po tërheq çdo ditë e më shumë nga gjithë vendi e diaspora krijuesit tanë. Aty botohen krijimet letrare e gjithë krijuesëve të vjetër dhe të rinj. Kjo gazetë, është e re që del në treg. Sapo ka hyrë në vitin e dytë të jetës së saj me botues Mark Simoni. Aty përfshihen botime letrare të ndryshme, paprjashtim e në gjithë fushat letrare. E veçanta e kësaj gazete është se, aty gjen faqe të veçantë botuese për tematika të llojeve e gjinive letrare, të cilat përfshihen në antologji poetike. Kjo është një risi si për nga lloji,por edhe gjithëpërfshirëse me sa më shumë autorë.Prurjet letrare të autorëve të të gjitha fushave krijuese, dhe botimet e tyre në gazetën letrare “Muzgu”, më e madhja që gjendet sot në vendin tonë. Gazeta “Muzgu” po kthehet dalngadalë,si një yll polar në hapsirën mbarëshqiptare të botës krijuese letraro-artistike. E ku ka më bukur të shkruash poezi për “Nënën”, për “Dashurinë”, për Vendlindjen” etj. Ja pra, këtu qëndron edhe fillimi i madhështisë letrare dhe mbështetja për gjithë krijuesit kudondodhur shqipfolës anembanë globit!

Durrës, 07. Maj 2014.

Ese

Kujtimet janë gonxhe ringjallje...!

Të kujtosh ata që ke për zemër, të cilët janë gjallë por edhe ata që nuk janë midis nesh; ke bërë një sfidë të madhe si për veten ashtu edhe për brezat që vijnë. Te kujtimet e bukura, sigurisht për ata njerëz që kanë lënë gjurmë të mira në shoqëri, miqësi, e familje, vjen një ditë e gonxhja e kujtimeve rizgjohet e prap bën thirrjen e brendshme të ndërgjegjes sonë njerëzore, ku na jep atë ndjesi e përgjegjësi për të hedhur në letër fjalët e shpirtit që burojnë si ujë burimi të kulluar. Njerëzit e mirë që kanë zemrën e madhe, mundohen që të përcjellin sa më shumë “mjaltin” e dashurisë në gjithë fushat e jetës shoqërore. Një nga ata burra zakoni i cili rrezatonte vlerat e traditës, por edhe të vlerave të civilizuar shoqërore e përparimtare, ishte edhe Fari Bako nga fshati Burranj të rrethit Skrapar. Ai lindi në vitin 1936 dhe ndahet nga jeta më 16 maj të vitit 1994.

Sa më shumë që largohen vitet, po aq shumë kujtohen e vlersohen ato vlera njerëzore e intelektuale nga njerëz të ndryshëm të kohës, të cilët kanë jetuar e punuar së bashku me këtë njeri plotë vlera e shembulli pozitive për shoqërinë. Fariu ishte njeri energjik e largpamës, por ai dinte të vlerësonte edhe të tjerët, i lartësonte dhe u jepte vlera intelektuale atyre. Fjala e mendimi i atij burri, ishin kryefjala e mirësisë së punës e të përparimit shoqëror. Ishin këto cilësi të cilin e bënë që të respektohej nga të gjithë. Fariu ishte njeri punëtor e kërkues ndaj vetes

e të tjerëve. Atë e gjeje punëtor krahu në punët e bujqësisë e blegtorisë, por edhe si një organizator i zoti në çdo drejtim. Qysh në fëmijëri i atij i ra barra e rëndë familjare të përballonte edhe punët familjare. Punonte punëtor krahu në bujqësi e blegtori. Mbas mbaroi edhe detyrimin ushtarak, më vonë ai punoi si brigadier fushe në fshatin e lindjes Burranj. Mbaron arsimin e mesëm e kalon në administratën e ish kooperativës së bashkuar Dobrenj, dhe më vonë shef i administratës. Ai i donte njerëzit me shpirt, prandaj edhe ata e respektonin aq shumë Familja e tij ishte solide e shembull në shoqëri. Të katër vajzat u arsimuan, ai u dha edukatë e dashuri prindërore së bashku me bashkëshorten Kanuçë, i martuan dhe sot u gëzohet mbesave e nipave që e duan aq shumë. Disa janë në Milano Itali, në Monako të Francës, në Durrës e Tiranë. Kam shumë kujtime për këtë njeri të vlerave njerëzore, ashtu si shumë të tjerë të cilët e kujtojnë edhe pas kaq vitesh kur ai ka ikur nga kjo jetë. Ishte vetëm 58 vjet atëherë kur sëmundja e pabesë i merr jetën parakohe, por ai la shumë kujtime e vlera të bukura njerëzore, kujtohet me plot dashuri e dhimbje nga të gjithë edhe sot pas kaq vitesh. Fari Bako ishte edhe njeri i këngës e valls popullore. Atë e gjeje pas punës edhe skenave të veshur me kostumet popullore.



Kënga folforike ishte shpirti i tij. Ai dinte të fliste me fjalë të ngrohtë e buzëqeshje me të gjithë njerëzit:të mëdhenj e të vegjël.Kanë ikur 27 vite që nga dt. 16 maj të vitit 1994,dhe sot në maj të vitit 2021,kujtimet i rrinë si gonxhe trënafili , i japin ringjallje e respekt nga shumë njerëz që kanë bashkëjetuar në atë kohë, por edhe nga brezat e rinj të sotëm ,sepse mirësia vlerësohet në çdo kohë.Ne kemi për të thënë shumë për këtë njeri shembull të vlerave shoqërore e intelektuale,por edhe kaq sa shkruam ja vlen për të thënë se kemi sjellë ato cilësi kujtimesh që na shërbejnë të gjithëve ne e brezave që do vijnë.



Foto, viti 1986: Fari Bako, Silvana,mbesa,Vita Bako,vajza.

Edhe pas 27 vitesh, ai kujtohet me gjithë mirësitë nga njerëz të ndryshëm duke l dhënë edhe më shumë vlera me komentet e tyre në rrjetet sociale pas publikimit tim të fotos me kostume kombëtare të Fari Bako, të cilat ne mundëm të shkëputim disa prej tyre e ti botojmë këtu në këtë ese përkujtimore.

Valentina Bako:

"Bravo Xhevo, na freskove mendjen për një xhaxha të mbrekullushëm, na kishte marrë malli shumë, u çmalla, kujtim i pa harruar qoftë !"

Tozulia Bako – Doko:

"Ahhhh xhaxhi im i dashur... Sa mall që kam... Sa i mirë që ishte.... Vita më ka marrë malli... I paharruar qoftë kujtimi i xhaxhait...!"

Marjana Gjoni:

"Rrofsh xhevahir që e kujton, më mungon shumë, ishte baba i dashur dhe i rrallë në të gjitha drejtimet!"

Vita Bako :

"Xhevo, jetë e shëndet ty me gjithë familjen që e kujton babin!"

Lefteri Çipi:

"Foto me lotkujtimesh...Shumë bukur, qofshi gjithëmonë të lumtur dhe të gëzuar!"

Durrës, 16 Maj 2021

Pentagrame filozofike ...

"...**Dituria** i qëndron afër të paditurës. Ajo e mëson të paditurën si të rrugëtojë në jetë por.....!

Mirëpo, fatkeqësisht e paditura, ngaqë s'e kupton dot diturinë, e përbuz atë deri aty sa e lëndon gjer në skutat e shpirtit diturinë. Kështu, e paditura bie në

greminë. Si rrjedhojë e kësaj, atëherë kujtohet dhe kërkon për të shpëtuar nga fatkeqësia, **Diturinë!**".

Dhjetor 2014, Xh, Cirongu

" Kur lindim derdhim **lot gëzimi**, por edhe kur largohemi nga kjo botë, përsëri derdhim **lot hidhërimi**. Sa çudi me të vërtet!? Pse ndodh kështu, - pyesim ne! Por ja, një përgjigje egziston:"Sepse nga loti kemi lindur e me lot ikim në parajs drejtlumturisë së përjetshme

Dhjetor 2014, Xh. Cirongu

" **Ilaçi** më i mirë që shëron plagën e shpirtit në trupin tonë njerëzor, por edhe që forcon kockën dhe e bën më fosforishente atë, është diellësia e fjalës së mirësisë"

Shkurt 2015, Xh. Cirongu

"Në shpirtin e pastër, pra tek njerëzit që kanë vërtet kristale dashurie, ruhet dashuria e vërtet, ndërsa tek njerëzit shpirt vegjël, dashuritë blihen e bëhen pazar si mall pa vlerë!"

Xh. Cirongu, Qershor 2018.

" Në do të jesh i ditur, bëj mik librin e lexoje atë ! "

Prill 2019, Xh. Cirongu

"Një zemër e gëzuar, mbjell dashuri!

Tetor 2019, Xh. Cirongu

" Kush ngreh zërin tej masës së llogjikës, atij i mungon dituria inetelektuale e profesionale !"

Maj 2019, Xh. Cirongu

“Njerzëve dritëshkurtër bëju mirësi sa të duash, një ditë ata do mbjellin gjemba në kopshtin e mirësisë ! ”

Nëntor dt. 11. 2019, Xh. Cirongu

“ Në çdo gur vargun shkruan poeti, loti e kënga aty veç mbeti ! ”

Dt. 24 Maj 2020, Xh. Cirongu

“E vërteta është kryevepra më e bukur e kësaj bote !? ”

Dt. 13 Qershor 2020, Xh. C irongu

“ Kur flet zemra, si dielli buzëqesh fytyra e tregon sinqeritetin njerëzor ! ” Dt. 22 Korrik 2020

“Nëse e do jetën e gjatë, mbill lule në kopshtin e zemrës tënde !”

Dt. 17 Gusht 2020, Xh. Cirongu

“ Kur e shkruan “floririn – kohë” në vargje, ajo s’ka harresë , por JETË !” Dt. 9 Nëntor 2020, Xh. Cirongu

“Njerëzit që s’kanë dinjitet, janë si një dru i thatë ! ” Tetor 2020

“ Atje ku ka dashuri, ka mirëqenie e shëndet !”

Dt. 5 Nëntor 2020, Xh. Cirongu

“ Të gjitha interes firojnë rrugës, vetëm e vërteta ecën krenare gjatë jetës !” Dt. 17 Nëntor 2020, Xh. Cirongu

“ Tek fjala e ëmbël është mirësia ”

Dt. 6 Dhjetor 2020, Xh. Cirongu

“ Poetët ndërtojnë kalatë e fjalës së shpirtit , prandaj s’kanë kurrë vdekje ! ” Dt. 16 Janar 2017, Xh. Cirongu

“ Në do të kesh dritë në të menduar dhe peshë në logjikën e fjalës së shprehur, këto i gjen te libri !” Dt. 23 Prill 2020 Xh. Cirongu

“Urtësia në logjikë ka peshën e një mali, kurse fjala e ëmbël ngroh edhe ujët e oqeanëve! “ Dt.11 Dhjetor 2019.Xh.Cirongu

“ Ilaçi më i mirë i cili shëron plagën e shpirtit në trupin tonë njerëzor, por edhe që forcon kockën dhe e bën më fosforishente atë, është diellësia e fjalës së mirë ! “ Dt. 10 Shkurt 2015 Xh. C.

“ Të gjitha interesat filtërojnë rrugës, vetëm e vërteta ecën krenare gjatë JETËS ! “ Xh. Cirongu dt. 17 Nëntor 2020

“ Nëna ime e shtrenjtë:Në lotin i syrit kam shkruar EMRIN TËND, në Zemër fjalën e DASHURISË, në shpirt DRITËN E PËRJETSISË!

Durrës, 5 TETOR 2018 Xh. Cirongu

“ – Një budalla e pyrt një të mençur : - Kur e ndjen veten për të mençur ? – Sigurisht kur i vij sipas mendjes budallait !? “

dt. 06 Nëntor 2020 Xh. Cirongu

“Vrapo me kohën, se po iku, vështirë ta kapësh atë!? Dt. 08 Mars 2021. Xh. Cirongu

“Fjala e babait është e rëndë si guri,por e pastër si floriri !”

Dt. 20 Mars 2020 Xh. Cirongu

“Po deshe veten, do edhe të tjerët. respekto mendimin e tjetërit, për mirë apo edhe kur të thotë dobësitë (të keqen) në sy. Në këtë mënyrë respektohesh e nderohesh (veten) , pra ndërton kala të fortë në rrugëtimin e JETËS ! ”.

Dt. 15 Mars 2018 Xh. Cirongu

@ “Shtëpia pa njeri, është si kopeja pa bari ! ”.

@ “Pika e djersës në punën e ndershme, është e rrjedh si burim floriri !”.

Nëntor, 2019.

@ Gënjeshtra është një gjethe pa frymë, aty s'ka frymarrje i bën dëm vetes, kurse xhelozia është një sëmundje e rrëzikshme , ajo i sjell dëm vetes e të tjerëve...(!)
formuloi : Xh. Cirongu 27 maj 2020.

@' Buzëqeshi jetës, sepse aty është shkruar me gërma të arta jeta e gjithsecilit nga ne. Aty mbretëron lumturia jonë!".
Formuloi: Xh. Cirongu.

Portale @ facebook....

O moj Shqipe që na linde, nga ty mos u ndafshim kurrë!...

Reportazh.

Në vend të prologut...

“-Këndoni vocët e mi, se këtu jemi në gjirin e shqipes sonë, - u tha nipërve e mbesave nëna nga Suhareka në marsin e vitit 1999-ës që kishte udhëtuar mes predhave e plumbave nëpër malet e Kosovës e kishte mbritur në qytetin bregdetar të Durrësit.” Më kujtohet ajo natë Marsi i atij viti me shi e borë, një dimër plot zymëti që të kallte frikë. Por , më “dimër i ashpër” ishte lufta e që

zhvillonte ushtria serbe në Kosovë ndaj vëllezërve tanë. Suhareka e gjithë Kosova ishte ndezur nga flakët e luftës për liri e pavarësi!

Koment:

Haziri, Vjenë [E marte, 20.11.2012, 01:59 PM]

I nderuari z.Xhevahir Cirengu, të lumtë penda në këtë shekll të shtetit shqiptar. Përkujtimi i veprave të mëdha të njerëzve të thjeshtë, është diçka sunbilike dhe me rëndëdësi në ngritjen e virtytit fisnik shqiptatë.

Vepra e njeriut tonë thjeshtë është brumi i të gjitha fitoreve tona. Penda e juaj e ka prekur këtë, jeton me te, është vet ai. Ai njeriu i thjeshtë e modestë nga fjalët por madhor me vepra.

Të faleminderit edhe nga unë në emër të prindërve të mi të ndjerë që e provuan pritjen vëllazërore dhe shtruan pritej vëllazërore dikur.

Haziri, Vjenë

Porterete mjekësh:

Z. Lushaj[E shtunë, 15.04.2017, 08:15 PM]

Bravo Xhevo. Një shkrim shumë i mirë.Ka shumë njerëz ëe punojnë shumë e ndjehen pak. Është detyrë e rëndësishme ti mbështesim e përgjithsojmë.

Urime.

Zemra shqiptare

Poet i pathyeshëm

(Poetit , Xhevahir Spahiu)

Shahin Ibrahimimi[E shtunë, 31.12.2011, 07:51 PM]

Urime z Xhevahir,më bëhet qejfi se po na nderon me shkrimet e tua qytetin tonë.Me pëlqyen poezitë.Gëzuar vitin e ri dhe suksese Shahini.

Z. Lushaj [E premte, 30.12.2011, 02:10 AM]

Urime zotri Xhevahir.Një ciikël shumë i mirë.Duket, gjithë Xhevahirët, prodhojnë xhavahire.

Miqsisht, Zeqiri.

“Zhurmon Osumi nga ujërat nëpër luginë

*Dhe valët e bardha i ndal atje mbi shkëmb,
Vargu i poetit zgjuar rri tek unë
Pse s'flet poeti? Ah! Nga ky çast gjoksi po më dhemb!...”*

Idriz Ismajli : Shkurt 2021

-Pak relaks ne keto ditë që ngjajnë me pranverën mik i nderuar

-Rrallë herë ndodh keshtu miku im ne Durrës. Atraksion i vërtetë.... 14 shkurt 2020 Bardhësi e borës në qytetin bregdetar të Durrësit, mbase do sjelli bardhësi edhe në zemrat e njerëzve për këtë vit në Shqipëri e në mbarë botën ! foto Xh, Ciron...

Fadil Curri: Faleminderit miku im i çmuar i penës, z. Xhevahir, po bora e ka lezetin e vet...

Komente për babain tim nga miq,kushërinjë e shokë,të cilët i falnderoj duke ju uruar gjithë të mirat familjare.

Hysen Grajçevci:

-Qofë i përjetshëm kujtimi për babait mik!

Gëzim Çipi:

-Të rroni e ta kujtoni Xhevo..!

Gëzim Voda:

-I pa harruar kujtimi i babait tuaj Xhevo.Është e vetmja gjë njerëzore që mund të bëjmë ndaj të ikurve tanë, t'i kujtojmë e mos t'i harrojmë.

Mimoza Dorrozhani:

-I paharruar daja Remziu, kështu i thërrisnim ne se mami na kish' mësuar që të vogla kur vinim te teze Alimeja i donim shumë dhe kur vinte nëne Dedeja,na prisnin me shumë dashuri,qofshin të paharruar kushëri!

Oert Cirongu:

I pa harruar kujtimi i babagjyshit,do jetë gjithmon në zemrat tona se ishte i vacantë!

Baki Cane:

-Të rrojmë dhe ta kujtojmë dajon Xhevo!

Mirela Cirongu:

-Na mungon shumë gjyshi!?

Rraman Shabani :

-Qoft i paharruar xha Remziu!

Idari Carkanji:

“ - E kam njohur nga afër në zdruktarinë koopertivës së Zhepës, njeri i nderuar dhe fisnik,i pa harruar kujtimi i tij!

Kastriot Caka:

-I paharruar babai juaj Xhevo!

Maksim e Behare Çipi:

-Qoftë i pa harruar kujtimi i babait tuaj të rroni e ta kujtoni!

Et'hem Shukulli:

-I paharruar ai burrë fisnik e fjalë pakë!

Estref Dorrozhani:

Qoftë i paharruar në përjetësi Remziu!

Poezia “ Çadra ”

Koment Pjetër: Sukses të vazhdueshme dhe mjaft të gëzueshme në krijimtarinë tuaj të begatë poetike,mik i dashur! Qofshi e kalofshi mirë familjarisht!

Poezia " Zjarri i dashurisë"

Komente:

Mihal Seferasi: Paç shëndet, Xhevo!

Mehmet Kono:Të përshëndes , Xhevo!

Lata Brahimasi: Përshëndetje Xhevo,Gëzuar 2021!

Fadil Curri: Suksesse miku im, vargje të bukura!

Tzoulla Bako – Doko: Shumë bukur...ju perqafoj me mall...
gëzuar një vit të mbarë!

Pjetër Cara: Vargje optimiste me emocion frymëzues!Më
pëlqen kjo poezi.Urime dhe shëndet e plot suksesse,
Xhevahir!

Urime për nipin dt. 28 Dhjetor 2020

El'ham Pasha: Gëzuar , mik krijues!

Marjana Gjoni: Shumë bukur, ka lezet me nipin !

Hajri Kapllani: Ta keni me jetë të gjatë princin o Xhevahir!

Vita Bako – Shabani:Dhe 100 ylli i tezes!

Bajama Shabani: Gëzuar mbarsi e te rroj nipi! Gëzuar o Dyshe,
mbarsi kudo e të rrojë nipi.

Poezia IKJA...

Komente:

Hysen Grajçevci:

Pranë një pamje të natyrës së mrekullueshme, nuk ka se si edhe vargjet e kujtimet të mos kenë mbetur te xhaketë e vjetër!

Vjollca Koni:

-Shumë e bukur!

Sa e njoh atë pamje është e imja dashuri?!

Suksese poet i vendit tim Xh. Cirongu!

Nasibi Çipi:

Shumë bukur xhevair, pamje e mbrekullushem!

Maksim Çipi:

Pranë kësaj pamje të mrekullushme dhe me vargjet e tua të bukura,na përshkruan rininë tonë të dikurshme.Urime!

Kujtim Mateli:

Urime Xhevahir për poezinë plot ngjyra shpirtërore.

Urime me rastin e 8 Marsit 2021:

Arben Kurteshi:

Urime, shëndet suksese e pa fund gëzime!

Pjetër Cara:

-O sa bukur! Gëzuar me mua 7 marsin familjarisht! Kështu t'iu shohim përherë! Qofshi e kalofshi sa më mirë familjarisht!

Lefteri Çipi:

Urime,suksese dhe pafundësi.
Ju uroj shëndet dhe gëzime!

Xhelo Tozaj:

M'u bë qefi që pashë një çift fisnik dhe të respektuari nga ana ime.Duke festuar,plotë e paçi gjithnjë me shëndet e mbarësi. Zonja gëzuar 8 marsin!

Bajame Shabani:

Shumë buku xhevo, Dyshja s'paska ndryshuar!?

Marjana Gjoni:

Shumë bukur,qofshi gjithmonë të lumtur dhe të gëzuar!

Mirela Cirongu:

Ju dua shumë,si yje u kam!

Antoneta Myftaraj:

Të mbrekullueshëm,qofshi gjithmonë të lumtur !

Vita Shabani:

Bukur, qofshi të lumtur!

Poezia

Fletëza urimi të bardha bore

Vendlindja ime çdo ditë më thërret
Se, nga gurët e dheu yt u bëra poet,
Te krojet e fshatit ndalove një çastë
E ngjeva penën me ujë të kristaltë,
Pastaj, me mall shkrova vargun e artë...

Komente:

Rraman Shabani:

Bravo mall për vendlindjen, ai vend na lindi e na rriti
xhevahir, respekte!

Mihal Seferasi:Mall për fshatin tonë, xhevo !

Meçan Hoxha :Bukur, Xhevo.Të lumtë!

Xhelo Tozaj :Ku është balta më e ëmbël se mjalta...!

Tefta Seferasi:Na emocionove xhevo, rrofsh sa malet bashkkë me familjen tënde të madhe!

Komente të marra nga faqja JEMI Skraparlinj

Shenim: Për këngën “Në Leskovë ëndrrat fluturojnë” , ku brenda shtatë ditëve të publikuar në utub nga Grupi Polifonik” Tomorrëca – Skrapar”, arriti, mbi 14 mijë shikime, 40 komente, dhe 66 shpërndarje. Ne mundëm të shkëpusim vetëm disa komente të ndryshme për ti vendosur këtu në librin e radhës së botimit.Në pamundësi për ti shkruar të gjithë komentet, ne ju urojmë shëndet e suksese gjithë atyre që shkruan komentet e tyre, por edhe në vazhdim me urimin e falnderimit: shëndet e suksese në familjet tuaja kudo që jetoni e punoni nëpër botë. ZOTI JU NDIHMOFTË!

@ Ibrahim Tanushi: “Zemra ju këndoftë!”

@Adriana Leka:”Për këta këngëtarë, si Pëllumb Gjata...Respekte pafund!”

@Miranda Koli:”Ju këndoftë zemra, super kënga, respekte”

@ Maksim Behare Çipi: ”Super!”

@Juli Shatro:”Bravo! -Ju lumtë goja, respekte pafund!”

@Verie Sevdari Liçollari:”Ju lumtë goja për këngën. Unë jam mbesë në Leskovë. Jam rritur me këto këngë...!”

@Rita Liçollari:”Ju lumtë goja! Shumë kujtime për dajon Skënderin,e xhaxhain...Këndoni shumë mirë, më kënaqin këngët e Skraparit...!”

@Muharrem Kalemi Hajdari:”Ju përshëndes, e ju lumtë goja !”

@ Shkëlqim Shpresa Xhizdari:”Ju lumtë goja”

@Bajame Terolli:”Ju lumtë goja Tomorrica “

@Astrit Shembitraku:”Zemra u këndoftë!”

@Myslim Cirongu:”Ju këndoftë zemra”

@Gëzim Lila:”Ju këndoftë zemra gjithmonë, nostalgji për atë vend edhe për të gjithë ju. Respekte!

@FREDI PANAÇI : U këndoftë zemra se na kënaqët shumë!.

@Leonora Gjoni:

Shumë bukur grupi, ju përshëndes me shumë respekt dhe ju që i keni bërë një tekst të mbrekullshëm.Je një poet i shkëlqyer me plot vlera.

Ju falnderoj nga zemra të gjithëve!

Tomorricë moj zonjë mbi zonjë

Kënga e re sapo doli

Teksi : Xhevahir Cirongu

Sudio: Agim Xhemali

Grupi Polifonik Tomorrice - Skrapar

Nesim Meno dhe Vilson Zani

Koment :Arben Kurteshi, Zvicër,: Madhështore muzika, teksti , pamjet, video!

Galeria e fotove të cilat mbajë kujtime të bukura në vite:

















Në foto: Muharrem Paja (gjyshi i Rakos)



Në foto: Fari Bako



Në foto: Leonora Gjoni, (Terpollari)



Nga e djathta në të majtën: Fet'ha Paja, Juanis Sitaqis me grupin themelues ekoenergji në Shqipëri, viti 2014

Autobiografi

Ka lindur në fshatin Leskovë, Tomorricë-Skrapar në vitin 1959. Arsimin fillor e të mesëm e kryen në vendlindje, viti 1981. Vazhdoi për Kulturën Masive (Degën e Librit) në Korçë, e kryen atë shkëlqyeshëm në vitin 1990. Pranë gazetës "Jehona e Skraparit" ka kryer kursin e gazetarisë. Nga viti 1978 deri më 1987, ai ka bashkëpunuar me Kabinetin e Gjuhësisë së rrethit skrapar, (sektorin e leksikologjisë dhe leksikografisë). Krijimtarinë e ka nisur herët, që kur ishte nxënës në bangat e shkollës 8- vjeçare. Fillimisht ka botuar në revistat "Fatosi" e "Pionieri". Më vonë, prej vitit 1976 e deri sot, shkruan e boton në gjithë median e shkruar dhe atë elektronike. Në vitin 1984, merr çmim të parë në festivalin kombëtar të këngës për fëmijë që u organizua në qytetin e Shkodrës; me titullin e këngës "Ligjëron nëna për djalën" të kompozuar nga Hajri Xhamëni. Po kështu, ka shkruar tekste këngësh folklorike. Kënga me motive të dasmës së krahinës së Skraparit "Moj nuse, faqe simite" merr çmimin e dytë në festivalin folklorik të Gjirokastrës. Është autor i katër këngëve, që janë hedhur në disk të kënduara nga këngëtarët popullorë Asllan Ibro e Bajram Haxhillari, në vitin 2009 dhe 2013 -ën. Tekstet e këngëve iu kushtohen dëshmorëve të Vlushës (të vrarë në luftën e Dytë Botërore- 1944); si dhe Astrit Suli, - Dëshmor i Kombit, i cili dha jetën për çlirimin e Kosovës në vitin 1999.

Në vitin 2009 merr pjesë në konkursin letrar për tregimin më të mirë të organizuar nga shtëpia botuese "Ada" dhe revista "Obelisk", ku tregimi me titull "Hijet e harresës" hyn në antologjinë "Tapeti i tregimit". Me poezinë "Nëna" merr pjesë në antologjinë "Lotët e Virgjër" me autor Agim Mato – Fatmir Terziu, botuar nga "APCO" 8 mars 2012 në Londër. Ku midis 143 poetëve nga gjithë trojet shqiptare është edhe emri i poetit Xhevahir Cirongu. Ka marrë pjesë me poezitë e tija të botuara në 10 antologjitë me poezi që ka botuar shtëpia botuese "Muzgu" në Tiranë. Po kështu, autori Xhevahir Cirongu është edhe redaktor e korrektor i mbi 90 librave. Poezitë e Xh. Cirongut janë vlerësuar edhe nga kritikë e studiues të ndryshëm. Të tillë janë Faik Xhani – Tiranë e Pjetër Cara – Durrës, i cili vlerëson poezitë të libri me titullin "Bisedë me poezinë" midis autorëve të tjerë edhe krijuesin e trevës së

Skraparit, poetin nga Leskova e tomorricës, Xhevahir Cirongu.

Ka punuar në Kulturë e telekom deri në vitin 1990. sot shkruan në mediat e shkruara dhe ato elektronike në të gjitha fushat gazetareske e letrare. Deri tani është autor i 14 librave. Ka në proces botimi edhe 3 të tjerë me tematikë të ndryshme. Deri më sot,

publicisti, poeti e shkrimtari Xhevahir Cirongu, në fushën e gazetarisë ka botuar mbi 4 mijë artikuj të fushave të ndryshme në publicistikë e letërsi.

Jo vetëm kaq, Xhevahiri është edhe një kritik e vlerësues i mirë letrar. Janë me dhjetra kritika vlerësuese që u ka bërë shumë autorëve rreth librave të tyre, në Shqipëri e Kosovë. Ai di të qëndis bukur fjalën e shkruar dhe të bëjë vlerësim real që mirëpritet nga lexuesi i mirëfilltë letrar. Ka bashkëpunuar dhe është bashkëpunëtor i shumë gazetave e revistave brenda dhe jashtë vendit. Ka botuar e boton shkrime në revistat: "Fatosi", "Pionieri", "Shqiptarja e re", "Hosteni", "Obelisk", "Dituria", "Metafora", "Vegime letrar", "Pavdekësia" "Krahu i shqiponjës" etj. Por edhe në gazetat "Jehona e skraparit", "Luftëtari", "Puna", "Zëri i rinisë", "Bulevard", "E vërteta", "Ndryshe", "Zëri i popullit", "Republika", "Kushtrim brezash", "Telegraf", po edhe te "Drita", "Muzgu", "Dielli i Tomorrit", "Nacional", "Dëshnica", "Zëri i Gollobordës", "Tirana observër", "Fryme e Re" por gjithashtu tek "Lajmi", "Bota sot" në Kosovë, etj. *Në vitin 1986 vlerësohet me Medalien "Naim Frashëri". Gjithashtu, Xhevahiri merr pjesë në "Ditët Naimiane" që organizohet për çdo vit në Përmet, i cili përfshihet me një poezi në këtë antologji. Po kështu merr pjesë në antologjinë ndërkombëtare për mesdheun me dy poezi kushtuar pemës së ullirit , i cili përfaqëson Shqipërinë. Njëra poezi vlerësohet si poezia më e mirë e kësaj antologjie që botohet në itali në vitin 2017 në gjuhët italisht, fërngjisht dhe shqip. Poezitë e këtij autori, përveç përkthimit në gjuhët, Anglisht, Italisht, Fërngjisht, janë përkthyer edhe në gjuhën Arabe e Kineze. Eshtë antar i Klubit të Shkrimtarëve e Artistëve - Durrës. Por, Xhevahir Cirongu është edhe një nga inisiatorët e themelimit të grupit folklorik Tomorrica – Skrapar në qytetin e Durrësit, dhe ka krijuer disa tekste këngësh të reja të kënduara nga këngëtarë të ndyshëm të cilët janë antarë të këtij grupimi të këngës popullore. Njëkohësisht ai është edhe antar i këtij grupi folklorik me qendër në qytetin e Durrësit.*

Botime të autorit:

- 1.Kush ia shkeli syrin Ildës, poezi (2005)
- 2.Tomorrica zemra jonë (bashkëautor) ,monografi (2009)
- 3.Shpirtit i thërres, poezi (2009)
- 4.Mall nga oqeani, publicistik, poezi, tregime (2010)
- 5.Misteri i një graje, tregime (2010)
- 6.Bisqet e gjakut, monografi histori (2013)

- 7.Kosmogonia e një poeti kosovar (bashkëautor)
përmbledhje kritika vlerësuese letrare (2014)
8. Pena e Bedri Tahirit përjetëson lavdinë
tonë kombëtare , histori (Bashkëautor) (2015)
9. Kënga e lotit, poezi (2016)
10. Livadhi në mal , tregime për fëmijë (2017)
11. Tomorri qiell perëndie (publicistikë) (2018)
- 12 . Udhë në kohë... (publicistikë) - (2019)
- 13.Sikur ta prekja diellin, poezi, (2020)
- 14.Shtigjet e vendlindjes (publicistikë) - (2021)

Fund

Durrës, Prill 2021

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Cirongu, Xhevahir
Shtigjet e vendlindjes: publicistikë / Xhevahir Cirongu;
red.Osman Azizaj.
Durrës- jozef, 2021
200 f.; me foto: 14,5 x 21 cm.
ISBN 978-9928-357-06-9

- 1.Letërsia shqipe
2. Kritika,interpretim.
- 3.Shkrime,korrespondenca për shtyp

824.18.09
821,18.-92

Përmbajtja

Fq.

1. Djali nga Skrapari Rako Paja kërkon të “Kap” diellin6
- 2 .Poet që ndez zjarre e lë gjurmë në shpirtin e lexuesit.....16
- 3.Rreth vicioz....19
- 4.Endrra nuk merret...21
- 5.Po të mos ishe ti...25
- 6.Libri poetik”Eci mbi një fije shprese” pasqyron shpirtin e kohës që jetojmë.....40
- 7.Në “Kurthin” e koronavirusit dhe marrdhënja njeri- natyrë...46
- 8.Poezia e Rifat Plakut lexohet si vetë pranvera.....49
- 9.Tomorrë nëpër shekuj dhe tomorricarët që apelojnë.....52
- 10.Partizan Bako, me rastin e 30 vjetorit63
11. Ecim rrënjëve të atdheut.....67
12. Kemi zonjën Amerikë.....76
- 13.Poetja emigrante Xhemile Aliu fluturon me vargun poetic nëpër krahët e erës.....79
- 14.Intelektualë që përcjellin dije e vlera qytetarie në shoqëri.....87
15. Mësues Flamur Çela, “Flamur ‘krenarie në fushën e sporteve...94

16. Biografia e Skënder Kapitit.....	96
17. “Drenica “e Durrësit, 20 vjetori i Qëndresës së mobilizimit të luftëtarëve të UÇK.....	103
18. Libri është porta e cila të fton në “galerinë e dijeve.....	107
19. Veprimtaritë mbajnë gjallë historinë tonë.....	115
20. 1 Prill 1999 -1 Prill 2019, - 20 vjetori i qëndresës së mobilizimit të luftëtarëve UÇK-së “Dernica” Durrës.....	118
21. Invalidët, duam zbatimin e ligjit, jo premtime.....	122
22. Nën petkun e “Pandemisë” korrupsioni po zhvat edhe xhepat e invalidëve.....	127
23. Sociale.....	122
24. Invalidët.....	127
25. “Imagjinata VS” një krenari e vetëdijshme që mbartë vlera letrare.....	129
26. Celulari mjet më i ri “frymëzyes për krijuesit.....	139
27. Për intelektualët.....	143
28. Ishte njeri livlerave intelektuale, Neki Cirongu do mbetet I tillë edhe pas vdekjes.....	146
29. Shkrimtari Arben Kurteshi del para lexuesve me romanin e tij të parë me titullin “Plisi”	151
30. Petraq Misto Proko, vjen para lexuesve me librin “Jetë brezash”	158
31. Gazeta “Muzgu” një yll polar e fjalës letrare.....	161
32. Kujtimet janë gonxhe ringjallje.....	162
33. Pentagrame filozfike.....	167

34..Portale @ facebook.....172

35.O moj Shqipe që na linde, nga ty mos u ndafshim kurrë...172

36.Autobiografi.....193

37. Boime të autorit....196

Prill, 2021